

BIBLIOTEKA

E

81H-32

784

SHTETIT

GJIROKASTËR



THOMA NOTI

Komisari

NOVELE

89HF39-002

S

1784

BIBLIOTEKA ERINISË

THOMA NOTI

KOMISARI

Novelë

~~5/2~~

BIBLIOTEKA E SHITËRISË
TIRANA 1974

2922

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI

Autobusi i ngjitej me ngulçim së përpjetës plot dredha, duke tërhequr pas një shtëllungë tymi të murmë, që qëndronte disa çaste pezull, pastaj davaritej honeve dhe shkrepave. Major Guri kolovitej në ndenjësë, i kredhur në mendime. Kishte kohë që zemra e tij nuk kishte rrahur me kaq vrull dhe nuk kishte provuar ndjenja të tilla. Ndërsa autobuzi i ngjitej së përpjetës, Gurit i dūkej sikur krahas tij, krahas maqinës, rrëshqiste edhe zyra e shtabit, ku kishin rrjedhur disa nga vitet e tij më të mira. Dhe ai herë e shihte veten në autobuz e herë në zyrën e shtabit, përkrah shokëve, duke kuvenduar plot zjarr me ta.

Sa shumë kujtime e lidhnin Gurin me atë zyrë! Kishte shkuar atje dy-trembëdhjetë vjet më parë, krejt i ri, energjik, dhe po largohej andej disi i ngjallur, i ngathët, po më serioz, më i pjekur në mendime e me një tufë thinjash në tëmtha. Sa ditë e net kishte kaluar në atë zyrë, në atë ndërtesë, duke u marrë me punët e pambaruara të ditës, i përkulur mbi hartat e mbushura me shigjeta e shenja konvencionale të kuqe, të zeza e të kaltra! Dhe ja tani, të gjitha mbetën prapa. Vetëm kujtimet dhe përfytyrimi i mjegullt i zyrës e ndiqnin hap pas hapi, si të qenë në garë me autobuzin e të donin të rendnin para tij.

Ç'biseda të zjarrta, sidomos ato të ditëve dhe të javëve të fundit, pas botimit të Letrës së hapur

të partisë! Dukej sikur problemet e punës, të familjes, të shoqërisë ishin lënë mënjanë dhe kudo flitej, kuvendohej për heqjen e gradave, për krijimin e komiteteve të partisë, për vendosjen përsëri të komisarëve dhe për thjeshtimin e uniformës ushtarake. Edhe tani, që autobuzi nxitonte drejt qytetit të zhytur thellë në male, jehona e largët e atyre bisedave e mposhte zhurmën e maqinës dhe arrinte e plotë dhe e freskët gjer te Guri, buzë dritares së hapur përgjysmë, nga vërshonte ajri i freskët e kundërmues i majëmaleve.

«Thoni ç'të doni, more shokë, po partia po shtron tani një problem shumë të madh, aq të madh, sa është vështirë ta përfytyrosh plotësisht rëndësinë që ka ai sot dhe që do të ketë për të ardhmen e, më thotë mendja, edhe për një kohë shumë, shumë të gjatë». — Ky ishte zëri i Ndrekos.

«S'e luan as topi. Të gjitha këto u bënë në kohën e duhur. Partia mbi çdo gjë, tamam si në luftë dhe... pikë». Ky ishte zëri i Canes.

«Po, si në luftë. Njëlloj si atëhere, partia na bën thirrje që të luftojmë për t'i vënë në jetë me pjekuri e mençuri prej komunisti masat e marra. Dhe, më falni, por unë i kuptoj të gjitha këto, i kuptoj shumë mirë, vetëm me këtë uniformën, me këto gradat... nuk di si të them. Të më falni, po ju betohem se unë nuk e përfytyroj dot Gurin, ose Ndrekon, ose... pa spaletat e majorit në supe, pa...», — ky ishte zëri prej basi i «Otellos» siç i thërrisnin në shtab Alekos, një oficeri me trup të gjatë, me fytyrë të rrumbullakët e ezmere.

«E di si më duken mua gradat, lulkat, o shokë? Si ato kryqet dhe qendizmat e priftit kur bën ajazmonë».

«Ama fjalë! I bukur krahasim! Na e bëre Cainen prift! Ha-ha-ha!»

«Gradat nuk ishin të tepërta e të panevojshme, aq më pak të dëmshme. Po ato e lojtën rolin e tyre».

«Domosdo. Kush është në kundërshtim me këtë? Por tani janë bërë pengesë dhe... pikë. Ligji i mohimit të mohimit: në fillim pa grada, pastaj me grada edhe tani përsëri... Dialektika e zhvillimit dhe... pikë. Këtë s'e luan as topi i allamanit».

«Thoni ç'të doni, por, po u hoqën gradat, më thotë mendja se mbaroi disiplina. Dhe, të më falni, pa disiplinë, s'ka ushtri. Kur të kalosh ti rrugës, ushtari do të shullehet në diell dhe as që ka për të çarë kokën. Do të kthehet nga ana tjetër, me një fjalë. Dhe, më falni, po unë s'i hedh faj... Ku ta dijë ai që je oficer, komandant?»

«Po ai të njeh, ore».

«Mbase në repartin tim më njeh, shumë-shumë edhe në garnizon. Po në një qytet tjetër nga do të më njohë?»

«Do të të vëmë një këmborë...! Ç'thua kështu, «Otello?» Pse, ore, gradën nderon ushtari? Uniformën?»

Guri atë ditë kishte qëndruar mënjanë. Rrinte, dëgjonte dhe heshtte. As ai dhe as të tjerët s'e kishin vënë re kur kishte hyrë komandanti epror dhe sa kohë kishte qënduar ashtu në këmbë, me shpa-

tullat e mbështetura në derë e me duart e kryqëzuara në gjoks. Kur e kishin parë, zërat ishin fashitur një e nga një. Oficerët e shtabit ishin kthyer nga ai dhe kishin pritur ç'do të thoshte. Komandanti kishte hedhur disa hapa mendueshëm dhe kishte qëndruar buzë tryezës së Gurit.

«Të gjithë e thanë nga një fjalë, ashtu siç e menduan. Dhe bënë mirë, se hekuri duke u rrahur kalitet. Po ju, Guri, ç'mendoni? — dhe i kishte vënë dorën në sup e nuk e kishte lejuar të ngrihej nga karrigia. Guri ishte skuqur, kishte ngritur vetullat, e kishte vështruar një çast eprorin dhe kishte ulur përsëri sytë. Ai e njihte prej kohësh kolonel Shpendin — kështu e quanin komandantin — e kishte pasur komisar batalioni gjatë luftës dhe kishte për të një respekt dhe dashuri të thellë, si fëmija ndaj prindit.

«Hë, Guri, ç'mendon? — e kishte pyetur sërish komandanti.

«Si të them? Njëri nga shokët e përcaktoi drejt kur tha se rëndësia e këtyre masave i kalon jo vetëm kufitë e ushtrisë, por edhe të vendit tonë. Por ja, si të them... — dhe kishte vështruar spaletat e kolonelit.

«Të kuptoj. E ke fjalën për gradat. Si do të mund të punojmë pa to? Si do ta njohin të tjerët gjerarqinë tonë? Si do ta respektojnë dhe do ta nderojë ushtari komandantin, i riu të vjetrin, apo jo?»

«Po, shoku komandant».

Koloneli kishte nxjerrë paqetën nga xhepi dhe ua kishte afruar shokëve. Kishte ndezur edhe vetë një cigare, e kishte thithur disa herë në heshtje,

duke u çapitur nëpër zyrë, dhe ishte ndaluar përsëri pranë majorit.

«Guri, sa vjet u bënë që njihemi me njëri tjetrin? A e mban mend?»

«Padyshim, shoku komandant. Njëzet e ca vjet».

«Po. Mbi njëzetë! Një jetë e tërë. Atëhere s'na kishte dirsur mustaqja, madje ti ishe pionier, partizani më i vogël në batalion, kurse tani, — komandanti kishte kaluar dorën mbi kokën pa flokë — tani. . . » — dhe kishte vënë buzën në gaz. Kishin qeshur dhe të tjerët. «Por unë nuk e kam fjalën këtu. Dua të të kujtoj një ngjarje. E mban mend atëhere, në ditët e para të çlirimit, kur të erdhi dekreti i gradimit aspirant? Ti ngurroje t'i vije gradat. Të dukej se, po të veproje ashtu, do të bëje një veprim, që do të të largonte sadopak nga shkollat e luftës, nga partizanët. Dhe nuk i vure për ca kohë. Një ditë unë u detyrova të të thërrisja veçan. Biseduam gjatë rreth dobisë që do të na sillnin gradat, jo aq për t'u mbyllur gojën armiqve, të cilët, meqë e kishin humbur davanë, s'pushonin së thëni se ne ishim njerëz të pyllit, njerëz të egër, të prapambetur, e sa e sa profka të tjera, por sidomos për t'ju përgjigjur më mirë detyrave të reja që na dëlnin në rrugën e modernizimit dhe të kalimit nga një ushtri partizane në një ushtri të rrëgjullt, të kohës. I mban mend këto, Guri?»

«Po shoku komandant. E si mund t'i harroj?»

«Dhe ti i vure gradat. Se ishe krenar për fazën e re, më të lartë, në të cilën hynte ushtria, ishe i bindur për drejtësinë e mësimëve të partisë. Ja, kështu. Po. . . a mund të më thuash, Guri,

kur të respektonin më shumë shokët, vartësit e tu?
Kur ishe pa grada, apo me grada?»

Guri e kishte ngulur vështrimin në një cep të dhomës, ishte menduar gjatë, ishte matur disa herë të fliste, por gjithnjë ndërronte mendje.

«Unë të kuptoj mirë, shok i dashur. Ti e ke vështirë të bësh dallimin. Dhe jo vetëm ti. Të gjithë ne. Kjo ngjet, sepse ushtria jonë është dalluar kurdoherë për një disiplinë të fortë, të ndërgjegjshme; se ushtari ynë — dikush e tha këtë — nuk nderon uniformën, as gradën, por komandantin, komisarin, tek të cilët sheh përfaqësuesit e popullit, të partisë. Pra, ai nderon vetë popullin, nderon partinë. Kështu, Guri. Mos e harro këtë».

«Jo, shoku komandant, nuk do ta harroj».

Dhe ndërsa biseda kishte reshtur e shokët ishin larguar njëri pas tjetrit, ai kishte qëndruar edhe për shumë kohë pa lëvizur nga tryeza, me mjekrën e mbështetur në mes të dy duarve, duke e lënë të digjej gjer në fund cigaren në taketuke. Kishte kujtuar një për një partizanët, shokët e luftës, ditët plot jetë e dinamizëm që kishte kaluar përkrah tyre, në repart dhe i ishte dukur sikur ajo dhomë që ngushtuar, sa po ja zinte frymën. Ishte ngritur, kishte hapur dritaren, po përsëri nuk ishte ngopur me ajër. Kishte ndjerë një nevojë aq të madhe për t'u takuar me njerëz, me ushtarë, për t'u rënë bashkë me ta kryq e tërthor kodrave, majave, sa dhe vetë që çuditur. Ndjenja të tilla nuk i kishte provuar herë tjetër. Ato i kishin nxitur të dilte nga zyra dhe e shtynin diku larg, larg. Dhe ai kishte shetitur për një kohë të gjatë në periferinë e qytetit.

Kur ishte kthyer pasdite në zyrë, e kishte ndjerë veten të lehtë, të freskët, plot energji.

Pas dy ditësh ishte zhvilluar mbledhja e organizatës së partisë, në të cilën ish folur për luftën kundër burokratizmit. Guri, edhe tani, shumë pak mban mend se ç'u bisedua në atë mbledhje. Vetëm se, kur po mbaronin diskutimet, ai ishte ngritur me rrëmbim dhe kishte çfaqur dëshirën që të transferohej në një garnizon të largët, me çdo punë që ta caktonte partia, qoftë edhe me detyrë më të ulët. . .

Dhe ja tani, maqina ecën e ai lëkundet në sedile. Pemët, arat, shkëmbinjtë, kodrat vrapojnë e vrapojnë nga e majta dhe e djathta, ashtu si mendimet e Gurit. Më në fund, maqina ndalet.

Ai zbret dhe merr rrugën për nga reparti.

* * *

Shefi i truprojes e priti me përzemërsi dhe donte ta shoqëronte, po Guri donte të mbetej vetëm. U suall për një kohë para ndërtesave. Ndërkaq, diku, nga e djathta, dëgjoji zëra gazmorë, thirrje. Në këndin sportiv po luanin volejball. Këmbët e shpunë atje. Ushtarët loznin të shkujdesur e me pasion. Ai vështroi një copë herë dhe vetëm pas një kohe vuri re se njëra skuadër kishte një lojtar më pak. Atëhere la valixhen dhe çantën, hoqi si me mëdyshje xhaketën dhe zuri vendin bosh. Ushtarët ishin dhënë pas lojës. Vetëm kur Guri pasoi topin e parë, ata panë njëri tjetrin, mblodhën supet dhe vazhduan të luanin me të njëjtën gjallëri. Guri

luante qetë, kishte gishta elastikë, ngrinte e pason-
te bukur, po gjuante rrallë. Më shumë ja ngecte
topin me mençuri kundërshtarit. Çdo lëvizje e tij
ishte disi e ngathët, dhe të linte përshtypjen e një
njeriu, që ka luajtur mirë volejball shumë vjet
përpara.

Vetëm kur mbaroi loja — duhet shtuar se fi-
toi skuadra ku luante Guri — ushtarët u gjendën
fare pranë majorit. Tani që u veshën dhe nuk ishin
më lojtarë, po eprorë e vartësa, nisën të mbanin
një farë distance e ta vështronin me kërshtëri. Dy
vetë i folën me zë të ulët njëri tjetrit:

— Ka ardhur për inspektim majori, më duket.

— Ka ardhur nga Tirana, me siguri. Si lum
ai. Nuk di ç'do të bëja sikur të mund të dilja sonte
shëtitje nga Hotel Dajti. Eh, sa më ka marrë malli!

Guri i dëgjoi dhe u kollit me zor «khë, khë».
Ata e vështruan dhe qeshën. Qeshi dhe ai.

— Nga Tirana, shoku major?

— Po.

— Sigurisht me shërbim.

— Jo. Jam transferuar këtu.

Njëri nga ushtarët fishkëlloi padashur, po, kur
ndeshi në vështrimin e oficerit, u hutua disi dhe
mori drejtpëdrejtim.

— Këtu! Po me ç'detyrë?

— Zëvendës për punë politike në batalionin e
parë këmbësor.

— Ashtu?! Domethënë i batalionit tonë!

Ushtarët e vështronin tani më me interesim, po
edhe me një ndjenjë gëzimi e respekti njëkohësisht.
Atyre u pëlqeu ky njeri që hyri pa zhurmë e bujë
në mes të tyre, në një mënyrë fare të thjeshtë, pa
dashur të binte në sy. Mbase pikërisht për këtë ata

ndjenë për majorin një respekt të tillë, që nuk kishte të bënte vetëm me moshën e gradën. E vunë në mes dhe, duke biseduar si të njiheshin prej kohësh, e shpunë nga zyrat e komandës. Meqë ato qenë mbyllur, u përpoqën të gjenin kapter Hasanin, që t'i rregullonin vend për fjetje, po as atë nuk e gjetën. Megjithatë, Guri nuk u shqetësua. Donte ta kalonte atë natë, natën e parë në repart, në fjetoren e ushtarëve. Dhe ashtu bëri. Pasi u dha sinjali i gjumit dhe në fjetore ra heshtje, ushtari i shërbimit i tregoi një krevat bosh dhe ai, në majë të gishtave, shkoi atje e u shtri. Qëndroi një copë herë me sy mbyllur, u vërtit disa herë në shtrat, po gjumi nuk e zinte. Nga mesnata ju afrua ushtari i shërbimit dhe e mbuloi me batanie. Nuk ishte ai i pari. Me siguri që postat qenë ndërruar. Domethënë se kishin kaluar dy orë, mbase edhe më shumë. Ai nuk qe në gjendje të thoshte në kishte fjetur, apo jo.

— S'ju zë gjumi, shoku major? — e pyeti posta me zë të ulët.

— Fjeta pak, por u zgjova.

— Epo, kur ndërron vendin njeriu... pastaj edhe dyshekët janë ca të fortë, me kashtë. Dyshekë ushtari.

Guri e kuptoi se ai vuri buzën në gaz. Ishte errësirë dhe nuk ja dallonte dot fytyrën. Donte ta shihte, ta mbante mend. Mënyra se si i fliste, e qeshura dhe vetë prania e ushtarit, se pse i krijoi përshtypjen se kishte të bënte me një nga ata ushtarë, me të cilët mund të afrohesh shpejt e të mbështetesh në ta.

— E pini cigaren?

— Po.

- Doni ta ndizni?
- Këtu është e ndaluar, apo jo?
- Po, por...
- Ju faleminderit.

Ata qëndruan edhe disa minuta pranë njëri tjetrit. Guri vuri duart në kokë, e pyeti dhe për diçka dhe, pa e kuptuar, i kapitur nga udhëtimi, nga mendimet që nuk e kishin lënë të qetë gjithë atë ditë, e mbërtheu gjumi. Ushtari u largua pa u ndjerë, ashtu siç kishte ardhur.

Të nesërmen, në gjithë repartin flitej për Gurin. Ngado që shkonte, ai e ndiente se e shoqëronin sy kureshtarë. Ushtarët i tregonin shokut se si kishte hyrë pa u ndier në lojën e voleibollit, si kishte fjetur atë natë në fjetoren e batalionit, madje edhe për fjalët që kishte shkëmbyer me postën e radhës. Si të donte ta shtonte kureshtjen e tyre, edhe natën tjetër Guri fjeti bashkë me ta. Duke u marrë me punë, ai nuk e ndjeu fare se si kaluan orët dhe as që u kujtua të kërkonte magazinierin. Ditën e tretë dikush ju afrua që prapa dhe ju drejtua me ndrojtje:

— Me leje, shoku major? I keni me vete dokumentat e transferimit?

Ai u kthye dhe vështroi. Ishte një nënoficer disi i dobët, i veshur pastër, i porsarruar, me pulla metalike që i vetëtinin nga fërkimi me sidol, me fytyrë të zgjatur, me dy mollëza pak të kërcyera e si të ngurosura. E si fytyra, veshja, ashtu dhe çdo lëvizje e tij të linte përshtypjen se kishe të bëje me një nga ata njerëz, që çdo gjë e mat me milimetra.

— Më parë të njihemi. Unë jam zëvendësi për punë politike. Quhem Guri Lena, — dhe, duke vështruar ngultas, i zgjati dorën e ja shtrëngoi.

— Unë jam magazinieri i batalionit, kapter Hasan Mera, — dhe bashkëfolësi u skuq gjer te veshët.

Ata ecën krahas njëri tjetrit. Teksa e pyeste për punën, për familjen, për ushtarët, Guri i hodhi krahun me përzemërsi, duke dashur t'i largonte vartësit atë qëndrim të ngathët e të hutuar. Po megjithatë, Hasani rrinte disi larg, me duar të ngjitura te të qepurat e pantallonave, si në qëndrim gatitu. Sjellja e çiltër dhe e përzemërt e eprorit sikur e hutoi edhe më shumë. Njeri i rregullt, i përpiktë jashtë masës, ai mundohej të sillej me një korrektësi të tillë me vartësit dhe eprorët sa që shpesh bëhej i mërzitshëm dhe i padurueshëm, duke mbajtur orë e çast në gojë normat e mirë-sjelljes dhe paragrafët e rregulloreve. Madje, kur kishte mundësi, ai largohej nga ata dhe mbyllej me orë të tëra në depo. Atje, në mes kartelave, formularëve e materialeve, e ndjente veten të qetë, të plotfuqishëm, kurse me njerëzit shpesh hutohesh, ngatërrohej e nuk arrinte të merrej vesh mirë. Ai kishte një parim të tillë në jetë, të cilit mendohej t'i përmbahej me rreptësinë më të madhe: «Mbi çdo gjë, rregullorja... Në paragrafin kaq të rregullores së shërbimit të brendshëm thuhet... kurse në paragrafin aq...» — dhe vazhonte të citonte fjalë për fjalë nene e paragrafë të tërë, aq sa ushtarët, pas një kohe, nuk i flisnin më «kapter Hasani» po «kapter paragrafi» dhe ishin të bindur se ky epitete i përshtatej plotësisht. Dhe filluan atëhere të qarkullonin për të lloj-lloj tregimesh e anekdotash. Tregonin, madje, se disa muaj para se të vinte aty, Hasanit i kishte vajtur në zyrën e njësisë ku punonte, një i njohur i tij i

vjetër, me të cilin shkonte e kthehej shpesh nga puna. Kishin shkëmbyer disa fjalë dhe, kur qe bindur se nuk kishin ç't'i thoshin njëri tjetrit, Hasani e kishte pyetur:

— Po, hele-hele, ç'e mirë të nxori këtej?

— Dua të tërheq disa materiale. Ja listë-kërkesa.

Kapteri e mori, e vërtiti një copë herë nëpër duar, pastaj e pyeti:

— Po vërtetimin ku e ke?

— Cilin vërtetim?

— Si cilin? Vërtetimin se je... Pertef Daja.

Bashkëbiseduesi kishte qeshur me të madhe, duke mbajtur ijet me duar.

— Nëqoftëse ke ardhur për t'u gajatur, më vjen keq. Por mos harro se kjo është zyrë ushtarake dhe duhet të silleni ashtu siç e kërkojnë rregullat, — i kishte folur rreptë Hasani, duke u drethur nga inati.

— Ç'domethënë kjo? Unë kujtova se nuk ka nevojë për vërtetime të tilla. Ti e di mirë, tani sa e the me gojën tënde që jam Pertef... .

— E thashë, e thashë. Por... rregullat janë rregulla. Duhet t'i respektojmë një për një. Mirë ty që të njoh. Po një tjetër? Si t'ja bëj me të? Apo njërit t'ja kërkoj e tjetrit jo. Kështu thoni ju? Me një fjalë të bëjmë dallime...

— Tjetrit në daç kërkoja, në daç jo. Punë për ty është, megjithëse kjo, për mendimin tim, qelbet erë burokraci. Dhe tani hajde, m'i jep materialet, se nuk më pret puna.

— As mos e thuaj atë fjalë. Nuk i shkel rregullat kapter Hasani, sikur bota të përmbysset.

Shoku ishte larguar tërë nerva dhe ishte kthy-

er pas disa minutash e ja kishte afruar vërtetimin mu tek hunda.

— Po tani më njeh që jam Pertef Daja? — e kishte pyetur.

Hasani e kishte parë dhe, pa e prishur qetësinë, ishte përgjegjur:

— Tani po. Mund të fillojmë të operojmë, — dhe kishte hapur me qetësinë më të madhe një formular. . .

Kjo histori u përhap si era në gjithë njësinë. Njerëzit në fillim qeshën, por pastaj ranë në mendime. Duhej korigjuar rregullorja e brendshme e shtabit. (Eh, sa herë e kishin kthyer nëpër duar ato ditë rregulloren e brendshme, sa paragrafë kishin ndryshuar e thjeshtuar dhe sa duhej të korigjohnin ende!) Por, më shumë se rregullorja e brendshme, komandën e shqetësoi qëndrimi i Hasanit. Mos vallë ai, duke u marrë me dokumentat, formularët, materialet, ishte shkëputur fare nga jeta, nga njerëzit? Me siguri që po. Duhej menduar mirë kjo punë. Duhej bërë diçka. Dhe, si e vërtitën punën nga të gjitha anët, vendosën ta transferonin në repart, në «bazë», siç thoshte vetë ai.

Guri nuk dinte asgjë nga këto, por, duke u çapitur përkrah tij, nuk i vinte mirë që ai gjithnjë pyeste, kurse Hasani vetëm përgjigjej. Këtë e ndjeu, si duket, edhe Hasani dhe, pas shumë lëkundjesh, vendosi ta pyeste më në fund:

— Domethënë, edhe juve ju dërguan këtu?

Guri mbajti hapin. E shikoi me vëmendje.

— Mua nuk më dërguan, por erdha vullnetarisht, — e korigjoi në çast.

— Njëllëoj është: ju dërguan ose erdhët.

— Jo plotësisht. Ka një ndryshim të dukshëm në mes këtyre fjalëve.

«E sheh? Ç'mu desh ta pyesja! Rri, o lumëmadh, në punën tënde dhe lëri të tjerët të kavurdisen me vajin e tyre» — e qortoi veten kapter Hasani. Bëri edhe disa hapa në heshtje, pastaj qëndroi:

— Më falni, por... desha t'ju kujtoj edhe një herë për dokumentat, numrin e urdhërit të transferimit, kartelën personale edhe...

— Ju faleminderit. Unë ju kërkova që ditën e parë, por nuk ju gjeta. Sidoqoftë, do të kaloj vetë nga magazina, — u përgjegj Guri, duke e vënë re hutimin e vartësit. «Numër më vete», mendoi duke i shtrënguar dorën.

* * *

Ato ditë Gurin nuk e gjeje kurrë në një vend. Herë do ta shikoje duke kontrolluar rregullimin e brendshëm, herë te armaturat, në këndin sportiv, në poligon, pranë ushtarëve, duke u përpjekur të njihej me ta nga afër. Ai ndjente një gëzim të thellë, kur mendonte se nuk do ta kalonte gjithë ditën e ditës në zyrë, po në ajër të pastër, midis njerëzve. Dhe Guri kishte një aftësi të çuditshme të njihej e të afrohej me ta, të futej në botën e tyre të brendshme. Ai kuvendonte thjesht e shtruar, si shoku me shokun, duke zhdukur me zotësi çdo gjë që krijon distanca artificiale në mes komandantit dhe ushtarit, shefit dhe vartësit.

Sidomos i tërhiqnin vëmendjen rekrutët. Një pasdite, ai ishte mbështetur në trungun e një plepi,

thithte cigaren dhe vështronte me kërshtëri ushtarët e rinj, të cilët nuk ishtë vështirë t'i dalloje nga të tjerët. Me të parë ndonjë ushtar të vjetër, ata e rrethonin dhe i drejtonin pyetje pambarim: cili specialitet ishte më i mirë, si sillej komandanti i togës së ndërlihdjes, kur hapej bufeja, a rastiste të vinte ndonjë fotograf në repart, a shpërbleheshin vërtet me leje ata që dilnin shkëlqyeshëm në qitje, kur do të bëhej betimi, dhe sa e sa të tjera. Ushtari i vjetër mendohej t'u përgjigjej me radhë të gjithëve.

— O po dale, dale. Mos ngulmoni t'i mësoni të gjitha në një ditë, se do të plakeni shpejt. Ahuuu, sa ka zanati! — dhe i shkelte synë ndonjërit e vinte buzën në gaz. Ushtarët e rinj qeshnin me ndrojtje dhe fillonin përsëri nga pyetjet.

— Posta!.. Posta!.. — thirri dikush aty pranë. Ushtarët u drejtuan me vrap andej nga erdhi zëri.

— E ç'të mundohemi kot? Ne dje muarëm letër. Më mire shkojmë nga klubi — i tha Zamiri Petritit dhe i hodhi krahun. Tjetri nuk kundërshtoi. U çapitën me mëdyshje dhe u ndalën para një pasqyre të gjatë anës së fushës, nga ato që u shërbejnë ushtarëve për të kontrolluar uniformën dhe veprimet e para rreshtore. Zamiri u afrua te pasqyra, rregulloi uniformën dhe vështronte disi me habi fytyrën e tij të hutuar.

— Pas trupit të rri, si ta kesh bërë me porosi. Tani ec, — i foli Petriti dhe u mundua përsëri ta tërhiqte. Po ai nuk luajti vendit.

— Mbetë gjithë ditën te pasqyra, o lumëmadh, si nusët e reja.

— Ke parë ti? Në fillim më dukej vetja si në kallup me këto rroba.

— Edhe mua.

Kurse tani sikur po mësohemi, ë? Madje filloi edhe të na pëlqejë uniforma ushtarake. Se si të tregon: më të madh, më të pjekur, më të fortë, desha të thosha.

— Ruaju mos hash veten me sy.

Ata panë disa veta që vrapuan nga bufeja dhe i ndoqën pas.

— Hajde tani, vëri krahët murit dhe shtyu, në mos do të rrish gjithë ditën këtu e të mos blesh gjë prej gjëje.

Zamiri nuk kundërshtoi. U ngjesh pas shokut dhe zgjati duart mbi kryet e të tjerëve.

— Xha Memo, pesë gurabie.

— Një «Partizani».

— Tri petulla.

— Dy lekë karamele.

Të gjithë flisnin me një zë. Në dritaren e vogël zgjateshin aq shumë duar, sa shitësi nuk arrinte të kuptonte se çfarë duhej t'i jepte njërit dhe çfarë tjetrit.

— Me radhë, djema, me radhë, si në mulli. Ç'është kështu me ju, sikur ju ndjek njeri pas. Të merremi vesh, xhanëm. E kujt është kjo dhjetëlekëshe? Ç'kërkon të bleësh, more djalë?

Po zërin e tij nuk e dëgjonte njeri.

— Hajde, xhaxho, luaji duart.

— Qenke me nge ti!

— Pesë byrekë... Dy...

Xha Memua mezi arrinte t'ua plotësonte kërkesat. Kur u dha sinjali i mbledhjes, edhe pse nuk

kishte bërë ndonjë xhiro kushedi, ai u gëzua që i ranë veshët në qetësi. Ushtarët, që s'kishin blerë gjë, u larguan me zor e të pakënaqur.

— Toga, në dy rreshta, mblidhu!

Zamiri me Petritin arritën më pas nga të gjithë. Ata i kishin duart plot me byrekë e gurabie. Kur panë komandantin e kompanisë që u kishte ngulur sytë dhe e mbante me zor të qeshurën, u hutuan fare dhe nuk dinin ku t'i fshihnin ato që kishin ndër duar. Zamiri u mundua t'i mbështillte petullat me shami, kurse Petriti i mbante duart prapa.

— Toger Pirro, lerini edhe dhjetë minuta të lirë, — urdhëroi major Guri.

Ushtarët morën frymë, si të çliruar nga një barrë e rëndë.

— Ja kush ja di hallet ushtarit, — foli një zë.

* * *

Ora e parë e mësimit ju duk tërkuzë Petritit. Në fillim e tërhoqën disi kthimet dhe paraqitja tek eprori, por pastaj u mërzit dhe zuri të numëronte sa herë kthehej majtas, djathtas, prapa. Më në fund u mërzit edhe nga kjo dhe e humbi çdo interesim për mësimin. Zbatonte pa dëshirë komandat dhe bënte njërin gabim pas tjetrit. Komandanti i tërhoqi disa herë vërejtjen, po ai e përmblihte për një çast, pastaj e lëshonte përsëri veten. Mezi që priti sinjalin e pushimit.

— Toga, shpërndahu! — komandoi me zë të lartë toger Pirrua. Disa ushtarë morën djathtas

e majtas, të tjerët mbetën në vend dhe nxorën paqetat e cigareve.

— Prapsohu! — u dëgjua aty për aty zëri i komandantit. — Ne thamë se komandat duhen zbatuar me shpejtësi e shkathtësi. Me të dëgjuar komandën «Shpërndahu», ushtari vrapon nga rresh-ti, si të ketë rënë një bombë diku pranë, pastaj shkon atje ku ka punë. Kuptuat?? Kështu pra!

Ai i prapsoi disa herë, gjersa u bind se e kup-tuan si duhej vepruar. «Ja një oficer i ri, kërkues, energjik», — mendoi Guri dhe solli ndërmend se edhe në stërvitjet e mëparshme kishte vënë re se Pirrua përpiqej me të gjitha forcat t'ua mësonte ushtarëve çdo gjë me rrënjë e sipas rregulloreve.

— Shpërndahu! — komandoi sakaq oficeri. Ushtarët vrapuan disa hapa dhe qëndruan anës fushës, duke pritur komandën tjetër për mbledhje, dhe vetëm kur togëri ndezi cigaren, u grumbulluan grupe-grupe e nisën të bisedonin.

— Për besë, na e mori frymën, — tha njëri.

— Dale, xhan i vëllait, dale, merre shtruar Ehu, sa ka zanati!

— Shekuj do të më duken këta dy vjet.

— Sh-sh-t! — bëri shenjë i pari dhe tregoi me bishtin e syrit majorin që po afrohej.

Ushtarët i përtypën fjalët dhe i bënë vend në mes tyre.

— U lodhët? — pyeti ai dhe u zgjati paqetën e cigareve. — Kush e pi, shokë? Ndizeni.

Ata ngurruan në fillim, por buzëqeshja e ngrohtë e eprorit, vështrimi i çiltër, gazmor, ua hoqi si me dorë ngurrimin, kështuqë morën nga një cigare edhe ata që nuk e pinin.

— Ndizeni! — ju drejtua një ushtari, që rrinte i mënjanuar.

— Faleminderit.

— Nuk e pini?

— Jo.

— Shumë mirë bëni. S'ka ç'ju duhet farmaku.

Ata u panë disa çaste sy më sy, si të donin të blenin mendimet e njëri tjetrit. «Për këtë do të më ketë thënë kapter Hasani se nuk është në rregull me disiplinën. Po i dyti cili të jetë vallë? Ai atje?»

— Nga jeni ju? — pyeti të parin.

— Nga Librazhdi.

— Dhe quheni. . .

— Petrit Shkoza.

— Shumë mirë, shoku Petrit, — mërmëriti, si të vazhdonte një bisedë të lënë në mes, pastaj e ngriti zërin: — Me bujqësi jeni marrë, apo jo? Po ju? Nga Librazhdi jeni edhe ju? — ju drejtua shokut të tij. — Brenda nga qyteti? Si quheni?

— Zamir Laska.

— Po ju? — ju drejtua një të treti.

— Ushtar Çlirim Shpati, — u përgjegj ushtari në çast, duke marrë drejtpëdrejtim. Guri i buzëqeshi.

— Ja, kështu duhet të përgjigjet ushtari, — tha dhe i rrahu shpatullat Çlirimit.

— Epo, ai është i vitit të dytë, ka ngrënë një thes me kripë në ushtri, shoku major.

— Më duket se bashkë kemi biseduar atë natë, natën e parë që erdhe këtu. Ju ishit me shërbim, apo gabohem, shoku Çlirim?

— Po, shoku major, me shërbim isha, — dhe

ushtari hëngri inat me veten që u skuq ashtu, si një vajzë e turpshme, kur kujtoi se i kishte propozuar eprorit të ndizte një cigare në shtrat.

— E di? Më thuaj thjesht «shoku Guri». Kështu është më mirë. Apo jo? Gradat janë punë ditësh. Ta mësojmë gojën që tani. Po, si e kishit emrin ju? Çlirim Shpati?

— Si urdhëron, shoku... Guri.

— Shpati, — përsëriti ai me zë të ulët dhe humbi në mendime. — Se ku e kam dëgjuar këtë mbiemër... Se ku e kam dëgjuar...

— Është i biri i heroit të punës socialiste, traktoristit Nebi Shpati.

— Ashtu? Pa shiko, pa shiko. Dhe unë vrisja mendjen, ku e kam dëgjuar. — Ai u mat të pyeste edhe për diçka tjetër, po nuk arriti. Buria dha sinjalin e fillimit të orës tjetër. Toger Pirrua kërkoi leje e dha pa vonesë komandën për mbledhje:

— Toga, në vijë të zhdërvjellët për dy... Shpërndahu! Më shpejt, shokë, më shpejt... Toga...

Major Guri u kënaq kur vuri re se komanda i shkundi ushtarët nga plogështia dhe bëri buzën në gaz. «Djalë i gjallë,» — mendoi për komandantin e kompanisë dhe, tek e vinte re me ç'shkathtësi e dinamizëm i kryente veprimet, me ç'energji i komandonte ushtarët, ju kujtua padashur vetja e tij, pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, kur ishte në moshën e Pirros e kryente edhe ai detyrën e komandantit të kompanisë.

Ushtarët e rinj i numëronin ditët me gishta. Të shumtën e herëve u dukej sikur koha ishte mbërthyer në vend dhe nuk lëvizte. Ditët dhe javët e para në ushtri u dukeshin aq të gjata, aq të ngjashme, sa shpesh nuk ishin në gjendje t'i dallojnë nga njëra-tjetra. «Vazhdimisht e njëjta punë, asgjë interesante, — thoshte Zamiri. — Nuk ngopesh as me gjumë, as me bukë. Tani ha, tani të merr prapë uria.» «Gjithnjë të hapet goja, — e plotësonte Petriti, duke u shtritur. — Sa shtrihesh në krevat, të duket sikur bie buria: ti-ta-ta-ti. Çuditësh kur të thonë se ke fjetur shtatë orë. «Çohu!» të thërret posta në rrëzë të veshit dhe të heq pa të keq batanien. Pastaj vrap në gjimnastikën e mëngjezit, vrap për t'u larë, vrap në trenazh... në stërvitje dhe përsëri në trenazh, në... Oh vetëm emrat ndërrojnë, po e njëjta gjë janë, në daç thuaji «trenazh» në daç «stërvitje». Ujë në djersë bëhesh. Le pastaj kapter paragrafi! Ku të lë ai të marrësh frymë? Edhe në gjumë e dëgjoj zërin e tij: «Vrap! Vrap!» dhe kërcej përpjetë. Një natë desh u rrëzova nga krevati».

Këto fjalë Petriti i përsëriste shpesh. Në fillim shokët e dëgjonin me njëfarë kureshtje, po pastaj nisën të mërzhiteshin. «Edhe ti, Petrit, gjithnjë në një brimë i bie fyellit!» Ai i vështronte me inat, zinte ndonjë qoshe dhe zhytej në mendime. Në kësi rastesh, para syve i delte Flutura, me buzën në gaz dhe vështrimin të përqëndruar, sikur kërkonte vazhdimisht diçka e nuk e gjente.

«Flutur! — mërmëriste nëpër buzë. — Ja kanë

gjetur tamam emrin që i përshtatet. Tamam si flutur endet rrugëve të fshatit!» Dhe i dukej sikur ajo i afrohej krahë lehtë, e rrëmbente, kapërcente fusha e male dhe e shpinte atje, në mbrëmjen e vullzimit, e para mbrëmje në fshat, ku të rinjtë kishin shkuar drejt e nga mbledhja e organizatës, pa prindërit e babagjyshët. Petriti dhe Flutura qëndronin përball njëri tjetrit. Ai ja kishte ngulur sytë dhe nuk ja hiqte kurse ajo e ndjente që larg atë vështrim. Qe bërë lulëkuqe në fytyrë dhe nuk guxonte të lëvizte as qepallat. Ishte mpirë e tëra nga një ndjenjë e çuditshme, që nuk e kishte provuar herë tjetër. I dukej sikur zemra do t'i dilte nga krahërori e nuk ngopej me frymë, siç i kishte ndodhur edhe në mbledhjen e rinisë. Ata kishin zënë vend pranë e pranë dhe as që dëgjonin se ç'flisnin rreth tyre. Në një çast, ashtu krejt papritur — Petriti i pat mbërthyer dorën dhe ja kishte shtrënguar fort. «Flutura, unë...» dhe i kishte pëshpëritur edhe diçka me zë të ulët. Diçka që as ai vetë nuk e kishte dëgjuar, po që ajo e kishte kuptuar shumë mirë. Dhe që skuqur e tëra. Më në fund kishte ngritur sytë dhe e kishte kryqëzuar vështrimin me të tijin. Sa shumë shprehte ai vështrim! Petritin s'e mbante vendi nga gëzimi. «Flutura!», i kishte mërmëritur sërish. Po nuk kishte arritur të shtonte tjetër.

— Shokë, është bërë një propozim, që ta mbylлим mbledhjen mbi luftën kundër zakoneve prapanike dhe, kështu siç jemi, të qëndrojmë në mbrëmje vallzimi, — tha ai që drejtonte mbledhjen.

— Dakord! — thirrën disa veta në një gojë.

— Ju bëni si t'ju vijë për mbarë, — shtoi

një tjetër. — Unë për veten time do të shkoj. Nuk kam leje nga prindët.

— Ose të gjithë, ose asnjë.

— Si ore, të gjithë! Ç'kuvendoni kështu kodra pas bregut.

— Mirë që ne jemi djem, po vajzat?

— Edhe ato. Unë do të zë derën e nuk do të lë asnjëri të dalë, — dhe ai që foli, një i ri shtat-lartë e i fortë, si një lis, i vuri derës shpatullat e tij të gjera.

Në sallë u bë një pështjellim i madh. Disa vajza u përpoqën të dilnin, po nuk mundën. Me to ishte edhe Flutura. Ajo edhe donte të shkonte, edhe i pëlqente të qëndronte. Me dy mendje rrinte mbështetur afër derës. Ishte si në ethe. Dridhej e tëra. Ç'do të thoshte babai kur ta merрте vesh? Po ata të tjerët...? Njerëzit e... Fundi le të thoshin ç'të donin. Ajo as që do të bëhej merak. Mjaft që babai të mos i thoshte gjë.

Ndërkohë, Arbeni, mësuesi i fshatit, mori fizarmonikën e filloi t'i binte. Në fillim kërcyen devolliçen. Pastaj në vatrën e kulturës u derdhën një mori tingujsh të gëzueshëm.

— Tango, shokë e shoqe, tango! — thërriti me të gjithë zërin ai që i kishte vënë shpatullat derës.

Për disa çaste askush nuk guxoi të ngrihej. Herë pas here, mbi tingujt e fizarmonikës ngrihej zëri i djaloshit shpatullgjerë! «Tango! Hë, mo, ç'më bëni naze? Kërceni, se nuk vjen më ky rast. Guxim, shokë, guxim. Yaaa... Tango!» Meloditë u ndërruan disa herë dhe djali nga dera u ngjir së thirruri, gjersa Selmani, sekretari i organizatës së rinisë, ftoi të kushërirën në vallzim. Pas tij u

ngritën tri katër çifte të tjera. Ata vërtiteshin me vështrësi, duke vështruar këmbët e duke numëruar me zë: Një-dy-tre, një, dy, tre! Flutura qe dhënë e tërë pas numërimit, që kur e kur mposhte edhe tingujt e fizarmonikës, kur para saj qëndroi dikush. E ndjeu se Petriti e ftoi në vallzim. Ajo u skuq e tëra dhe u mblodh grusht te qoshja, po shoqet nuk e lanë të qetë dhe ajo nuk e kuptoi as vetë se si u gjend në krahët e tij. Të dy qëndruan pranë e pranë dhe lëviznin këmbët si u vinte për mbarë. Do të donin që mbrëmja të mos mbaronte kurrë. Por ja, befas dera u hap me tërsëllimë dhe në sallë u fut i ati i saj, bashkë me disa moshatarë të tjerë, që shfrynin nga inati. Ajo ndjeu dorën e të jatit që ja shtrëngoi krahun si darë dhe e tërhoqi përjashta. Por nuk i bënte përshtypje asgjë. I dukej sikur ishte gjithnjë në krahët e Petritit, që e vështronte, e vështronte dhe i pëshpëriste diçka në vesh...

Kujtimin e asaj mbrëmjeje Petriti e kishte ruajtur të plotë e të freskët në mendjen e tij. Sa herë ndodhej vetëm, mendohej të përfytyronte edhe hollësitë më të vogla që kishin të bënin me mbledhjen e organizatës dhe me mbrëmjen e vallëzimit, duke harruar çdo gjë që e rrethonte aty, edhe veten e tij. Puliste sytë dhe i dukej sikur e kishte pranë Fluturën, sikur e shihte tek zbriste kodrës me shtamën në kokë e shkonte në burim për të mbushur ujë, ku ishin takuar disa herë pas mbrëmjes së vallzimit. Atje e kishte parë edhe atë mëngjez që ishte nisur për ushtar. Ajo e dinte se do të ikte atë ditë, e kishte përgjuar dhe, kur ishte nisur, kishte marrë shtamën e kishte zbritur teposhtë

kodrës. Petriti kishte mbetur disa hapa prapa atyre që e përcillnin, ishte ngjeshur pas një lisi dhe e kishte përshëndetur me dorë. Ajo kishte vështruar një çast rreth e qark, pastaj e kishte mbledhur veten dhe e kishte përshëndetur duke tundur shaminë. Dhe nuk ishin parë më. Po edhe tani, që ishte ulur e po tymoste duhanin, Petritit i dukej sikur e kishte përpara, të lehtë e lozonjare, duke i tundur nga larg shaminë. «Si do t'ja bëjë e gjora vajzë, — mendoi dhe ndjeu sikur ja shtrënguan me dorë krahërorin. Keq e ka me babanë, me të fejuarin. Shumë keq. Kurse unë... E ç'mund të bëj unë! I kam shkruar tri-katër letra, po ajo gjithnjë hesht...» — dhe hoqi rripin e mesit e bëri me majën e briskut një vijë në anën e brendshme. «Iku dhe një ditë, — tha i kënaqur. — Mbetën edhe... Po vërtet edhe sa ditë mbetën? — Edhe shtatë-qind e pesë ditë! Bo-bo, sa shumë! Domethënë qindra viza. E ku i merr rripi të gjitha këto? Duhet gjetur një vend tjetër ku t'i shënojmë», — fliste me zë të ulët, duke dashur ta largonte mendjen nga Flutura dhe ecte ngadalë, në drejtim të fjetores. Zamiri ishte me shërbim. E kërkoi me sy nëpër fjetore, po nuk e pa gjëkund. Atëhere u ndal te dera. E ktheu përgjysmë. «Ja, këtu mund t'i bëjmë vizat», dhe nisi të shënonte me laps në një kënd. «Një, dy, pesë... dhjetë».

— Ç'ditë është sot, o shokë?

— E martë.

— Si ore e martë!? Kjo qenka e tmerrshme.

Kur do të vijë e shtuna?

— Pas katër ditësh, — ja ktheu Andoni.

Petritit nuk i erdhi mirë, po shokët qeshën pa të keq dhe ai u çapit më tej.

Ditët rridhnin njëra pas tjetrës dhe ushtarëve të rinj nuk u bënte më përshtypje as jaka e mbërthyer, as rripi i shtrënguar i mesit. Çdo ditë që kalonte, mësonin diçka të re dhe javët e muajt nuk u dukeshin më të gjatë si njëri tjetri. Në mësimet që zhvillonin, në shoqërinë dhe në vetë jetën ushtarake, syri i tyre u mësua të dallonte mjaft gjëra interesante, të cilat nuk kishin mundur t'i zbulonin më parë. Bie fjala, pas një stërvitje në teren të thyer, në shi e në furtunë, ata e ndjenin veten të lodhur, por edhe të fortë, kurse pas një natë shërbimi pranë depos buzë përroit, kur kishin qëndruar disa orë të rrethuar nga errësira dhe heshtja e thellë, me automatikun e shtrënguar mbi gjoks, u dukej sikur kishin qenë në një botë tjetër, në botën e guximtarëve, të cilën e kishin njohur shumë pak gjer atëhere. Sa më shumë kohë kalonte, aq më pak dalloheshin ushtarët e rinj nga të vjetrit. Ata qenë shkrirë e bërë një.

Vetëm Petriti me Zamirin bënë përjashtim. Çdo ditë që kalonin në repart i afronte gjithnjë e më shumë. Kjo ngjiste jo vetëm sepse ishin të dy nga një krahinë, por sidomos sepse kishin zbuluar te njëri tjetri shumë gjëra të përbashkëta: të dy ishin kokëfortë, të përkëdhelur, nuk u pëlqente të shoqëroheshin me të tjerët; mundoheshin t'u bënin bisht detyrave.

Edhe atë ditë që reparti u gdhi në festë, se do të bëhej betimi, ndërsa të gjithë qeshnin e bisedonin të gëzuar, duke pritur me një ndjenjë padurimi sa të jepej urdhëri për rreshtim, ata të

dy qëndronin veç shokëve. Petriti kishte mbyllur sytë dhe e kishte tretur mendimin larg, në fshatin malor, ku zbriste Flutura me shtamën në kokë, ndërsa Zamiri kujtonte sektorin e fermës, ku kishte punuar si agronom i mesëm. Sa mirë kishte qenë atje! Vërtet që shumicën e kohës e kalonte fushës dhe lodhej duke kontrolluar plugimet, mbjelljet, prashitjet, shërbimet bujqësore, por ndjente kënaqësi që të gjithë ja dëgjonin fjalën, e respektinin, kurse, kur shkonte në shtëpi, e priste nëna me gaz në buzë e me gjellën e ngrohtë pranë vatrës. «M'u lodhe, biri i nënës. Të pastë nëna, m'u lodhe», — i thoshte ajo dhe i qëndronte qiri në këmbë. Ajo përpiqej t'ja plotësonte të gjitha dëshirat, si djalë të vetëm që e kishte. Këto e kishin bërë Zamirin njeri tekankos e të rrëmbyer. Kujtonte se edhe në ushtri, si njeri me shkollë e agronom i mesëm, do ta mbanin si ujët e pakët e as që do të merrej me stërvitje. Do t'i linin në dorë vetëm ekonominë ndihmëse të repartit dhe do t'i thoshin: «Nga ti, or shok i dashur, s'duam gjë tjetër, mjaft të na ndreqësh punët e ekonomisë». Po nuk ndodhi kështu. Ditët e para treguan vërtet një farë interesimi për të, por kur vunë re në sje-lljet e tij një qëndrim prej kapadaiu ja ndiqnin me një vëmendje të veçantë çdo çap që hidhte. Le pastaj kapter paragrafi. Me të as që arrinte të merrej vesh. Një e dy dhe:» Ushtar Zamiri, mba radhimin, çoje hapin, çoje! Vështro përpara! Mos fol në rresht, ushtar Zamiri!» Sa inat i vinte në këto raste! I fliste vetëm atij, sikur të tjerët nuk gabonin kurrë! I nervozuar kthente kokën dhe matej t'i thoshte diçka, po e ngatërronte më keq

hapin. Kurse kapteri ja niste prapë nga e para: «Mos e prish hapin, ushtar Zamiri. Vështro drejt. Mbulo shokun...»

Kështu edhe atë mëngjez. Sa arritën në vendin e rreshtimit, ja zuri disa herë emrin në gojë. Ç'njeri, kallup fare! Dhe kushedi a do të fliste kështu me vete, po të mos kishte dëgjuar që larg një zë gazmor. Ktheu kokën dhe pa Andonin që vinte duke vrapuar.

— Vini re, shokë! Një lajm me rëndësi — thirri Andoni.

Shumë veta, ndër ta edhe Zamiri me Petritin, e rrethuan në çast. Ushtari beson shpejt. Ai sikur pret çdo ditë të dëgjojë diçka të re, të papritur.

— Si është puna? Ç'ka ngjarë?

Andoni merrte frymë me nxitim nga vrapimi dhe nuk përgjigjej. Vetëm thoshte:

— Vini re, një lajm me rëndësi.

— Hë, de, folë.

— Qetësi, shokë. Tani do ta them.

Të gjithë heshtën, thua se nuk merrnin frymë.

— Folë, se ta ngjesh.

— Sot, shokë, ... do të bëjmë betimin.

Disa qeshën me shakanë e shokut. Të tjerë rrudhën vetullat të pakënaqur dhe nisën ta shanin, kurse Petriti u tërhoq mënjanë e nuk nxori zë.

Ceremonia e betimit filloi në orën dhjetë. Me t'u dhënë komanda «Eja në radhë», mbi fushë u end një heshtje e thellë, solemne. Ushtarët qëndronin përballë tribunës. Rreshtat e tyre dukeshin nga larg si mure të ngjeshura pranë njëri-tjetrit, mure helmetash dhe bajonetash. Ata ishin mble-

dhur dhe herë të tjera aty, përballë tribunës, po sot e ndjenin se kishte diçka që i jepte rreshtimit një kuptim të veçantë, që më shumë ndjehej se sa kapej me sy.

Në tribunë kishin zënë vend shokë të komandës eprorë dhe përfaqësues të pushtetit në rreth. Foli major Guri. Ishte një përshëndetje e shkurtër, por çdo fjalë e peshuar mirë, që të hynte në zemër. E mori fjalën edhe një nga shokët e ardhur, veteran i luftës. Ai tregoi se si ishte betuar njëzet e ca vjet më parë, së bashku me shokët, në një qeli burgu. Fashistët përgjonin përjashta, kurse nga tavani i qelisë dukej sikur varej nyja e litarit që donin t'u hidhnin në grykë armiqtë. Por ata qenë afruar kokë më kokë, kishin shtrenguar grushtet dhe i kishin premtuar shoku shokut se do të qëndronin të papërkulur gjatë torturave e do të jepnin edhe jetën buzagaz po ta lypte nevoja; po fjalë nuk do të nxirrnin nga goja. Dhe ata nuk i kishte përkulur asgjë, as plumbi dhe as trekëmbëshi i armikut.

— I tillë ishte betimi ynë, betim lufte, betim llogoresh, që ta bënte zemrën më të fortë se çeliku, — e përfundoi fjalën veterani. Pastaj u kujtua se diçka kishte harruar dhe shtoi: — Dhe ne gëzohemi kur shohim në fytyrat tuaja, në sytë tuaj, të njëjtën gatishmëri e vullnet të pathyer për t'i shërbyer partisë, atdheut, lirisë.

Fusha oshëtiu nga brohoritjet e fuqishme. Kur ra heshtja, komisar Guri nxori përpara një tabak letër, ku ishte shkruar formula e betimit dhe nisi të lexonte: «Unë, qytetar i Republikës Popullore të Shqipërisë, betohem me nderin dhe jetën

time...» Fjalët e tij i përsëriti një kor i madh bu-
rrash, që bëri të tundej i tëri vendi. Zërat e tyre
bashkoheshin me njëri-tjetrin, ngriheshin lart, për-
plaseshin në shkëmbin e thepisur përballë. Atje
sikur bëheshin më të fuqishëm, si të merrnin me
vete diçka nga fortësia e shkëmbit, dhe kthehe-
shin përsëri në fushë, bashkoheshin me zërat e
tjerë të ushtarëve dhe pushtonin gjithë qiellin.

Petriti nuk e kishte menduar se betimi do ta
emociononte aq shumë. Shumë ditë me radhë ai
e kishte përsëritur me shokët formulën e betimit,
sa e kishte mësuar çdo fjalë përmendsh, por asnjë-
herë tjetër nuk i kishte shqiptuar ato me një
mënyrë të tillë. Teksa i përsëriste, kishte shtrënguar
fort grushtet, kishte tendosur muskujt dhe e ndjen-
te se si i bëhej trupi mornica mornica.

...«do të jem ushtar trim, i disiplinuar... vi-
gjilent»... fliste me sa i hante zëri dhe, pa e kup-
tuar, e kishte hedhur vështrimin në kodrën përballë
repartit. Dhe i ngjante sikur këto fjalë ja rrë-
mbente era nga goja dhe i përcillte larg, te fshati
i tij, te prindërit dhe vëllezërit, te Flutura. I dukej
sikur ato fjalë i dëgjonte i madh e i vogël, tërë at-
dheu. Edhe kur fjalët e fundit të betimit qenë
përplasur në shkëmb dhe qenë tretur në hapësirë,
atij i kumboi në vesh edhe për një kohë ai kor bu-
rrash, në të cilin shkrihej edhe zëri i tij.

— Qenke djersitur! — i tha Zamiri.

— Edhe ti, — ja ktheu ai.

— Më kishte thënë Çlirimi, por unë kurrë s'e
kisha menduar kështu.

— As unë. Qenka vërtet diçka interesante...

— Dhe e... bukur.

Ata i buzëqeshën njëri tjetrit. Pastaj nënshkruan formulën e betimit. Firmat e tyre u futën në mes firmave të tjera, ashtu siç qenë përzier e shkrirë ata me shokët në një repart. Edhe atje, në letër, ato firma qëndronin si ushtarët, në rresht, me armët në dorë e bajonetat mbërthyer, për t'ju bërë gardh atdheut në rast nevojë.

* * *

Dy javë pas transferimit, Gurit i dhanë shtëpi. Të nesërmen ai shkoi në Tiranë dhe mori familjen. Majlinda atë natë nuk mundi ta fshihte mërzitjen. Qyteti i dukej i vogël, me rrugë e sheshe të ngushta dhe shumë i qetë, më i qetë nga ç'mund ta përfytyronte. Po Guri i tha se do të mësohej shpejt, se njerëzit ishin shumë të mirë, të afrueshëm, se kishte një kinema të vogël e të këndshme, kurse rreth qytetit vende të bukura, ku mund t'i kalonin gëzueshëm ditët e pushimit. Megjithatë, edhe pas ardhjes së gruas, ai gati gjithë ditën, nga mëngjezi gjer në mbrëmje vonë, e kalonte në repart.

Një natë u vonua më shumë se herët e tjera, ndaj gjithë rrugës, nga reparti në shtëpi, vriste mendjen të gjente një shkak që të justifikohet. Po, kur çeli derën e hyri në apartament, u ndodh para një të papriture. Sa u fut brenda, ajo i thirri në mënyrë të çuditshme e me një zë që nuk ja kishte dëgjuar herë tjetër.

— Mbylle, mbylle derën! — dhe mbështolli diçka në gjoks. Bebet e syve të saj ju dukën të zmadhuara. Fytyrën e kishte tërë djersë. U tremb.

— Ç'ka ngjarë?! — e pyeti i shqetësuar dhe u afrua të shihte ç'kishte mbështjellë me çarçaf. Në atë çast dëgjoi një zë të hollë fëmije, që nisi të qante me dënësë.

— Mos është Ditka sëmurë?

Ajo ja bëri «jo» me kokë dhe vazhdonte ta shikonte në një mënyrë të çuditshme.

— Po më habit, Linda. Unë s'po kuptoj asgjë. Ç'ke kështu?

— Si ç'kam? Nuk e kupton? Ja, e lava vetë vajzën. Po, po, vetë, me këto duar. Komshia shkoi në kinema.

Guri vuri të dy duart në bel dhe qeshi me gjithë zemër. Ajo rrudhi vetullat dhe e vështroi me habi.

— E lave vetë?! Dhe unë vrisja mendjen të gjeja se ç'punë të madhe do kishe bërë!

— Pse gjë e vogël të duket?

Guri vazhdoi të qeshte.

— E përse të mos qeshësh? — vazhdoi të ankohej Majlinda. — Ty të duket shaka, po unë e di se ç'hoqa! Më dukej se do t'i thyjeja ndonjë dorë a këmbë, ose do të rrëshqiste e do të mbytej. Po ti kështu je. Mos të të vijë keq. As që e kupton gëzimin e nënës që ka larë vetë fëmijën dymuajshë. Ti disa herë nuk më kupton mua. Tërë dashurinë e ke hedhur në ushtarët. Nuk them të mos i duash, po jo dhe kështu. As që pyet për grua, për fëmijë, për punët e shtëpisë.

Majlinda fliste, fliste, kurse ai e dëgjonte buzagaz. Në këto raste ajo nxehej shumë, po ai ja dinte huqin: e linte sa t'i binte inati — dhe kjo zgjaste vetëm tri-katër minuta — pastaj afrohej, e merrte me të mirë dhe çdo gjë kthehej në gjend-

jen e mëparshme. Kështu veproi dhe tani. Majlinda dalëngadalë u zbut, i harroi ato që kishte thënë dhe nisi të vishte me kujdes Ditkën e vogël. Pas larjes, fëmija kishte marrë ngjyrë rozë, thuase transparente, dhe lëvizte papushuar duar e këmbë.

— Pa shih ç'sy ka, bojë qielli. Dhe ç'vetull të hollë, të bukur, me hark! Tamam si ç'e kisha ëndërruar unë.

— Po ku i ka vetullat kjo, moj grua?! Unë as që ja dalloj.

— Nuk ja dallon? Vërtet thua? Ua, sa i çuditshëm! Po ja, ja, nuk e shikon si po i del?

Dhe qeshën të dy, duke u përkulur mbi fëmijën e duke e shikuar me minuta të tëra. Vogëlushja dhe çdo gjë përreth ju duk tërheqëse, e bukur dhe e këndshme. Befas Guri e ngriti përpjetë, zuri t'i qeshte e ta përkëdhelte, mirëpo ajo u tregua mospërfillëse: lëvizte duart në hapësirë, si të donte të kapte diçka që e shihte vetëm ajo. Atëhere Guri qeshi me gjithë zemër dhe ju duk sikur ja largoi njeri me dorë lodhjen e ditës.

Ai kalonte në shtëpi çaste me të vërtetë të lumtura. Megjithëse kishin më shumë se dhjetë vjet që ishin martuar, burrë e grua e donin njëri tjetrin me po atë zjarr, si në muajt e parë të martesës. Natyrisht, tani tregoheshin më të qetë, më të përmbajtur në marrëdhënjet e tyre, po e ndjenin se ishin afruar aq shumë, sa nuk mund ta kuptonin veten pa shokun. Ditka kishte hyrë si një lule mali në jetën e tyre, e freskët, me ngjyra të nderzura dhe kundërmuese. Si e vështrojnë, sa i gëzoheshin! Çdo tipar, çdo lëvizje e saj dhe çdo guitje, u dukej e jashtëzakonshme.

Çastet më të bukura i kalonin në mbrëmje. Jo vetëm kur tregonin ngjarjet e ditës apo dëgjonin radion, duke u vështruar në bebe të syrit, po edhe kur merrej secili me punën e vet. Shpesh, pasi tregonin të rejat e ditës, Guri merrte një libër në dorë dhe niste të lexonte. Në këto raste dukej sikur harronte çdo gjë, ndaj Majlinda, sadoqë lexonte edhe vetë shumë, nuk e linte të qetë:

— Ja, edhe ti me këto libra! Më trego më mirë diçka. Të kam thënë: kur jemi bashkë...

Guri zakonisht i buzëqeshte dhe vazhdonte leximin. Po atë mbrëmje, ndryshe nga herët e tjera, pasi shkëmbyen fjalët e zakonshme, Guri nuk e mori librin të lexonte.

— Pa hë, na thuaj, ç'të reja kemi nga shkolla juaj — e pyeti ai.

— Ti gjithnjë nga unë i pret të rejat. Kurse vetë hesht si memec. Epo, helbete, punë ushtarake. I di komanda! Apo jo?

Guri qeshi. Ai vërtet nuk e kishte zakon të fliste në shtëpi për punët e **repartit**.

— Doemos punë ushtarake. **Po** nuk na the, si doli ai diskutimi?

— Nga e di ti se kemi diskutuar? Kush të tha? Takove ndonjë nga arësimtarët?

— Jo, por unë të kuptoj. As vetë nuk e di se si, por ja që të kuptoj. Vë bast nëqoftëse sot nuk je ngrënë me shokët.

Dhe në të vërtetë ashtu kishte ndodhur. Ajo ju ul pranë dhe i tregoi se si, në pushimin e gjatë, njëri nga arësimtarët kishte treguar për një nxënëse, më të pa disiplinuarin në shkollë, që zakonisht endej rrugëve e nuk mësonte, po që atë ditë

u qe përgjegjur shumë mirë pyetjeve, më mirë nga nxënësi më i dalluar, më i sjellshmi i klasës, i cili asnjëherë nuk i ndante fjalët nga qëndrimi në shkollë dhe jashtë saj. Mësuesi ishte zënë ngushtë. Ç'notë duhej t'i vinte njërit dhe ç'notë tjetrit?

Në fillim pyetja u duk e thjeshtë, por, duke çfaqur mendimet, arësimitarët ishin ndarë në dy grupe. Disa thoshin se pedagogu çmon përgatitjen e nxënësit për mësim e jo «biografinë», e të tjera, të tjerë tregoheshin më të gjerë e mbronin mendimin se nota nuk duhej marrë krejt e shkëputur nga sjellja dhe qëndrimi i nxënësit. Dalëngadalë diskutimi u hodh në një teren tjetër: a ishin të domosdoshme notat, apo mund të bëhej dhe pa to? A do të vinte një ditë që të fshiheshin nga defteri?

— Dhe ç'mendonin shokët?

— Disa kërcyen përpjetë, të tjerët e morën më shtruar. Thoshin se një ditë, me siguri, përgatitja e nxënësve nuk do të çmohej me notë.

— Po ti, Majlinda, e çfaqe mendimin tënd?

— Natyrisht.

— Dhe the se, po të hiqen notat, do të pri-shet bota?

— Aspak. Përkundrazi. Unë mendoj se notat nuk janë të përjetshme, se mendimi kolektiv i arësimitarëve, do të gjejë me siguri një formë tjetër për të çmuar shkallën e njohurive të nxënësve, që t'u përgjigjet më mirë kushteve të reja të zhvillimit të shkollës dhe gjithë shoqërisë sonë, që...

Ajo fliste e fliste me pasion, kurse Guri dëgjonte i kënaqur.

— Për besë, Majlinda, ti po më çudit shumë.

— Ashtu? Kurse unë them se këtu nuk ka asgjë për t'u çuditur.

— Ndoshta ti ke të drejtë. Sidoqoftë, mua më duket se, sa më shumë kohë shkon, aq më tepër zbuloj tek ti një shoqe të denjë jete.

* * *

... Pas stërvitjes së ditës, Guri kishte ngrënë drekë në bufenë e repartit dhe ishte mbyllur disa orë në zyrë për të lexuar shtypin dhe për të nxjerrë andej detyra, sidomos mbi spastrimin e programeve dhe të rregulloreve nga pjesët e tepërta e të panevojshme, para se ta shtronte këtë problem me ushtarët. Kishte ditë që në repart, ashtu si në tërë ushtrinë, po bëheshin diskutime të gjalla e interesante. Ushtarë e oficerë shkëmbenin gjerësisht mendimet si duhej t'u përgjigjeshin sa më mirë problemeve të shumta që shtronte Letra e hapur. Jeta, stërvitja, programet, rregulloret, dhe çdo gjë i ishte nënshtruar gjykimit të masës, kritikës së rreptë të ushtarëve. Dhe këto mendime duheshin drejtuar atje ku duhej.

Kur mbaroi punë, ndjeu nevojë të çlodhej, të bisedonte me ushtarët. I gjeti ata të mbledhur në dhomën e kulturës. Sa hyri brenda, diskutimet u prenë, po ai e ndjeu se kjo nuk do të zgjashte.

— Ç'ka ngjarë, shokë? Apo keni ndonjë «çështje të brendshme», të cilën...

— Jo, shoku komisar, — ata nuk i drejtoheshin më «zëvendës për punë politike», ose «major», por

«komisar». — Ju mund të qëndroni. Madje ne deshëm të dërgonim disa shokë tek ju e të kërkonim mendimin tuaj.

— Kur është kështu, po ju dëgjoj, — dhe u ul në tryezën e parë, ku i bënë vend.

— Puna është, — vazhdoi Çlirimi, i cili drejtonte mbledhjen, — se Zamiri ka bërë një gabim të pafalshëm. Ju e dini se pardje, gjatë shërbimit, nuk u gjend i gatshëm në vendroje. Për këtë e kritikuan, i hoqën vërejtjen dhe ai premtoi se...

— Premtoi, premtoi. Arresti i zgjidh këto punë, or babaxhan. Që kur është hequr burgu, kërcen valle Zamiri me shokë dhe as që pyet kush je ti e ç'thotë rregullorja. — ndërhyri Hasani.

— Nuk është halli atje, — e ngau fjalën Çlirimi, — u bë shumë mirë që u hoq arresti. Edhe si fjalë, jo më si përmbajtje, ai nuk ka asgjë të përbashkët me ushtrinë tonë.

Dhe Çlirimi tregoi se, pak më parë, Zamiri kishte fyer rëndë bahçevanin e repartit, i cili gjoja qenkej pisqollë e nuk merrkej vesh nga bujqësia, duke cënuar kështu rregullat e mirësjelljes e duke prekur drejtpërdrejt, siç thoshte ai, «marrëdhënjet e ushtrisë me klasën punëtore». Dhe, kur kishte ndërhyrë pastaj kapter Hasani — ndoshta pa takt, por sidoqoftë me të drejtë — Zamiri kishte bërë një gabim të dytë e i qe përgjegjur me fjalë krejt të pahijshme për ushtarin. Dhe kjo nuk ishte aspak e rastit. Ai ishte shumë i rrëmbyer, nuk i përfillte shokët, tregohej i pavëmendshëm në stërvitje, sadoqë kishte mundësi më të mëdha për të mësuar nga shumë të tjerë.

— Ju keni të drejtë — tha Guri, duke vështru-

ar Zamirin, të cilin shokët e kishin nxjerë në një tryezë të veçantë, si në bankën e të akuzuarëve, — dhe ne, — vazhdoi ai, — nuk duhet ta lëmë mënjane shokun që ka gabuar. Përkundrazi, ta mbajmë pranë. Ai është njeriu ynë, shoku ynë, — dhe Guri u ngrit e zuri vend përkrah Zamirit. — Po mendoni ju se ç'duhet bërë për ta vënë shokun Zamir në një radhë me kolektivin?

Çlirimi nuk e priste një qëndrim të tillë të afrueshëm nga komisari dhe u hutua për disa çaste. Pastaj nisi të fliste i pavendosur:

— Një ditë ju na keni thënë se, gjatë luftës, kur një partizan çënoi marrëdhënjet me popullin, ja hoqët pushkën për disa javë.

— Po, dhe për atë kohë kjo ishte një masë e domosdoshme. Apo jo? — tha mendueshëm Guri, duke e kuptuar se ku do të dilte fjala.

— Natyrisht. — Çlirimi u përtyp dhe u mendua si të vazhdonte. — Kolektivi propozon t'ja heqë edhe Zamirit pushkën për ca muaj, ta caktojë t'u shërbejë derrave, gjersa të japë prova se e ka kuptuar gabimin dhe është korigjuar.

Kapter Hasanit nuk ju durua:

— Por unë ju thashë, shokë ushtarë, se kjo, sadoqë është një masë e fortë, nuk parashikohet në rregulloret tona, — foli ai me rrëmbim dhe vështroi nga komisari.

— Ajo s'na prish ndonjë punë, — ndërhyri Guri, — Nuk prish asnjë punë. Kolektivin duhet ta shqetësojë fakti në ka ardhur apo jo koha, është apo jo e domosdoshme të merret kjo masë. Unë mendoj se jo. Jam i bindur se Zamiri ka forca të

korigjohet edhe pa ju nënshtruar një mase të tillë, pa ja hequr armën. Apo jo, shoku Zamir? Ç'mendon ti?

Zamiri ishte hutuar e nuk e mblidhte dot veten. Guri e vuri re se si i dridheshin duart, se sa shumë i kishte kushtuar mbledhja, ndaj edhe nuk nguli këmbë që të përgjigjej aty për aty.

— Nëqoftëse nuk kanë kundërshtim shokët, unë propozoj që, hëpërhë, të mjaftohemi me kritikën e rreptë që ju bë dhe të kemi besim se Zamiri nuk do të bjerë më në të tilla gabime. Apo jo, Zamir?

— Si urdhë-ron! — u përgjegj ai me dënësë.

— Po ju, shokë ushtarë, dakord jeni?

Disa kundërshtuan, po shumica e miratoi mendimin e komisarit. Ushtarët u shpërndanë, duke vazhduar të flisnin me zë të lartë. Guri me Zamirin dolën të fundit. Ecën një copë herë të mirë pa folur, sikush me mendimet e veta, pastaj Guri u ndal. Qëndroi edhe ushtari.

— Dua të të bëj një pyetje, sadoqë ca të çuditshme, Zamir, — dhe komisari e vështroi ngultas. — Pardje, kur nuk u gjendët i gatshëm në vende-roje, dëgjova disa shokë të kuvendonin për ty. Në zjarr të bisedës, njëri nga ushtarët tha: «Ç'i duam fjalët e shumta? Nëqoftëse ndonjëri nga ne shkel rregulloret dhe merr nëpër këmbë disiplinën ushtarake, nuk duhet quajtur kjo si gjë e thjeshtë. Do parë puna më thellë. Unë, për veten time, them se, me sjelljet e tij, ai njeri prek diçka shumë të çmueshme: kompaktësinë e ushtrisë, vigjilencën, gatishmërinë e saj luftarake. Ndaj dhe ju pyes: e do apo jo ai ushtrinë, e çmon, kështu siç e duam

dhe e çmojmë ne, apo jo?» — Guri heshti një hop dhe i përsëriti pastaj fjalët e fundit. Zamiri u step.

— Urdhëro, shoku major? — pyeti i hutuar.

— Po, po. Nganjëherë puna shtrohet pikërisht kështu: e do apo jo ushtrinë ai që thyen rregullin, disiplinën, që dëmton gatishmërinë e saj luftarake. Me një fjalë si i zbaton ai porositë e familjes, kërkesat e atdheut, për të cilin ne e ruajmë si një gjë të shenjtë e të paprekshme këtë gatishmëri e jemi gati të hidhemi edhe në zjarr?

— Natyrisht që i dua, shoku komisar. Si të gjithë shokët edhe unë, — dhe, duke folur kështu, ushtari lëvizte, shtrëngonte duart, gjithë trupin, si të përpiqej të gjente një fjalë më të përshtatshme, më bindëse.

— Kurse shokët nganjëherë dyshojnë.

— Si është e mundur? Unë... — dhe përsëri nuk i gjente dot fjalët e përshtatshme për të shprehur të gjitha ato mendime që ja trazonin trurin në ato çaste — Unë...

— Po atëhere pse sillësh kështu? Pse nuk i zbaton rregulloret, pse e thyen disiplinën?...

Zamiri thujse nuk mbylli sy atë natë. I dukej sikur ishte gjithnjë në mbledhjen e lirë të kompanisë, sikur dëgjonte diskutimet e shokëve dhe vazhdonte në heshtje bisedën me komisarin. Mendohej të rikujtonte çdo fjalë që i kishte thënë ai. Vetëm ndaj të gdhirë dremiti ca. Dhe nuk ishte në gjendje të thoshte në ishte në gjumë, apo me sy hapur, kur e pa sërish veten në mes shokëve. Ata ishin vënë të gjithë në rresht, me armët në sup e pajimet ngjeshur pas trupit. Do të niseshin për

një stërvitje disa ditore. Edhe kuzhinjer Nesti kishte ngarkuar kazanët në kalë e kish hedhur karabinën krahë-qafë. Kurse ai... Ai mbante një stap në dorë dhe mendohej të nxirrte derrat në kullotë. Përpiqej të hapte derën, po ajo që mbante në dorë, që herë i ngjante me një shkop të gjatë e herë me pushkën, pengohej në pravazin e derës dhe nuk e linte të dilte. Andoni dhe disa të tjerë nisën të qeshnin. Ai u hutua dhe e humbi toruan. Në një çast desh të mbyllte derën e t'i fshehej vështrimit të shokëve, po në atë kohë u dha Komisar Guri. Ai i zgjati që jashtë karabinën, çantën e shpinës dhe e urdhëroi: «Shpejt në rresht. Zëre vendin tënd në mes shokëve dhe nisu në stërvitje...!»

Kur ra buria e zgjimit, ai u ngrit me përtesë nga shtrati. Ishte bërë qull në djersë.

* * *

Toger Pirros nuk i zinte këmba vend. Pasi dha urdhërin për hapjen e pozicioneve, kalonte nga një ushtar të tjetri, kontrollonte veprimet, bënte vërejtje dhe kërkonte të ndreqeshin në çast të metat, duke treguar, kur ishte e nevojshme, edhe si duhej vepruar. Pirrua ishte njeri kërkues. Qëllonte shpesh që ai të tregohej i rreptë dhe se kapter Hasani, po përsëri në veprimet e tij, ushtarët vinin re se kishte një logjikë të fortë dhe ishin të bindur se duhej vepruar pikërisht ashtu siç thoshte komandanti.

— Mirë e keni hapur pozicionin, por mos ha-

rroni: «armikun» duhet ta vrojtoni pandërprerë, — i kujtoi një ushtarit dhe kaloi më tej.

— Po ju, ushtar Petriti, ç'e keni atë? Furrrik pule? Pa futuni një herë brenda... Shtrihuni bar-kas... Merrni shenjim... E shihni? Gjysmën e trupit e keni përjashta. Si do të luftoni kështu?

Petriti ndërpreu punën dhe u kthye nga komandanti. U mat të thoshte diçka, të justifikohet, por e pa më të udhës të heshte. «Eh, lufta e shkretë! Ajo të mëson vetë si duhet vepruar, vëllaçko...» mendoi dhe vuri lehtë buzën në gaz.

— Natyrisht, stërvitja nuk është njëlloj si lufta, — tha komandanti si t'ja kishte kuptuar mendimet, — por si do ta vrasim armikun pa mësuar, pa u stërvitur? — Dhe mori lopatën e hoqi disa viza në tokë, duke shënuar madhësitë që duhej të kishin pozicioni. Pastaj e ndjeu se nuk kishte ç'të shtonin tjetër dhe shkoi më tej. Çlirimi as që e vuri re kur ju afrua. Ishte groposur, maskuar, kishte nxjerrë pushkën përpara dhe ishte kredhur në mendime. Komandanti i doli nga e djathta:

— Ç'mendon, Çlirim?

Ai donte t'i shmangej përgjigjes, po togeri nguli këmbë.

— Si të them? Ju, natyrisht, i dini më mirë këto punë. Po mua më duket se nuk e kemi zgjedhur mirë vendin dhe i kemi lënë «armikut» kuotën dominuese. Po ta zinte ai atë, mund të na shkulte pa shumë vështirësi këtej.

Pirrua u skuq. U mat disa herë ta ndërpriste, ta kundërshtonte. T'i thoshte se në mësimin që kishin përpunohej vetëgroposja e jo zgjedhja e vendit më të përshtatshëm për vendosje, se ai do

të bënte mirë t'i linte të trashat dhe ta hapte siç duhej pozicionin, por e kuptoi se Çlirimi kishte të drejtë. Aty për aty tundi kokën dhe nuk i tha asgjë, po, si u mendua mirë, mblodhi kompaninë, e nxori Çlirimin para rreshtit dhe tha se ai kishte bërë një vërejtje shumë me vend.

— Gjithnjë i pjell mendja këtij! — foli njëri me zë të ulët nga rreshti i dytë dhe e vështroi shokun me shpoti. — Në çdo stërvitje do të na nxjerrë ndonjë avaz. Të ishte kapter paragrafi këtu, me siguri do t'i thoshte: «Epo, meqë ditke kaq shumë, zotrote, urdhëro e zhvilloje ti mësimin!» Kurse toger Pirrua gjithmonë të jep hakun.

— Nuk i kemi thënë kot «strategu i kompanisë». Ai ka lindur për ushtarak, — ndërhyri Andoni.

Çlirimi dëgjonte në heshtje e, padashur, mendja i shkoi te diskutimi që kishte lindur disa javë përpara në repart mbi domosdoshmërinë e zbatimit të rregullores. Kjo kishte ngjarë pasi Petriti kishte nguruar të zbatonte urdhërin e nënoficerit. Në mbrëmje, ushtarët ishin mbledhur dhe kishin vënë në balancë qëndrimin e shokut të tyre.

Bëri shumë gabim Petriti, — kishin thënë ata. — Sipas rregullores...

— Hë, mo, se na e morët shpirtin me atë të shkretë rregullore. «Rregullorja kështu, rregullorja ashtu. «Epo dale, të shkretën, se ajo nuk është xham e thyhet, — ishte hedhur Andon shakaxhiu.

— Ç'do të thuash me këtë, o Andon?

— Dua të them që të mos merren gjërat kallëp.

— Pallavra! E di si i ka cilësuar një gazetar rregullore? Si melodinë e një kënge të bukur ushtarake, të hedhur në pentagram. Kështu ka shkru-

ar, më duket. Kur e sheh pentagramin, të ngjan si diçka e thatë, e vdekur. Po, kur e merr në dorë një muzikant dhe i lëviz gishtat mbi tasto a tela, kur i kthehen «shkarravinat» në tinguj, gjithçka sikur ndizet e merr jetë dhe ti habitesh kur dëgjon melodinë e bukur, të këndshme, e cila ishte fshehur në mes atyre vijave. Ja, kështu është edhe rregullorja.

Ushtarët kishin heshtur disa çaste, për ta rrokur më mirë kuptimin e krahasimit.

— Bukur e paska thënë.

— Do të ketë qenë poet.

— Po ti, Çlirim, pse s'flet? Apo bën strategjinë e madhe.

— Kam frikë se ndonjëri do të qeshë, po ta them hapur atë që mendoj.

— Jo, nuk e lëmë ne të qeshë.

— Atëhere mirë. Hajde ta pleqësojmë së bashku.

Dhe Çlirimi e kishte nisur nga biseda e major Gurit për Letrën e hapur, nga porosia e partisë për t'i rishikuar ligjet e për të hequr nga ato çdo gjë të tepërt, të panevojshme, të vjetëruar.

— Bjeri shkurt, vëllaçko. Ku do të dalësh? Mos guxo t'u prekësh rregulloreve, qoftë edhe një fije floku, se të mbyti kapter Hasani, o i gjorë, — e kishte ndërprerë Andoni.

— Po, atje e kam fjalën. Unë i kam lexuar dhe rilexuar këto ditë dhe mendoj se në rregullore ka gjëra të tepërta, madje edhe të pasakta. Për shembull, ka kapituj të tërë ku flitet për transportin me hekurudha, i cili nuk është tipik për vendin tonë; në rregulloren e disiplinës vendi i

parë u jepet masave ndëshkimore, kurse shpërblimet dhe lavdërimet dalin në plan të dytë.

— E paska marrë malli për mamanë, të gjo-rin! — e kishte ndërprerë Andoni. Dikush kishte qeshur. Por Çlirimi nuk e kishte prishur terezinë. Ai kishte vazhduar të çfaqte mendimet e tij, të cilat nuk ishte lehtë t'i kundërshtoje. — Përderisa për ushtarin tonë nuk është tipike shkelja e rregulloreve, po zbatimi i tyre me ndërgjegje të lartë, pse t'u jepet aq shumë vend ndëshkimeve, masave disiplinore? — kishte ngulur këmbë Çlirimi. Shokët e dëgjonin.

— Kjo s'ka rëndësi, — e kishte kundërshtuar njëri.

— Unë mendoj se po...

Rrahja e mendimeve kishte vazhduar gjer vonë. Në mbrëmje, kur kishte mbetur vetëm, Çlirimi kishte humbur për një kohë në mendime. Më në fund kishte hapur rregulloren e kishte filluar të lexonte. Kishte shfletuar disa faqe. Në përgjithësi ishin çëshje të njohura për të. Në ata paragrafë, padyshim, që pasqyruar një përvojë e gjatë, shumëvjeçare, aq sa shpesh Çlirimi, edhe pse nuk po i lexonte për herë të parë, e kishte vështirë ta rrokte gjithë kuptimin e kapitullit apo të paragrafit e që kthyer dhe e kishte lexuar nga e para. Në kësi rastesh, ai e përqëndronte gjatë vështrimit mbi ato germa të renditura në fjalë e fjali dhe i dukej sikur, midis rreshtave, i çfaqej fytyra e një njeriu, që e vështronte me një buzëqeshje ironike drejt e në sy dhe i tundte kokën me shpoti. Ky njeri herë i shëmbëllente kapter Hasanit, herë tiparet e tij zmadhoheshin, mjegulloheshin dhe Çli-

rimit i dukej sikur i dilte nga faqet e librit një mjekërosh i thinjur, mbi rregullore e paragrafë, i cili hakërrohej duke i tundur gishtin: «Ej, çunak, ty s'të ka dirsur ende mustaqja dhe kërkon të marrësh nëpër këmbë paragrafët, si të jenë lodra fëmijësh! S'e sheh që ne na ranë flokët dhe përsëri nuk e kemi të lehtë në këtë punë? Rri rehat, or djalkë, dhe vështro punën tënde. .!» Këto fjalë, të cilat për një çast nuk ishte në gjendje të kuptonte në ja thoshte njëri apo i kishte menduar vetë, e turbullonin, sa e humbiste toruan. Me shumë përpjekje mendohej të sillte ndërmend këshillat e komisarit, të përqëndrohej në lexim e atëhere e harronte mjekëroshin dhe i forcohej bindja se kjo që bënte nuk ishte punë e kotë dhe i përkiste atij po aq sa çdo pjestari tjetër të Ushtrisë Popullore.

As vetë nuk ishte në gjendje të thoshte se sa kohë kishte humbur ashtu në mendime. Kur kishte ardhur ushtari i shërbimit dhe, i shqetësuar, i kishte thënë se shokët ishin bërë merak, ngaqë ishte ngrënë darka dhe prej kohe që dhënë sinjali i gjumit, ai e kishte mbaruar letrën që kishte menduar t'ja drejtonte Ministrisë së Mbrojtjes Popullore. Në të, me fjalë të thjeshta, por të zgjedhura mirë, ai kishte shprehur mendimin se, në rregulloret ushtarake, kishte paragrafë, të cilët duheshin parë me sy kritik e duheshin formuluar në mënyrë të tillë, që t'i përgjigjeshin më mirë kohës dhe karakterit të ushtrisë sonë, porosive të Letrës së hapur të partisë. Ushtari kishte shprehur edhe mendime konkrete se ku duheshin bërë këto korigjime. Të nesërmen, pasi e kishin lexuar dhe rilexuar letrën, disa nga shokët e kishin quajtur të nxituar një vep-

rim të tillë dhe e kishin porositur që ta griste menjëherë. Specialistët që i kanë përpunuar rregulloret, kishin thënë ata, nuk kishin më pak mend se Çlirimi, madje ishin marrë tërë jetën me këtë punë. Mirëpo Çlirimi s'kishte hequr që s'kishte hequr dorë nga e tija. Dhe, kur, disa ditë më vonë, në repart kishte ardhur një letër me vulën e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, Andoni nuk kishte lënë vend pa bredhur; gjersa e kishte gjetur Çlirimin.

— Kam një propozim, shok i dashur, — i kishte thënë duke e fshehur letrën.

— Të hamë ca petulla? Ti mendjen gjithnjë tek e ngrëna e ke, — e kishte ngacmuar Çlirimi.

— Jo, kësaj here dua të bëjmë një dush të ftohtë.

— Ne të dy? Dhe në këtë kohë? Më duket se po të ha kurrizi.

— Mua nuk më ha, kurse ty po, — dhe i kishte zgjatur letrën.

Çlirimi e kishte marrë me mend se do të ishte nga ministria dhe i kishte rrahur zemra fort. Ai donte të qe vetëm kur ta lexonte dhe kishte bërë të largohej, por shoku e kishte ndjekur pas.

— Të thashë, o lumëmadh, se nuk mund të bëhet më i rëndë bishti nga sqepari, — e kishte ngacmuar Andoni. — Tani hajde, ç'mendohesh ashtu. Hape. Apo ke frikë mos ta kanë bërë barkun më të butë se kurrizin.

Ai e kishte grisur zarfin me mëdyshje, po, kur kishte nisur të lexonte, nuk u kishte zënë besë syve. Shokët e degës së rregulloreve të ministrisë nuk i kishin kursyer fjalët, duke e lavdëruar dhe duke e falënderuar për atë letër që, siç shpreheshin vetë,

«u kishte shërbyer më shumë nga ç'mund të merret me mend». Ata thoshin se një komision i posaçëm kishte kohë që i ishte përveshur punës për të «hequr ujët e tepërt» nga rregulloret bazë dhe shumë formulime e përcaktime, të cilat tanimë nuk i përshtateshin nivelit të zhvillimit të ushtrisë sonë, duheshin korrigjuar pa vonesë. «Megjithatë, mjaft çështje i kanë shpëtuar vështrimit tonë, — vazhdonte letra, — ndaj mendimet tuaja erdhën në kohën e duhur dhe na nxitën për ta nisur edhe një herë punën nga e para. Ju lutemi të na dërgoni edhe vërejtje e mendime të tjera, tuajat dhe dhe të shokëve, sepse kështu do t'i bëni një shërbim të madh forcimit të gatishmërisë luftarake, të ligjëshmërisë socialiste dhe frymës revolucionare të ushtrisë sonë».

Andoni, Zamiri dhe të gjithë ata që qenë ndodhur afër, i kishin lexuar e rilexuar disa herë këto rreshta, kurse Çlirimi kishte qenë gjithnjë si në ëndërr. I kishte ardhur mirë që nuk qe gabuar dhe që propozimet e tij do t'i shërbenin, sadopak çështjes së përgjithshme. Kurse shokët nuk e kishin lënë rehat. Njëri nga ata ja kishte vënë aty për aty nofkën «strategu i kompanisë». Bashkë me lajmin për letrën, që atë ditë qe përhapur në të gjithë repartin edhe kjo nofkë.

* * *

Komisar Guri ishte i fundit që e përgëzoi Çlirimin për letrën (ose, më saktë, i parafundit, po të mos harrojmë kapter Hasanin, i cili thoshte se kjo ishte një shaka me zarar, e kurdisur nga ndo-

një shok «që i ka halë në sy rregulloret»). Guri e përgëzoi i fundit, jo se e mori vesh me vonesë, por sepse, me të dëgjuar për të, mbloodhi organizatën bazë të partisë, për të diskutuar se ç'duhej bërë për të përgjithësuar shembullin e tij. Dhe u hartua një plan i gjerë masash, që nga organizimi i një mbrëmjeje tematike në shkallë reparti, gjer te dërgimi i Letrës së falënderimit në familjen e tij dhe shkuarja e Çlirimit nga një nënrepart në tjetrin për t'u folur shokëve rreth përvojës së tij si ushtar i dalluar. Puna për zbatimin e planit do të fillonte që të nesërmen.

Mirëpo ngjarjet nuk u zhvilluan plotësisht sipas parashikimit. Po atë mbrëmje, në batalion erdhi një radiogram, i cili u ngjalli jo më pak kurreshtjen atyre që e lexuan.

Si mbaroi mbledhja, Guri u kujtua se e kish-te lënë me të shoqen të dilte shtetitje dhe shpejtoi hapin për në shtëpi. Majlindën e gjeti të veshur e të gatshme tek tundte me nervozizëm karrocën e vogël. Sa e pa, u ngrit me rrëmbim dhe nisi të hiqte pardesynë. «Po shpërthen furtuna», mendoi Guri dhe zuri të shtynte nga dera karrocën, duke u hequr sikur nuk kishte vënë re asgjë të veçantë.

— Ku e shpie? — pyeti Linda.

— Nuk do të dalim? — ja ktheu ai dhe kafshoi buzën për të mbajtur të qeshurën.

— Tani? Tani që u ngrys dhe u ftoh koha? Kam dy orë që pres. Dhe është dita e parë që do të dilnim me vajzën. Ç'ters!

Ai ju afrua dhe u përpoq ta merrte me të mirë.

— Më fal, Linda, por... nuk munda. Kisha

punë. Një punë shumë të ngutshme, më kupton, që nuk priste.

— Pse unë nuk kisha punë? Vetëm ti ke? Edhe ne kishim pasdreke letrare me nxënësit, por kishim lënë fjalën dhe mora leje.

Guri e vështronte dhe nuk fliste. Kjo e nxehte dhe më shumë Lindën.

— Kur do të mbarojnë një herë këto punët e tua, xhanëm? Kur do të themi se do të shkojmë në një vend dhe ta mbajmë fjalën? Kur?..

Ai nisi të qeshte.

— Posi. Dhe tallesh me mua. Qëndron sa qëndron në repart, pastaj më vjen e fillon nga librat. Kurse unë... Unë të pres e as bukë nuk ha. Unë... Po pse nuk flet? Pse më vështron ashtu?

— E di ç'mendoj, Majlinda? Se si të shkëlqejnë sytë kur nxelesh.

— Ashtu? Fillove të tallesh tani?

— Jo. Aspak. Ta them me gjithë mend që, kur merr inat e skuqesh, bëhesh më tërheqëse.

Ajo vuri buzën në gaz. Gruaja e ka vështirë t'u qëndrojë lëvdatave të burrit të vet. Ulet menjëherë, si deti pas furtunës.

— A, ç'dinak që je ti. Se si ma heq kështu inatin, si me dorë... Do të dalim?

— Patjetër. Pa shih ç'mbrëmje e bukur është. Po të mos kishin çelur mimozat, nuk do të besoja se është fund shkurti e fillim marsi.

Ata e zbritën së bashku karrocën dhe dolën në rrugën kryesore, e vetmja rrugë e gjatë dhe e drejtë, që e ndante qytetin në dy pjesë thujse të barabarta. Ajo ishte një rrugë e gjerë, plot ajër dhe dritë, e rrethuar nga të dy anët me mimoza,

të cilat shpërndanin një aromë të këndshme. Majlindës i ngjante se në këtë buzëmbremje, në rrugën e heshtur, në shtëpitë e mbështjella me një si tis të trëndafiltë e të tejdukshëm dhe në medalionin e artë të diellit, që qëndronte pezull në majën e malit dhe shpërndante në gjithë vendin rrezet e përflakura, kishte diçka të veçantë, joshëse. Ndaj, kur pa kundrejt tyre një ushtar, që afrohej me hap të nxituar, ajo e shtrëngoi fort të shoqin nga krahu dhe u ngjesh tek ai, si të kishte frikë mos ja merrnin.

Ushtari qëndroi dy-tri hapa përpara, nderoi dhe i zgjati eprorit një zarf.

— Ka ardhur një radiogram për ju, — tha. — Urdhëroni. Më lejoni të largohem?

— Faleminderit. Shkoni!

Guri hapi zarfin dhe nisi të lexonte: «Më datën 5 mars, në Komitetin Qendror të Partisë, do të bëhet një mbledhje e rëndësishme. Major Guri Lena dhe ushtar Çlirim Shpati të jenë në Tiranë më 4 mars, se do të marrin pjesë në mbledhje». Pas këtyre rreshtave të daktilografuara, ai e ndali vështrimin mbi disa fjalë, të shkruara shpejt e shpejt me laps. E njohu në çast shkrimin e Skënderit, shokut të tij, i cili atë mbremje ishte oficer roje: «Kur të kthehesh nga Tirana, ka rrezik të bësh sikur nuk na njeh. Dhe çfarë, se? Dy veta nga një batalion...! Urimet më të mira». Guri ishte i bindur se lajmi do të përhapej me shpejtësi në të gjithë repartin. Shokët e tij ndoshta dhe do të habiteshin. Dhe jo pa të drejtë. Mirë Çlirimi se ishte një ushtar i dalluar me plot kuptimin e fjalës, po ai, ç'kishte bërë që të nderohej kaq shumë? Vetëm që kishte ardhur vullnetarisht në

bazë dhe me një detyrë më të ulët? Ç'ishte kjo mbledhje e rëndësishme? Për se do të flitej? Kush do të merrte pjesë?

Ai pyeste kështu veten dhe ecte i hutuar, pa vënë re ku hidhte hapat. Majlinda e kuptoi se në atë letër ishte shkruar diçka jo e zakonshme. Dhe priste me ankth. Po Guri as që kujtohej për të.

Ti harrove fare se jemi bashkë.

— Më fal, Linda.

— Ç'është ajo letër, nëqoftëse... nuk ke ndonjë sekret ushtarak.

— Jo. Më njoftojnë se më 4 mars duhet të ndodhem në Tiranë.

— Përsëri do të ikësh? Do të më lësh vetëm? Në zërin e saj shprehej keqardhje, shqetësim.

— Jo krejt vetëm. Tani ke Ditkën e vogël, Ditkën tonë.

Ajo e shtrëngoi edhe më fort nga krahu.

— A mund ta di pse do të shkosh? Sa do të rrish?

Guri i zgjati letrën. Ajo e lexoi dhe e rilexoi disa herë. «Pa shih si qenka puna? Dhe unë u mërzita. Po ç'është kjo mbledhje. Duhet të jetë domosdo e rëndësishme, gjersa të kërkojnë me urgjencë dhe me radiogram.» Burrë e grua ecën një kohë pa folur, secili në mendimet e veta, pastaj befas u gjallëruan e nisën të vrisnin mendjen pse do të bëhej kjo mbledhje. Sido që të ishte, vendosën ta festonin atë mbrëmje. Blenë mollë, arra, fiq të thatë, verë, lëng frutash dhe u nisën për në shtëpi.

— Unë do të kthehem pak në repart, të laj-

mëroj ushtarin, — tha Guri, kur arritën pranë shtëpisë.

— Mos u vono. Të pres me padurim! — i mërmëriti gruaja dhe e përshëndeti me dorë tek po largohej.

Guri e dinte që, kur futej në mes të ushtarëve, e kishte të vështirë të shkëputej prej tyre, ndaj dhe e ndau mendjen që të takonte Çlirimin, ta porosiste dhe të mos kthehej as majtas, as djathtas. Po, kur shkoi para dhomës së fjetjes, i gjeti ushtarët duke biseduar me zë të lartë, si të grindeshin për diçka:

— Duhet të lajmërojmë komandantin, — foli njëri më në fund.

— Dhe pa humbur kohë, — shtoi një tjetër. Guri u afrua.

— Po vjen komisari...

— Si është puna, shokë?

Ushtarët zunë të shikonin njëri tjetrin, pa ditur si t'ja fillonin. Pastaj ja treguan të gjitha, ashtu siç kishin ngjarë. Disa minuta më parë, ushtar Petritit i kishte shkrepur të dilte në qytet, ata nuk e dinin se pak më parë ai kishte marrë një letër tronditëse nga fshati, nga Flutura, dhe, ashtu siç ishte, pa i marrë leje askujt, ishte drejtuar nga postbloku. «Roje është Zamiri, — kishte menduar, — dhe nuk do të më sjellë ndonjë pengesë». Po roja i kishte bërë me shenjë të ndalej:

— Ku shkon? — e kishte pyetur.

— Nga sytë këmbët, — i ishte përgjegur Petriti.

— Ke marrë leje?

— Leje? E paske zënë me të trasha sot!

Zamiri ishte zënë ngushtë. Në një rast tjetër do të kishte kafshuar gjuhën dhe as që do ta kishte vrarë mendjen se ç'duhej të bënte, po pas atyre që kishin ndodhur para pak ditësh, ai kishte filluar ta kontrollonte veten në çdo hap që të mos shkelte më në dërrasë të kalbur. «Si do t'i dal përpara major Gurit, po ta marrë vesh që isha unë roje?» — kishte menduar dhe i kishte folur prerë shokut:

— Kthehu. Sonte kemi film në repart. Ç'të duhet t'i hapësh telashe vetes?

Petriti kishte bërë sikur nuk kishte dëgjuar dhe as që kishte kthyer kokën. Kohët e fundit seç bluante në mendje. Qëndronte i veçuar, me mendimet e veta dhe as Zamirit nuk i hapej. Edhe tani që ecte, dukej sikur mbante mbi supe një thes me mendime. Pse rrinte ashtu i zyrtë? Ç'e mundonte? Ç'do të bënte i vetëm në qytet? Po sikur ta shikonin?

— Ndal! — e kishte urdhëruar Zamiri me zë të fortë, që edhe atij vetë i qe dukur sikur i kishte dalë padashur.

Petriti kishte mbajtur hapin.

— Ç'pate?!

— Ktheu prapa!

Tjetri e kishte vështruar i habitur, si të desh t'i thoshte: «Hë, mo, hesht, sikur është hera e parë kjo», dhe kishte vazhduar të ecte. Po zëri i rojes e kishte gozhduar përsëri në vend.

— Mos shko, — i kishte folur Zamiri me zë të ulët, me ton lutës, si për t'u çfajësuar që e ndalonin, dhe kishte shtuar: — Do të lajmëroj shokët.

Petriti kishte rrudhur supet.

— Po kjo? Na dashka dekoratë djali! Epo mirë, vrapo e thuaji kapter paragrafit që të mbledhë kompaninë.

Nënoficer Hasani sikur kishte mbirë nga toka atë çast.

— Më kërkuat? — kishte pyetur.

Të dy ushtarët kishin mbetur të hutuar. Asnjëri nuk qe përgjegjur. Ai e kishte kuptuar se ushtarët ishin grindur për diçka dhe nuk u kishte ardhur mirë që u ishte futur në mes një i tretë.

— Ku shkoni, ushtar Petriti?

— Punë për mua!

— Si flet ashtu? Qenka puna jote! Po ne pse jemi këtu, për të tundur derën?

Zamiri me Hasanin e kishin vështruar tek largohej dhe e kishin ndier veten të pafuqishëm për të vepruar. Kishin këmbyer nga një vështrim të shpejtë me njëri tjetrin dhe Zamiri kishte mbetur në vendroje të vazhdonte bisedën me pushkën e tij, kurse kapter Hasani ishte drejtuar i tronditur për në repart. Ziente përbrenda «Ke parë kështu? As që pyet tjetri për ty! Puna ime, thotë. Ti vështro rrugën. Dhe as që e bën qejfin qeder. Kurse major Guri thotë: merre shtruar e mos e prish gjakun, Me metodën e bindjes! E ka fjalën masa, kolektivi, thotë. Iku koha e babaqemos, me demek. Ja, kështu. Dhe mos plas nga inati pastaj!» Ballin e komisarit e mbuluan rrudhat. E ndjeu se të gjithë ja kishin ngulur vështrimin dhe prisnin ç'do të thoshte. Po pse të prisnin nga një njeri? Ç'do të bënin ushtarët sikur të mos kishte ardhur ai? Do të qëndronin duarkryq, si Hasani, apo?... Dhe

në çast e rrëmbeu kureshtja të dinte se si do ta zgjidhnin ata këtë problem.

Kjo nuk ishte një kureshtje thjesht prej sositësi, por më shumë dëshirë për të parë se sa të pregatitur ishin ushtarët të vepronin, ta vinin në udhë shokun që kishte gabuar.

— Ju veproni sikur të ishit vetëm, sikur të gjithë eprorët tuaj të qenë, ta zëmë, në një mbledhje apo me shërbim dhe koha të mos priste sa të ktheheshin ata, — tha Guri, si u mendua gjatë, dhe mori rrugën për nga zyra.

«Ja, edhe ky i ngriti duart. — mendoi kapter Hasani. — Ehu, kollaj është të flasësh nëpër konferenca dhe t'i nxjerrësh gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve...»

Sakaq, Guri arriti në zyrë, u ul pranë tryezës, hapi sirtarin dhe nxori që andej një dosje. Shfletoi disa faqe, po nuk ishte në gjendje të lexonte as edhe një rresht të vetëm. Germat i ngatërroheshin me njëra tjetrën. U ngrit dhe ju afrua dritares. Ushtarët bisedonin. Kishin vënë në mes kapterin. Çdo të bënin vallë? Sa do të dëshironte të ishte pak më pranë tyre dhe të dëgjonte ç'thoshin!

— Ae, more vëlla, e di unë pse hedh vicka Petriti, — fliste kapter Hasani. — Të ishte burgu, pa llofoshim bashkë. Kurse tani... — dhe vazhdoi monologun me veten e tij: «Tani të ngrihet i biri i botës e të këput njëqind dokra. Të dërdëllis tërë ditën për demokraci e burokraci, e ku ta di unë, dhe e shkel rregulloren me të dyja këmbët. Ç'na duhen gjithë ato formalizma, thotë. Dhe të merr lapsin e kuq një farë Çlirim Shpati, me demek, e t'i këput pa të keq paragrafët, si të jenë kunguj

në kopsht. Pse u dashka të pritet ministri me bandë e trup-roje nderi, thotë. Po kjo pikë e zezë? Dhe ngreu e fol, po deshe. Ti je frymë e vjetër, burokrat ta këput me sëpatën e dardharit. Tani s'të pyet njeri, byrazer, as për disiplinën, as për ligje e rregullore». — Fjalët e fundit, siç duket, i shqiptoi me zë të lartë, sepse ushtarëve nuk ju durua.

— Si nuk pyetka njeri për disiplinën! — u hodh Çlirimi. Hasani kafshoi buzën. Sa shumë e hutonte ky njeri! Më mirë të kishte të bënte me kompaninë, me gjithë batalionin, se me të. Sa herë ishte ngrënë me të dhe gjithnjë i ishte dashur të tërhiqej, të lëshonte litar.

— Kush tha se s'pyet? — përsëriti Çlirimi, këtë herë me zë të ulët, si të donte t'u jepte rrugë mendimeve të veta që ja shtrydhnin trurin.

— Unë them. Petriti thotë. Gjithë të tjerët. Në mos e thëncin hapur, së paku e mendojnë.

— Nuk është ashtu, shoku Hasan. Ligjet, rregullat e disiplinës ushtarake janë shkruar me gjak dhe askush nuk guxon t'i marrë nëpër këmbë.

— Opo leri të trashat, o derëbardhë. Shko e merru vesh me Petritin, po ta mbajti.

— Do të shkojmë.

— Kot e keni. Ai s'ma vari mua, s'ja vari rojes, jo do të pyesi për të tjerët.

— Ty mbase nuk ta vari, por kolektivit do t'i bindet se s'bën, — ndërhyri ushtar Sokoli, i cili rrallë e tek e hapte gojën, po çdo fjalë i zinte vend. — Unë jam i mendimit të shkojmë kështu siç jemi në qytet dhe t'i bëjmë thirrje të kthehet.

Për disa çaste, asnjëri nuk guxoi ta prishte heshtjen. Të gjithë ranë në mendime. Nga një anë

u pëlqente propozimi i shokut, nga ana tjetër mendonin se nuk duhej nxituar.

— Opo dale, sikur nuk e ka keq Sokoli, foli njëri me mëdyshje.

— Si nuk e paska keq? Ku do t'i gjejmë gjithato fletë-leje?

— Asqë na duhen fletë-lejet. Ne mund të vihem në rresht dhe të na komandojë njëri prej nesh. Sa ta gjejmë, kthehem. Por mua më shqetëson diçka tjetër: a është e domosdoshme të shkojmë të gjithë? Përse të mos vejë njëri dhe ta urdhërojë të kthehet?

— Vështirë t'ja arrijë qëllimit, gjersa nuk ju bind rojes dhe kapter Hasanit.

— Le të shkojmë dy-tri veta.

— Edhe dy-tri vetave ai mund të mos ua vejë veshin.

— Atëhere kot e kemi. Të presim sa të kthehet, pastaj shohim e bëjmë.

— Jo, nuk duhet pritur. Kapter Hasanit, apo ndonjë tjetri mund të mos i bindet, por me kolektivin nuk bëhet shaka.

— Ku pyet ai kur nxehet, o lumëmadh.

— Do të pyesë se s'bën. Shkelësi i rregullave mund t'i shmanget vështrimit të njërit apo tjetrit, por kur e sheh se në mbrojtje të ligjit, të regullores, jemi të gjithë ne, nuk do ta ketë lehtë të ecë dot kundra rrymës. Nisemi. Ne tani, fundja, të lirë jemi...

— E drejtë, veçse duhet njoftuar më parë komisar Guri, kurse Sokoli me Gjonin, që u vjen dorësh, le të shkruajnë një fletë-rrufe...

Guri qëndronte prapa perdes dhe vështronte. Tek shihte që ushtarët diskutonin me aq zjarr, e

rrëmbeu kureshtja të mësonte sa më parë se përse flisnin, ç'kishin ndërmend të bënin. Por gjersa kërkoji të vetëvepronin, vendosi të priste. Dhe kjo nuk ishte një pritje e thjeshtë, por e mbushur me tundime e shqetësime, njëlloj si mësuesi kur ka dhënë detyrën dhe pret të shikojë se sa e kanë përvetësuar nxënësit lëndën e tij. Ndërkaq trokiti dera dhe u fut Çlirimi brenda e i njoftoi se ç'kishin vendosur. Ai i dëgjoi si nëpër ëndërr fjalët e tij. Ç'ti thosh. T'u jepte lejë? Po sikur t'u linte inisiativë atyre. Kohë shumë për mendime s'kish. Vendosi:

— Unë ju thashë, shokë, veproni sikur të mos isha unë fare në repart. Ti Çlirim je zëvendës komandant — tha prerë. Po, kur mbeti përsëri vetëm, ai zuri të vinte në ballancë veprimin e ushtarëve. Dhe, sidoqë në vështrimin e parë i dukej se kishte diçka që nuk shkonte, i erdhi mirë kur mendoi se ky vendim i papritur kishte një domethënje të madhe.

Mendimet ja preu si me sopatë një zë i fortë:
— Para marsh!

Sa hodhën hapin e parë, buçiti kënga. Në vend qëndroi vetëm Kapter Hasani, i cili e vështronte i habitur kolonën e togës që po i afrohej postbllokut. Kur dolën nga reparti, kënga mori edhe më shumë zjarr. Tingujt e saj u derdhën në luginën, që përshkohej nga një lumë i rrëmbyer dhe u përplasën lart, në faqen e kodrës së mbuluar nga një gjelbërim i butë e i ndezur.

Ushtarët ecnin me hap të rëndë. Kur kapërcyen urën dhe u futën në qytet, kënga buçiti edhe më e fuqishme rrugëve të ngushta, të rrethuara nga të dy anët me ndërtesa dy-tri katshe. Njerëzit dilnin nëpër dritare e ballkone, kurse kalimtarët mbanin

hapin e dëgjonin të kënaqur. Ata i rrëmbente në çast kolona e ushtarëve, që ecnin me hap të shtrirë, si në paradë, dhe që këndonin aq bukur.

Në një qytet të tillë të vogël, me një rrugë kryesore, një kinema e katër-pesë bufe, nuk ju desh të kërkonin shumë. Petritin e gjetën para vitrina-ve të kinemasë.

— Repart ndal! — thirri Çlirimi që kishte komandën.

Ushtarët përplasën hapin dhe qëndruan në një kohë. Petriti ktheu kokën. U habit sa më s'bëhet dhe mori të largohej.

— Shoku ushtar; zini vendin në rresht! — foli prerë dhe qetë Çlirimi, si të thoshte diçka krejt të zakonshme. Petriti e shikoi i habitur. Disa qytetarë, që u ndodhën aty afër, u kthyen nga ushtarët e po vështronin me kureshtje.

— Në rresht! — vazhdoi Çlirimi me të njëjtin ton dhe shtoi pak më butë: — Mos na vono. Na presin në repart.

Petriti nuk e kuptonte se ç'po ngjiste. E ndjeu se nga të gjitha anët vështrimet ishin ngulur mbi të. Pa e kuptuar se çfarë e shtynte: toni i prerë i Çlirimit, vështrimet e shokëve, apo të kalimtarëve, ai plotësoi rreshtin e parafundit. Çlirimi këtë priste:

— Para marsh! — komandoi.

Dhe kënga u derdh përsëri rrugëve të qytetit si të mos kishte ngjarë asgjë e veçantë. Gjer në repart, nuk këmbyen asnjë fjalë. Kur arritën atje, u ndalën para tabelës së fletë-rrufeve. Një ushtar lexoi me zë të lartë.

«Shoku Petrit,

po të drejtohem i edhe një herë ne, shokët e togës. Kjo nuk është hera e parë, por dëshirojmë të

të jetë e fundit. Ne po të pyesim të shqetësuar: pse veprova ashtu? Si mund të sillesh me kapadaillek e mospërfillje ndaj rojes dhe magazinierit të batalionit? Si guxove të dilje në qytet jashtë radhës e pa leje? A nuk e di se ky është një lloj dezertimi nga reparti? Sikur në atë kohë të jepej sinjali i alarmit, kush do ta zinte vendin tënd në rresht? Në qoftë se do të vepronim edhe ne si ti, vaj halli me rregullin dhe disiplinën ushtarake».

Për disa çaste sundoi heshtja. Petriti vështronte i nxehur e i hutuar herë nga shokët, herë nga fletërrufeja.

— Po kjo ç'do të thotë? Kush e ka shkruar? — pyeti.

— Ne, shokët e togës.

— Si është e mundur! — shfryu dhe nisi të ecte drejt tabelës. I shkrepiti ta griste mu aty, para syve të tyre, pa le të bëhej kiameti, po ndërroi mendje.

— Ç'do me thënë kjo? — pyeti së dyti.

— Asgjë më shumë nga ato që janë shkruar. Lexoju edhe një herë dhe mendohu mirë, përpiku ta kuptosh gabimin.

— Ashtu? E kush e thotë këtë?

— Ne! — u përgjegjën si në kor ata që qenë në rresht. Petriti e ndjeu se nuk e kishte të lehtë të hahej me të gjithë, ndaj uli sytë dhe i përtypi mendimet. Shokët e kuptuan se nuk kishin ç'të thoshin tjetër dhe, pa u dhënë njeri komandë, u shpërndanë. Vetëm Petriti qëndroi edhe për një kohë para tabelës së fletërrufeve.

Jo vetëm Majlinda, por të gjithë ushtarët i kishin pritur me padurim Gurin dhe shokun e tyre ushtar gjersa të ktheheshin nga Tirana. Ata kishin dëgjuar në radio se Çlirimi në emër të tyre kishte folur në mbledhjen e kuadrove kryesore, ndaj, sa e panë që po vinte nga postblloku, e rrethuan dhe e bombarduan me pyetje. Çlirimi në fillim u hutua. Ai gjithmonë i kishte pasur fjalët të kursyera, po atë ditë ju zgjidh gjuha dhe nisi të fliste, të fliste. Ndjente nevojë ta mbante me të tjerët gëzimin që ja trazonte krahërorin gjatë atyre ditëve.

— Më duket si një ëndërr, shokë. Kurrë nuk e kisha parë veten më ngushtë. Vajta më shpejt nga të gjithë. Dalëngadalë, salla u mbush. U hutova krejt kur pashë gjithë ata oficerë madhorë, kolonelë dhe gjeneralë, me gjoksin plot dekorata. M'u duk se vetëm unë isha i tepërt dhe sikur kisha hyrë gabimisht atje. Pastaj erdhi shoku Enver. Salla gjëmoi nga brohoritjet. Ai na përshëndeti me dorë. Pastaj nisi të fliste. Sa thjesht e bukur e shpjegoi domosdoshmërinë dhe vlerën e madhe të ndryshimeve që do të bëhen në organizimin e ushtrisë. Po ç't'ju them për këtë? Ju e keni lexuar vetë në gazetë. Pas tij u ngritën dhe diskutuan shumë oficerë.

— «Po shokët ushtarë dhe marinarë ç'mendojnë? A i aprovojnë vendimet dhe propozimet që shtrohen për diskutim?» — pyeti befas shoku Enver.

Në sallë u bë heshtje. Dukej sikur nuk lëvizte as miza.

— «Fjalën e kanë shokët tanë ushtarë, — tha pas pak shoku Enver dhe m'u duk sikur m'i nguli

sytë mua. — S'ka gjë se s'janë përgatitur. Le të flasim ashtu siç mendojnë, siç flitet në mes shokësh», — dhe përsëri m'u duk sikur i kishte sytë nga unë. E mora këtë si një urdhër që më drejtonte komandanti në fushën e luftimit, dhe e mblodha veten. «Ushtari nuk duhet të hutohet — mendova dhe u ngrita. Nisa të flas nga vendi.

Shoku Enver më ftoi në tribunë. Në fillim ngurova, pastaj u çapita ngadalë. Kur u ngjita lart dhe i hodha një sy sallës, thashë se më pushoi zemra. U lava në djersë. Vetëm buzëqeshja e Atij më dha zemër. Dhe nisa të flas ashtu siç mendoja unë për masat që propozon partia për Forcat e Armatosura. Thashë se këto masa, krijimin e komiteteve të partisë, vendosjen e komisarëve politikë, etj. ne ushtarët, i aprovojmë me gjithë zemër. Dhe u ndala pastaj te puna e gradave. Ne, thashë, nuk e respektojmë shokun Guri për spaletat e majorit që mban mbi supe, po sepse shohim te ai njeriun e partisë, përfaqësuesin e saj, prindin dhe edukatorin tonë, i cili është gati të shkojë përkrah nesh edhe në provën më të madhe në jetë, në luftë, e të bëjë çdo gjë për popullin, për partinë. Komisar Guri mund të kishte një gradë më të madhe, apo më të vogël, po kjo nuk do të na bënte që ta donim e nderonim as më shumë, as më pak. Dhe shtova se cilido nga ne, ushtarët, po ta kërkonte nevoja, do të ishte gati të hidhej edhe në zjarr për shokun Guri. Tregova pastaj rastin e Zamirit. Thashë si e shkeli ai disiplinën, ç'masa propozoi kolektivi i ushtarëve dhe si ndërhyri me takt e mençuri komisar Guri, duke na dhënë të kuptonim se partia ka besim te bijtë e saj, te ushtarët. Hodha sytë nga komisari. Ai ishte skuqur, fshinte djersët me shami dhe

lëvizte në karrige. «E shkele, Çlirim!» thashë me vete. Dhe u përpoqa të ndërroja fjalë, po s'munda. U hutova fare. Nuk dija ç'të thosha. Desha të uler, po e ndjeva se nuk i kisha thënë të gjitha. Vështrova përsëri nga komisarari. Ai e kishte mbledhur veten dhe më bënte me shenjë: «Hë de, pse t'u lidh gjuha kështu?» Të tjerët vështronin herë mua, herë komisararin. E kuptan gjendjen time dhe qeshën pa të keq. Shoku Enver duartrokiti. Mora zemër dhe vazhdova. Përsëri më duartrokiten.

Ushtarët e dëgjonin me vëmendje. Tundnin kokën. Dikush i dha zjarr bisedës.

— Mor po ti paske qenë thëngjill i mbuluar.

— Kur u pregatite, xhanëm? Si nuk të muarëm vesh fare?

— E ç'pregatitje? Unë s'kisha fare letër përpara. Fola ashtu siç mendoja, siç diskutojmë këtu, në mbledhjet e lira të kompanisë.

— Pse nuk thua që na paske turpëruar?

— Ashtu m'u duk edhe mua. Po ta shihnit si ma shtrëngoi dorë shoku Enver! Si më përqafoi!

— Të ishte atje kapter Hasani, do të thoshte: «Ju shkelët rregulloren. Duhet të qëndronit dy deri tre hapa para eprorit, të zgjatnit këmbën e majtë, dorën e djathtë dhe...» — ndërhyri Andoni, duke imituar zërin e nënoficerit. Të gjithë qeshën.

— Po pastaj? Ç'ngjau pastaj?

— Kështu. Shoku Enver më përqafoi dhe tha: «Shumë mirë i kuptojnë çështjet punëtorët, fshatarët, ushtarët. Kjo do të thotë se partia jonë është në rrugë të drejtë.» Salla gjëmoi nga duartrokitjet. Shoku Enver më uli në presidium, pranë vetes.

— Ç'punë ke bërë në jetën civile? — më pyeti.

— Punëtor, shoku Enver, traktorist kam qenë.

— «Edhe unë kështu mendoja», — tha dhe i hodhi një sy sallës. «Do të të mbajmë në ushtri, — shtoi, — të bëhesh oficer, komisar, një komisar i kuq, proletar».

— Si të mendoni ju, shoku Enver. Si të thotë partia. Unë jam ushtar i saj.

— O po ti paske qenë brisk nga goja! — tha njëri. — Këtu mezi t'i nxjerrim fjalët.

Dhe shokët e ngritën në duar. Brohorisnin, thërrisnin, qeshnin. Kurse Guri, në shtëpi, i tregonte Majlindës për ato minuta të paharruara që kishte kaluar në Komitetin Qendror të partisë.

* * *

Jehona e kësaj ngjarjeje la gjurmë në jetën e kompanisë dhe e ngriti më lart frymën luftarake të ushtarëve. Për disa ditë me radhë, Çlirim Shpati kaloi nga njëri repart te tjetri, u fliste shokëve për mbledhjen, për detyrat që shtronte partia. Dhe kthehej pastaj në kompani e punonte me një energji, që i habiste shokët. Komisar Guri kishte dalë tani në plan të dytë. Ai ndiqte me vëmendje rrjedhën e ngjarjeve dhe, pa rënë në sy të të tjerëve, mundohej t'i jepte kësaj rrjedhe drejtimin e duhur, ashtu siç drejton kop-shtari vijën e ujit, që toka të vaditet sa më mirë e bimët të rriten të shëndetshme. Edhe kur nuk ishte në mes tyre, ushtarët e ndjenin praninë e komisarit. Mendimi krijues i masës ishte vënë në lëvizje dhe, si një ortek i fuqishëm, kishte marrë përpara çdo gjë të vjetër, të kalbëzuar, të dëmshme. Vetëm kapter Hasani e kishte humbur toruan. Shpesh mby-

llej në zyrë, nxirrte përpara rregulloren dhe hiqte vija mbi njërin paragraf pas tjetrit, duke ndjerë një dhembje të tillë në zemër, si të shkulte pjesë nga trupi i tij. Pas disa ditësh, në vend të rregulloreve bazë, erdhi një instruksion i vogël, prej disa faqesh, që e futi në mendime të thella. I lexoi brenda disa minutave ato pak rreshta dhe atëhere e humbi fare pusullën, pasi nuk mori asnjë përgjigje për të gjitha ato pyetje, që ja rrihnin trurin si çekan.

Por jeta vazhdonte të ecte përpara, pa pyetur për shqetësimet e nënoficerit. Zamiri dhe shokët sikur i kishin harruar ato që kishin ngjarë. Ata nuk ja hidhnin në sy fare diskutimin që ishte bërë për Zamirin në dhomën e kulturës dhe tregoheshun me të çdo ditë e më të afrueshëm, më dashamirës. Madje, në një stërvitje, toger Pirrua e kishte nxjerrë përpara kompanisë dhe kishte thënë fjalë të mira në informacionin politik. Vetëm Petriti i mbante një mëri të heshtur, sadoqë, në vetvete, e kuptonte se nuk kishte bërë mirë që kishte dalë pa leje. Ndaj dhe e kishte ndarë mendjen që, kur ta takonte përsëri, të mos bënte sikur s'e shihte.

* * *

... Një pasdite Petritin e kishin njoftuar se në truproje ishte paraqitur një vajzë, që kishte thënë se vinte nga fshatrat e Librazhdit dhe që kërkonte të takohej me Petritin. Sa e njoftuan, atij se ç'i cëriti në zemër dhe vrapoi për nga hyrja e repar-tit. Me ta parë, u step i hutuar.

— Fluturë, ti këtu?! — dhe i zgjati dorën me

ndrojtje. — Si është e mundur? Të lejuan nga shtëpia?

Këto pyetje sikur e prunë në vete vajzën. Mërmëriti diçka nëpër buzë, po Petriti nuk kuptoi asnjë fjalë. E vështronte, thuase do ta përpinte me sy. Vajza kishte ulur kokën dhe coponte me dhëmbë një degë plepi. Gjoksi i bëshëm i ngrihej dhe i ulej me rrëmbim, si të kishte bërë një vrapim të gjatë. Nuk ngopej me frymë. Sytë e zinj, të mëdhenj, hetues, rrotulloheshin herë djathtas e herë majtas nën vetullat e holla e pak të ngritura, si t'ja kishte vizatuar njeri me laps. Petriti e shikonte dhe nuk e kuptonte ç'kishte ngjarë. Si ishte e mundur që ajo të vinte gjer atje. Gjatë gjithë atyre muajve, kur mbetej vetëm, ai e kalonte gjithë kohën me Fluturën, duke kuvenduar në heshtje me të. Sa herë e sillte ndërmend, ajo i përfytyrohej në mbrëmjen e vallzimit, ose tek zbriste drejt burimit, me shtamën në kokë, e duke i tundur shaminë. Më kot ishte munduar ta përfytyronte ndryshe, duke punuar në arë, në bankat e shkollës, apo duke kuvenduar me shoqet. Po që t'i vinte aty, s'i kishte shkuar kurrë në mendje. Por ja që ajo po i qëndronte përballë, me një buzëqeshje të ndrojtur, duke pulitur qepallat dhe ai rrinte krejt i hutuar e nuk mund ta kuptonte plotësisht se çfarë kishte ngjarë. Kurse, ajo, pasi kishte hedhur atë hap të guximshëm, kishte nevojë t'i thoshte se kishte vepruar shumë mirë dhe se ai Petriti, e kishte pritur një gjë të tillë.

— Si të lejuan? — e pyeti për të dytën herë.

Asaj ju drodh buza. Gjatë gjithë rrugës kishte menduar vetëm për një gjë: të largohej sa më shumë nga fshati dhe të takohej me Petritin. Kurse

tani që ja kishte arritur qëllimit, i dukej sikur kishte bërë një hap të pamenduar.

— Ja... erdha! — vetëm kaq mundi të fliste dhe hapi duart anash, si të donte të thoshte: «Mbase dhe gabova, por kështu ma preu mendja. Kujtoja se ti do të më prisje ndryshe».

— Po kur do të... ikësh? — u nxitua të pyeste Petriti, ngaqë nuk dinte ç'të thoshte tjetër.

Ajo u skuq. E ndjeu se lotët po ja digjnin qepallat. Nëqoftëse do t'i thoshte edhe një fjalë, nuk do të ishte në gjendje t'i mbante më. Dhe, po të shpërthente, ajo ishte e bindur se do të shfrente tërë ato ndjenja e shqetësime, që i ishin mbledhur si lëmsh në krahëror dhe po e mundonin aq shumë prej disa ditësh. Por tani nuk ishte e zonja as të qante, as të qeshte, as të fliste. Mezi qëndronte në këmbë.

— Unë erdha për... gjithnjë, — foli me zë shumë të ulët, dhe fshehu përsëri sytë poshtë qepallave të rënduara nga lotët.

— Për gjithnjë?!

— Po.

— Mos bën shaka, Fluturë! Si është e mundur që... — dhe bëri një hap prapa.

Flutura e kishte menduar krejt ndryshe këtë takim. As që i kishte shkuar ndërmend se Petriti do të hutohej kaq shumë. Mos vallë ishte nxituar? Mos ndoshta duhej ta kishte lajmëruar më parë Petritin, që të mos e gjente të papregatitur? Po ç'thoshte kështu? Ku kishte kohë ajo për t'u menduar? Ngjarjet kishin rrjedhur aq shpejt dhe aq papritur, sa dhe ajo vetë u habit.

Kështu mendonte Flutura. Kurse Petriti: «Shiko si është prerë në fytyrë. E shkreta Flutur! E

mira... Trimëresha. Ku ta dish ç'ka ngjarë me të, gjersa u detyrua të hidhte këtë hap. Dhe unë rri si mumje! Ç'guak që jam!»

— Fluturë, mos u mërзите? Sa mirë bëre që erdhe! Sa mirë! Po ja, si të them, unë nuk të prisja. E dija se një ditë do të ishim bashkë. Isha i bindur për këtë. Por... Si të them! Jo kështu papritur. Pastaj... pastaj do menduar mirë kjo punë.

— Ke frikë nga njerëzit e mi?

— Frikë? Ç'thua kështu, Fluturë?

— E çfarë tjetër?

— Asgjë. Ashtu, kot, — dhe, pa ditur ç'të bënte, nxori shaminë e fshiu ballin e djersitur. Për një copë kohë qëndruan kundruall, fare afër njëri tjetrit, duke ndjerë në fytyrë frymën e ngrohtë dhe, bashkë me të, një rrëqethje të këndshme, joshëse, që kalonte nga njëri te tjetri dhe ua përshkonte të gjithë trupin.

— Më prit këtu, Fluturë. Do të kthehem shpejt, — dhe, pa marrë përgjigje, u lëshua drejt reparitit. Roja i shkeli synë dhe diç i tha, po ai as që ja vari fare. Vrapoi nga fjetorja në zyrë, në magazinë, në këndin sportiv, po nuk takoi asnjë nga eprorët. Disa nga shokët e kompanisë u përpoqën ta ndalnin, e pyetën pse shpejtonte ashtu, mos kishte ndonjë hall, po ai u largohej, si të kishte frikë mos ja rrëmbenin të fshehtë. Ecte me nxitim dhe vriste mendjen të kuptonte se si do t'u vinte filli ngjarjeve, çdo të bënte me Fluturën, ku do të qëndronte ajo? Dhe pikëpyetjet s'kishin të mbaruar. I vinte inat me veten që nuk ishte i zoti t'u jepte një përgjigje të saktë dhe që i dukej vetja i paaftë për të bërë qoftë edhe një të njëqindën e asaj që kishte

bërë Flutura. Vetëm për një gjë ishte krejt i bindur: ajo nuk mund të kthehej kurrë, kurrsesi, në fshat. Po ku tjetër mund të shkonte? Ku do të rrinte? Ç'do të bënte! Me se do të ushqehet? Si...

Tek fliste kështu me vete, dalloi së largu kapter Hasanin. Për disa çaste ngurroi t'i drejtohej, ngaqë kishte pak besim se do ta ndihmonte. Por minutat shkonin, Flutura priste e kushedi ç'do të mendonte ajo, po të vonohej shumë. Deshi s'deshi, zgjati hapin, e arriti dhe u mundua t'i shpjegonte sa më qartë se e priste e fejuara në postbllok dhe se kishte nevojë për një natë leje. Kapteri e vështrioi ftohtë dhe rrudhi supet:

— Më vjen keq, por sot, ju e dini, nuk ka liri-dalje. Le të vijë të dielën. Si mund ta thyejmë orarin e veprimeve?

Petriti mezi u përmbajt. E kishte ende shumë të freskët në kujtesë se ç'i kishin bërë shokët kur kishte dalë pa leje dhe ndruhej mos përsëritej e njëjta gjë, sidomos tani që nuk do të ishte vetëm.

— Ju lutem më ndihmoni, shoku kapter. Kam nevojë për leje. Sikur ta dinit si qëndron puna, nuk do të më vononit as edhe një minutë.

Por atij nuk i bënë asnjë përshtypje këto fjalë.

— S'di si të them, more djalë. Ushtria nuk është gjendje civile, ku mund të takohesh kur të duash e me kë të duash. Në të ka ardhur e fejuara, le të presi gjer nesër, sa të vijë komandanti. Ai, po të dojë, le t'ju japë leje.

— Po ajo ç'të bëjë, ku të flejë sonte?

— Atje ku ka fjetur gjithnjë, — ju përgjegj tjetri dhe i ktheu krahët, pa e vënë re se si u pre në fytyrë ushtari. Petriti psherëtiu thellë, qëndroi

një hop pa lëvizur dhe e shoqëroi me sy kapterin gjersa u largua, pastaj u lëshua me vrap nga dalja e repartit.

* * *

Të nesërmen, kur dielli lëshoi shigjetat e para të zjarrta midis degëve të shelgut lotues, ku ishin ulur pranë e pranë, ata u zgjuan të hutuar nga gjumi. Nuk ishin në gjendje të thoshin në kishin fjetur ndonjë orë, apo porsa kishin mbyllur sy. Sa do të ishte ora, vallë? Ç'do të bënin tani?

— Fluturë, unë duhet të shkoj, — i tha ai, duke e vështruar nga lart poshtë. Ajo që strukur në trungun e shelgut, ishte mbledhur sa një grusht dhe nuk guxonte të ngrinte sytë e ta vështronte.

— Nuk kam si qëndroj më shumë. Do të jenë bërë merak shokët, — shtoi pas pak, si të donte të çfajësohej.

— Shko! — i tha ajo. — Por... mos u vono.

Ai tundi kokën dhe u largua. E dinte se nuk do ta kishte aspak në dorë që të kthehej shpejt. Kushedi ç'do të thoshin shokët, kapter Hasani, komisar Guri. Ndoshta e priste përpara një gjyq i rreptë shoqëror, si ai që ishte bërë para disa ditëve. Vetëm për një gjë hante inat me veten: pse s'kishte ngulmuar të takonte me çdo kusht komisarin dhe t'ja shpjegonte si qëndronte puna? Ai nuk e kishte bërë këtë jo se nuk i kishte shkuar ndërmend, por kur ishte nisur për tek ai, kishte ndjerë një ndrojtje e maramendje të çuditshme, siç do ta kishte ndjerë para prindërve të tij, kur do t'u thoshte se ishte martuar pa lejen e tyre. Dhe, meqë

nuk takoi dot as toger Pirron, u shtrëngua t'i drejtohej kapter paragrafit. Ishte i bindur se nuk do ta kuptonte por mjaft që t'i thoshte, që të mos zhdukej pa adresë, pa le të dilte ku të dilte. Pas fjalëve që këmbëu me të, nuk donte kurrsesi ta linte Fluturën të priste gjatë dhe t'i punonte mendja kushe-di se ku. Ndërsa tani që ecte për në repart dhe mendonte të gjitha këto, ishte i bindur se, sidoqë të ngjiste, sa do që të vonohej, Flutura do ta priste, do ta priste tërë jetën, dhe pse minuta dhe orët do t'i dukeshin të gjata, pa mbarim.

Të parin që takoi në repart ishte Zamiri. Sa-dogë disa ditë më parë ai ishte bërë shkak ta merrnin vesh shokët që kishte dalë pa leje në qytet dhe, pas kësaj, ishte munduar t'i shmangej çdo bisede me të, Petriti e përshëndeti i pari dhe e ndjeu se nuk do të qe në gjendje t'i mbante mëri as atij dhe as ndonjë tjetri. Ai ndjente një lumturi të tillë, të cilën donte ta ndante me shokët, t'u jepte edhe atyre pjesë nga gëzimi i tij. Sa e panë, ushtarët u lehtësuan nga ankthi që i kishte pushtuar dhe u matën ta pyesnin, por atë çast dha ballë komandanti i kompanisë. Duke u marrë me tërheqjen e fishekëve, të tabelave, të flamurëve dhe të materialeve të tjera për qitje, ai harroi fare që nënoficeri i rojes, një orë më parë, i kishte raportuar se atë natë krevati i ushtar Petritit kishte mbetur bosh. Vetëm pasi u nisën për në poligon e dalloi Petritin në mes të shokëve, desh t'i thoshte diçka po se pse ndërroi mendje, kur vuri re fytyrën e tij, ku, bashkë me hutimin, shprehej qartë edhe një ndjenjë e thellë gëzimi të pafund. Por kishte edhe një arësye tjetër që, hëpërhë, ai vendosi të mos e thërriste ushtarin. Nga përvoja e tij si komandant,

ai e dinte se, para qitjes, ashtu si para një provimi të vështirë, njeriu duhej të ishte krejt i qetë. Dhe qitjet nuk zhvilloheshin çdo ditë, as çdo muaj, ato ishin barometër i punës së gjatë për përsosjen e mjeshtërisë luftarake.

Poligoni priste në heshtje. Me qetësinë e tij të thellë, ai sikur donte që, pak më vonë, kur të fillonte qitja, të bëhej edhe më i thellë kontrasti e të përcillej gjer larg jehona e krismave. Dhe ndërresat e ushtarëve, të përbëra prej tri vetësh, ja lëshonin radhën njëra-tjetrës. Toger Pirrua ishte ndër ethe. Nuk i zinin këmbët vend. Kalonte në vendin mësimor të ushtarëve që prisnin radhën për qitje, i porosiste si duhej të vepronin, ç'gabime kishin bërë shokët që kishin qëlluar para tyre, pastaj kthehej në vijën e zjarrit, vrojtonte me shumë kujdes veprimet e qitësve dhe ndërhynte shumë rrallë për të bërë ndonjë korigjim, vetëm kur e shihte të domosdoshme një gjë të tillë.

Aty nga mbarimi i qitjes, erdhi në poligon komisari. Pirrua i doli përpara, mori drejtqëndrim dhe nisi të raportonte. Po Gurit nuk ju durua:

— Më thuaj si janë punët? — pyeti me nxitim.

Pirrua i zgjati listën me rezultatet e qitjes. Komisari i hodhi një sy nga kreu në fund, pastaj nisi të bënte disa llogaritje mbi paqetën e cigareve. Befas u vrëjt.

— Domethënë, nëqoftëse dalin keq edhe dy tri veta, qitja nuk plotësohet. Po sa ushtarë nuk kanë bërë ende qitje? — pyeti sërish eprori.

— Katër.

— E qartë. Temperatura të paska arritur dyzet, — buzëqeshi komisari. — Por mos u shqetëso, —

shtoi pas pak, — ushtarët janë përgatitur dhe do të dalin medoemos mirë. Apo jo?

— Le të mos shpejtohemi, shoku komisar. Puna do ta tregojë.

— Ashtu? Domethënë e ke humbur besimin? Ja, kjo nuk është gjë e mirë. Nëqoftëse komandanti e humbet besimin tek vartësit, atëhere është e kotë të dalë në fushën e betejës. Po dale një herë, se desh harrova. Si qëndron puna me ushtar Petritin? Ku ishte mbrëmë?

Pirrua u hutua një çast. E ndjeu se u skuq gjer te veshët.

— Thonë se ka qenë me një vajzë, me... të fejuarën.

— «Thonë me një vajzë», «me të fejuarën...» Një komandant i mirë nuk duhet të përgjigjet kështu, me hamendje. Unë dua të di me saktësi: ku ishte mbrëmë ushtari?

Pirrua ngriti supet.

— Kjo nuk është aspak e mirë, shok i dashur. Nuk duhej lejuar. Mua më duket se, duke vepruar kështu, ju keni vënë «egon» në plan të parë: «Mjaf-ton të dalim mirë në qitje, pa të tjerat rregullohen». Pra, keni arësytuar si teknokrat. Harroni se, nëqoftëse nuk jeni në rregull me disiplinën, me konceptet e njerëzve, nëqoftëse ata shkojnë ku të duan dhe kur të duan, pa i dhënë llogari njeriu, nuk vlen asnjë grosh rezultati i qitjes, goftë dhe i shkëlqyer.

Pirrua e lëshonte peshën e trupit herë në një-rën këmbë, herë në tjetrën. Pëllëmbët e duarve i ishin njomur nga djersa. Kurrë nuk e kishte parë komisarin kaq të shqetësuar.

— Na rroftë puna që flasim nga mëngjezi në

darkë për ndërgjegjen, për revolucionarizimin e mendjeve dhe të zemrave të njerëzve, dhe lejojmë të meta të tilla. Ma thërrisni menjëherë ushtar Petritin.

Sa nderoi dhe mori të kthehej, ushtuan tri krisma njëra pas tjetrës.

— Ai është duke zhvilluar qitje, — tha komandanti.

— Mirë atëhere. Bëni si të doni me këtë qitjen tua. Për mua s'ka asnjë rëndësi rezultati, — ja ktheu komisarari dhe u nis nga ushtarët.

Pirrua nuk bëri as majtas, as djathtas. Dëgjoi si nëpër tym fjalët e ushtarëve të ndërresës, që por-sa kishin qëlluar me fishekun e parë: «Po Petriti sa mori?» «Dy pikë!» Si ishte e mundur të kishte marrë kaq pak? Pas Çlirimit, po të gjykoje nga provat që ishin bërë, Petriti ishte qitësi më i mirë në kompani. Në një rast tjetër, Pirrua nuk do t'i kishte besuar që ai të kishte marrë aq pak pikë, po tani, pas fjalëve të komisararit, as që mendonte më për qitjen. Hante inat me veten se përse ishte treguar aq i shkujdesur dhe i njëanshëm. Edhe pas të shtimes së dytë, kur thanë se Petriti kishte marrë vetëm tri pikë, përsëri nuk u shqetësua aq sa do të mërzhitej në një rast tjetër. «Gjersa e mora dyshin në politikë, le ta marr edhe këtu», mendoi. Ja nguli vështrimin Petritit, që ishte shtrirë në pozicion. E kuptoi se ai e sforconte shumë veten dhe pushka i lëvizte. «E pat kjo punë», — mendoi Pirrua dhe shënoi me laps një dysh në listë, bri emrit të ushtarit. Po qitja mbaroi dhe raportuan se Petriti me fishekun e tretë kishte goditur dhjetën, duke grumbulluar gjithsejt pesëmbëdhjetë pikë, aq sa duheshin për të marrë «rrogën bazë». Toga e plotësoi dety-

rën, por asnjëri nuk i harroi lehtë ethet që u shkaktoi Petriti.

Ushtarët u vunë në rresht dhe, duke ecur, filluan të këndonin. Petriti priste nga çasti në çast ta thërriste komisari, i cili kishte mbetur disa hapa prapa e po fliste me kapter Hasanin:

— Ju ishit mbrëmë me shërbim këtu. Ç'ngjau me ushtarin? — e pyeti Guri.

— Ku ta dish? — ju përgjegj nënoficeri. — Tha se i kishte ardhur një vajzë.

— Ashtu?! E ç'vajzë që ajo? Nga erdhi?

— E fejuara, thoshte. Po hajde besoi Petritit. Ushtria shoku major, nuk është vend për fejesa e martesë. Pa shikë, për një qime floku na dha notën dysh në qitje. Dhe qitja nuk bëhet çdo ditë. Ai dysh të mbetet peshqesh për tërë vitin. Dhe na rroftë e fejuara pastaj.

Po Guri as që dëgjonte më. Ai ishte i bindur se në këtë mes kishte diçka që duhej sqaruar. Nuk donte të besonte që Petriti të ishte aq i papërmbajtur, sa të mos e kontrollonte veten, sidomos pas fjalës që i kishte dhënë atij dhe shokëve. Ndaj e nxori ushtarin nga rreshti dhe kërkoi të dinte se ç'kishte ngjarë. Në fillim Petriti ngurroi, pastaj ja tregoi me hollësi të gjitha ato që i kishte thënë Flutura mbrëmjen e kaluar:

«Babai ma gjeti letrën tënde në xhep. Sa s'u çmend kur e lexoi. Të ishte atje dhe të shihje. «E dashur Fluturë! — thërriste dhe shkante e vinte nëpër dhomë. Ke parë kështu? E dashur Fluturë! Maskarai. As që bëhet merak se tjetra është e fejuar e nesër do të shkojë te burri. Edepsëzi».

«Pse e shan ashtu, baba, ai nuk ka ndonjë

faj», — thashë unë pa u menduar, në vend që të heshtja e t'i vidhesha nga sytë.

«Si the, moj, si? Pse e shaj, the, apo më bënë veshët? — dhe më lëshoi mbi fytyrë atë dorën e tij të rëndë e tërë kallo. Dhe thua se nuk ditke gjë?! Ti i paske rregulluar telat me të, — dhe m'u lëshua me një mëri të egër e nuk pyeste ku më godiste. U bëra gjak në fytyrë. Dy herë u rrëzova. Ja, buzët i kam ende të plasaritura. Po ai nuk ngopej. S'dija si t'i shkëputesha nga duart. Vrapova te dera dhe e hapa, po ai më mbërtheu nga flokët dhe s'shihte ku më binte.

«Mos qëllo ashtu, se druri është i ndaluar sot», — thashë. Po ai u xhindos më shumë. «Dale pa ta tregoj unë, — tha. — Na qenka i ndaluar druri. Po pëllëmbët janë të ndaluara? Po grushtet? Po shkelmat?» — dhe m'u lëshua përsëri. Nuk di si do t'i kishte vajtur filli, kësaj pune, po të mos hynte në mes xhaxhai dhe të më shkëpuste nga duart e tij. Ja, kështu. Shkova që atë mbrëmje te xhaxhai dhe nuk e pashë prakun e derës, gjersa më iku të nxirët nga fytyra. Thonë se babai, sa më shumë ditë shkonin, aq më shumë xhindosej. Mblesi ja kishte shtrënguar lakun në fyt. Kishte kërkuar të martohesha brenda javës. Po unë isha vulanga-vulanga në fytyrë. Babai u bë pishman që më la e ika. As xhaxhait nuk i flet me gojë. Thotë se, po t'i bie prapë në duar, do të ma ndajë trupin dysh me sopatë. Dhe unë nuk prita më. As që e tëholla punën më gjatë. U nisa e erdha. Tani... në dorën tënde!»

Kështu i kishte thënë ajo. Dhe herë qante e herë qeshte. Lotët e mëdhenj e të ndritshëm, si kristali, i rrukulliseshin mbi faqet e nxehura prush.

Guri dëgjonte e mendohej. Po, ngushtë e kishte pasur ushtari, megjithëse mund të qe këshilluar me të, të kërkonte një mendim. Po kjo kishte kaluar. Tani ai, sidomos vajza, kishte nevojë për ndihmë.

— Ku është Flutura? — pyeti Guri.

— Nuk e di. U ndamë në mëngjez. Këtej rrotull duhet të jetë.

— Shkojmë e kërkojmë.

E gjeti Fluturën po në atë vend që e kishte lënë në mëngjez. Kishte larë fytyrën në lumë, aty afër, dhe ishte kthyer prapë te «shtëpia e tyre», siç e quajti vetë shelgun. Kur e pa se Petriti po vinte bashkë me një oficer, u turbullua aq shumë, sa u mundua të fshihej midis degëve të shelgut.

— Mos u tremb, Fluturë, është shoku Guri, komisari ynë, — e qetësoi Petriti.

«Komisari? E si do të ishte vallë ai?» Po fundja pse të shqetësohem? Gjersa është komisar, i mirë do të jetë patjetër...

— Guri Lena, — ju paraqit majori, duke i zgjatur dorën, dhe bëri sikur nuk e vuri re hutimin e vajzës. — Petriti m'i tregoi të gjitha. Ti ke vepruar tamam si një vajzë revolucionare, ashtu siç thotë partia. Shumë mirë që e shqelmove atë fejesë. Kështu duhet të bëjë një vajzë e zgjuar dhe trime.

Fluturës sikur i shkriu gjaku në damarë. Për herë të parë ngriti sytë dhe e pa. Ç'njeri i mirë! Tamam kështu i kishte përfytyruar ajo komisarët, kur i tregonte gjyshja rreth vatrës histori nga të luftës.

— Po unë e kritikova ashpër shokun Petrit. Pse të mos vinte e të trokiste në derë që mbrëmë? Apo mendon se ne nuk i ruajmë zakonet e mira të

shqiptarit. Dhe e di ç'vendosëm të bëjmë për ta korigjuar gabimin? Të shkojmë që tani në shtëpinë time, ose më saktë në shtëpinë tonë. Ne kemi një dhomë tepër dhe qysh tani ajo është në dispozicionin tuaj. Apo jo, Petrit? — dhe i bëri shenjë atij që të mos kundërshtonte. Ushtarit një fytyrë i ikte, një i vine. Këto ishin minutat e para, që ai nuk mendonte më se ç'do të bënte me Fluturën. I vinte inat me veten kur mendonte se sa pak e kishte njohur komisarin dhe shokët e tij dhe sa keq ishte sjellë në disa raste.

Derën e apartamentit ua hapi Majlinda, e cila porsa ishte kthyer nga shkolla.

— Majlinda, të kam sjellë miq, — i tha Guri buzagaz.

— Mirë se të vini. Urdhëroni, urdhëroni, — dhe ajo hapi derën e dhomës së pritjes. Po pse kështu pa lajmëruar, more burrë, — ju kthye ajo të shokit.

— Më parë njihuni: kjo është Flutura... Shkoza, — shqiptoi ai mbiemrin e Petritit. — Një trimëreshë e vërtetë. Një javë para martesës me një burrë plak, shqelmoi të gjitha paragjykimet dhe erdhi te ai që dashuronte.

— Vërtet? Sa mirë paska vepruar! Të lumtë, motër, — dhe Majlinda ju hodh në qafë dhe e shtrëngoi fort, fort.

— Ajo do të rrijë te ne, gjersa të vendoset në ndonjë punë, ose ndoshta sa të mbarojë Petriti shërbimin ushtarak.

Ata të dy, Petriti me Fluturën, u hutuan dhe herë vështronin Gurin e herë gruan e tij, e cila nuk dinte si ta shprehte gëzimin që ndjente:

— Oh, sa mirë, Guri, sa mirë që e bëre. Ne do

të duhemi si motra. Tani ju shkoni ku të doni, në daçi në stërvitje, në daçi me shërbim. Ne kemi njëra tjetrën.

Ajo e përqafoi përsëri Fluturën:

— Ç'vajzë të mirë paske zgjedhur, shoku Petrit! Po edhe ti, motër, nuk je gabuar...

— Së pari, jepi Fluturës diçka të hajë. Ajo ka që dje pa vënë gjë në gojë («Nuk thua tri-katër ditë, — mendoi Flutura. Po tani s'kam uri, jam e ngopur, e dehur nga lumturia»). — Ne, — vazhdoi Guri — do të shkojmë nga posta të lajmërojmë prindërit që të mos bëhen merak për Fluturën. Pastaj do të kthehemi përsëri.

Dhe dualën.

* * *

Një majin ata gjithmonë e kishin pritur me një gëzim të veçantë. Vjete me radhë, Guri me Majlindën e kishin bërë zakon të zgjoheshin pa zbardhur mirë, të dilnin në ballkonin e katit të katërt të shtëpisë, nga dukej si në pëllëmbë të dorës një pjesë e mirë e rrugëve të kryeqytetit, dhe të vështronin si zgjohej nga gjumi Tirana, si derdheshin njerëzit turma-turma nëpër rrugë. Bashkë me ta derdhej dhe kënga, të cilën sikur ua rrëmbenin nga goja njerëzve balonat e fëmijëve, e shpinin në katin e tyre të katërt dhe e ngrinin edhe më lart, në qiellin e pafund blu.

Megjithëse në mbrëmje bashkëshortët Lena menduan se nuk kishte arësye të ngriheshin herët, të nesërmen u doli gjumi më shpejt nga ç'e llogaritën. I zgjoi buçitja e një daulleje, që gjëmonte çu-

ditërisht shumë në rrugët e ngushta të qytetit rrëzë malit: bam-ba-ba -bam-bam, dhe shoqërohej nga një thirrje gazmore he-he-hej! Guri u ngrit dhe doli në dritare. Që poshtë, nga rruga, e përshëndeti një grumbull fshatarësh, të cilët vinin, siç duket, të merrnin pjesë në festën e shokëve punëtorë. Ai që i binte daulles, një burrë me mustaqe gjer te veshët, më gjoksin leshtor të shkopsitur, i buzëqeshi duke nxjerrë jashtë dhëmbët e bardhë, si zaje lumi, pastaj e goditi më fort daullen, thirri përsëri me atë zë prej basi: he-hej-hej! dhe u largua, i rrethuar nga turma laramane e gazmore e fëmijëve.

Guri mbështeti trupin në parvazin e dritares dhe u kot në mendime. Prapa shpinës në garderobë, ishte varur uniforma e re dhe pranë saj ajo e vjetra, me spaletat e majorit në supe. Megjithëse këtë kostum gjer dje e kishte mbajtur në trup, ju duk si diçka e largët, e harruar, që i përkiste së kaluarës, ashtu si reliket e një muzeumi. Kurse uniforma e re, e thjeshtë dhe e hijshme e tërhiqte pranë, ashtu siç e tërheq kostumi i ri një fëmijë. Befas e rrëmbeu dëshira të lahej, të vishej shpejt e shpejt dhe të dilte në rrugë, në mes njerëzve e ta ndante me ta gëzimin e thellë që ndjente. Po e ndali gjëmimi i një daulleje tjetër dhe rrokopuja e turmës që vërshoi papritmas nën dritare.

Kur rruga ra përsëri në qetësi, Guri ndenji edhe një çast ashtu, me fytyrën e kthyer andej nga u larguan njerëzit, dhe e hodhi vështrimin nga dritarja përballë, në apartamentin ku banonte kapter Hasani. «Edhe ai qenka ngritur shpejt», mendoi kur pa se në kuzhinë ishte ende e ndezur llamba elektrike, e cila, tani që kishte çelur dita, dukej

e zbetë dhe e pafuqishme. Ju duk se, prapa perdes, qëndronte një njeri. Mbase ishte Hasani. Ç'bënte vallë ai në ato çaste? Ç'mendonte? A i rrihte dhe atij zemra me forcë?

Hasani kishte veshur uniformën e re dhe kishte qëndruar një copë kohë para pasqyrës, duke shikuar herë kostumin, herë fytyrën e tij gjatoshë, me mollëzat pak të kërcyera e si të ngurosura. Nuk mund të thoshte se uniforma i pëlqente. Në thjeshtësinë e saj, ajo kishte diçka tërheqëse, të cilën ai nuk mund ta kapte, ta dallonte, por sidoqoftë as që mund të krahasohej me uniformën e gjeratëhershme. Mbase për këtë fytyra e tij e vështronte e hutuar që nga pasqyra. Edhe vetë u çudit me shprehjen e fytyrës, që ju duk e akullt e pa asnjë ndjenjë. Ai hukati mbi pasqyrë dhe vuri re se si, në çast, fytyra e tij u fsheh si e hutuar prapa veshjes së mjegullt. Atëhere e ndjeu veten disi më të qetë e të lehtësuar. Mori të dilte e të shkonte në repart. Por ndjeu hapa në rrugë, të cilat i kujtuan të ecurën e rëndë e gjithmonë të nxituar të major Gurit. Befas qëndroi, pa mundur të përcaktonte se ç'duhej të bënte: të dilte, apo të priste edhe ca. Më mirë të priste. Po sikur të ndeshesh me të përjashta? Si do t'i drejtohej: «Mirëmëngjezi, shoku major?» Po tani s'kishte më grada. T'i thoshte: «Mirëmëngjezi, shoku... shef», «shoku komisar» apo thjesht «shoku Guri»? Jo, jo, nuk ishte punë e lehtë kjo. Duhej menduar më nge, që të mos e qeshnin. Më mirë të priste ca, të shihte si do t'i drejtoheshin të tjerët, pastaj, duke parë e duke bërë. Dhe mbylli derën e s'doli.

Guri ecte me hap të shpejtë. Një ndjenjë e fuqishme padurimi e shtynte që të shkonte sa më

shpejt pranë ushtarëve dhe ta ndante me ta gëzimin që ndiente. Dhe ushtarët e prisnin me kërsëri komisarin e tyre. Si do të dukej ai vallë me uniformën e re? E, ndërsa prisnin, vazhdonin të bisdonin me zë të lartë, gazmorë:

— Pa mendohuni një herë, more shokë, ku e festuat Një majin një vit më parë? — pyeti Andoni, ushtari «një pëllëmbë po gjithë gjëmë», siç i thoshte Zamiri, që i bënte gjithnjë shokët të qeshnin me shakatë e tij të kripura.

Një ushtar psherëtiu.

— Ç'na pyet ku e festuam. Më mirë thuaj si do ta kalojmë sot.

— Pa shiko, na e mori malli djalkën për manë.

— Si në minierën tonë, o shokë, nuk festohet në asnjë vend të botës dita e punëtorisë, — nisi të fliste Sokoli. — Unë, nga ana ime, vjet e pashë veten më ngushtë se çdo herë tjetër. Më takoi të vishesha si prift. Kisha vënë një jastëk në kurriz, një palë syze, që më binin në majë të hundës, dhe një copë lëkurë deleje në vend të mjekrës, që më arrinte gjer te gjoksi. Në njëerën dorë mbaja kryqin e bekoja njerëzit, kurse në tjetrën një kusi për të mbledhur para. Të gjithë fëmijët e minierës m'u mblodhën përreth. Disa më kapnin nga rasua e zezë, disa më nduknin nga lëkura e deles. Nuk kishte torturë më të madhe, vëllezër. Ta dinit sa më dhimbte, se e kisha ngjitur me qiriç atë të shkretë mjekër. Po ku pyesin fëmijët? Ma nduknin dhe herë-herë thërrisnin:

Uratë, bir i perëndisë.

Të na puthç një her në b...

Njerëzit gajaseshin, më keq se me ata që lua-

nin rolin e Kosiginit e të Xhonsonit. Vetëm një plake i erdhi keq për mua dhe më doli krah. «He, lipsuni këtej, more zullapër, — u hakërrua. — Lëreni rehat njeriun e perëndisë. Qenka tamam si papa Thanasi i fshatit tonë, i paçim uratën», — dhe bëri kryqin.

— Një majin e fundit as mua s'më lanë rehat fëmijët, — u hodh Çlirimi. — Tërë natën e natës, duke u gdhirë festa, nuk mbylla sy. Kisha dhënë fjalën se brenda prillit do ta shpyllzoja kodrën në këmbët e fshatit. Më kishte mbetur pa bërë dhe një goxha vend. «Hajde, o djalë, se punën e natës e qesh dita», më thanë kooperativistët. Po unë nuk doja ta bëja fjalën dysh. Ehu, sa ka zanati! Ju përvështa inatshe. Trungun e fundit e hoqa sapo gjëmoi daullja në fshat. Njerëzit kishin dalë në rrugë me kuç e me maç dhe përgatiteshin të kalonin para tribunës së ndërtuar mbi një karrocë katërrrotëshe. Ja shkela gazin traktorit e shkova dhe unë atje. Të shihje sa u gëzuan fshatarët! Më bënë rrugë të dilja në krye. «Klasa punëtore në ballë, pastaj fshatarësia», — thoshin. Dhe më hodhën një flamur të kuq mbi kabinë, hipën sipër fëmijët e fshatit, kurse të tjerët më ndoqën pas, duke kënduar e brohoritur. Ç'festë e bukur, more shokë! Kurrë s'më del nga mendja.

Ushtarët dëgjonin dhe mundoheshin ta përfytyronin Çlirimin duke kaluar rrugëve të fshatit, mbi traktor, i rrethuar nga fëmijët.

— Ti, shoku Andon, si shumë po na blen sot. Pa na thuaj si e kalove vjet Një majin?

— E ç'të them? Për mua ajo qe festa më... «tragjike». Një ditë më parë më kishte ardhur fletë-thirrja për t'u paraqitur në rekrutim. Më thanë se,

pas festës, do të shkoja ushtar dhe më ulën në karrigen e berberit. Unë ju luta atij, i rashë në gjunjë që ta bënte një sy qorr e një vesh shurdh e të më jepte dhe një ditë afat të paktën, sa të kaloja festën, po ku pyeste ai? Ishte një stërhell, që tërë kohën kishte qenë bari dhe kishte qethur dhentë me një gërshërë të madhe, kurse tani që kishte dalë maqina qethëse elektrike, kishte vendosur të ndërronte zanat e të bëhej berber. «Hë, a lumëmadh, se nuk do të të qethim mendjen, po flokët», më tha dhe më vuri gërshërët. Ju luta përsëri, po ai bënte sikur nuk dëgjonte. «Mos e vra kaq shumë kaploqen për leshrat, — më tha më në fund, — se tani është maj e bishtosen edhe bagëtitë».

Shokët qeshën me lot.

— Po pse nuk shkove që atëhere ushtar? — pyeti Zamiri.

— Sepse ata të degës ushtarake menduan se duhej të njihesha medoemos me ty, — u përgjegj flakë për flakë Andoni.

Shpërtheu përsëri gazi. Atë kohë njëri nga ushtarët lajmëroi se po vinte komisari. Bisedat u prenë në çast. Të gjithë u vunë në një rresht, si t'i kishte komanduar njeri. Ushtarët nuk ja ndanin sytë. Ai i takoi me radhë, u uroi festën, pastaj u fut në mes tyre dhe e ndjeu veten më pranë ushtarëve, si asnjëherë tjetër. Ata e rrethuan, vështronin uniformën me shenjat e kuqe në jakë, e cila sikur e jepte edhe më të plotë portretin e komisarit të tyre, dhe pritën ç'do t'u thoshte. Ai e kuptoi këtë dhe nisi t'u tregonte për ditët e paharruara të luftës, kur komandantët dhe komisarët nuk dalloheshin nga lulkat dhe gradat, po ngaqë shkonin të

parët në betejë dhe zgjidhnin frontin më të vështirë, duke hedhur në sulm me shembullin e tyre çetën, batalionin, brigadën partizane. Këto ishin tregime të thjeshta e interesante, pa të cilat nuk mund të kuptohej maji i atij viti, maji i kuq i punëtorëve, i fshatarëve, i ushtarëve.

Ndërkaq, kapter Hasani e bëri zemrën gur dhe u nis për në repart. Ecte si mbi gjemba dhe i dukej sikur të gjithë shikonin nga ai. Kur ju afrua repartit, nuk vendosi të futej brenda. Befas e rrëmbeu dëshira të dilte rrugëve të qytetit. E shytynte për këtë jo aq dëshira për t'u shkrirë me turmën e manifestuesve, se sa një kureshtje e guditshme, që ishte strukur thellë në qenjen e tij. Ecte dhe pyeste veten: si do të sillëshin vallë ushtarët që do të takonte rrugës? A do ta nderonin, apo do t'i shkonin pranë dhe do të bënin sikur nuk e shihnin? Ai përpiqej të tregohej sa më i qetë e i shkujdesur dhe çapitej ngadalë rrugëve të qytetit. Majtas e djathtas kalonin turma njerëzish, po Hasani ua kishte ngulur vështrimin tre ushtarëve, që po vinin kundrejt. Kur ju afruan, bëri sikur nuk i pa, po zemra i rrihte me forcë. Disa hapa përpara, ushtarët kthyen kokën nga ai, ngritën duart tek bustina dhe e nderuan. Ai në fillim u hutua, pastaj u buzëqeshi, u tha «Mirëmëngjezi» dhe e ndjeu veten disi të lehtësuar. U çapit më tej. Përsëri u ndesh me disa ushtarë, të cilët, siç ju duk atij, e nderuan plot respekt, si asnjëherë tjetër. Pastaj nuk priti më: cilido ushtarak që i afrohej, ai ngrinte dorën dhe e përshëndeste i pari, pa vënë re në qe më i ri a më i vjetër në moshë. Madje edhe ushtarët shpejtonin ta nderonin, si të qenë në garë me njëri tjetrin kush të përshëndeste i pari. Madje

edhe punëtorët e kalimtarët e përshëndesnin: «Mirëmëngjezi, shok». Sa shumë të njohur paskësh pasur në qytet! Ai ecte dhe si një refren i bukur, që shoqëronte marshet e transmetuara nga radioja, ngado e uronin: «Mirëmëngjezi, shok ushtarak! Me shëndet uniformën e re!»

— Mirëmëngjezi, shokë! Gëzuar festën!

Dhe ndjente një lehtësi të çuditshme. «Shiko sa e thjeshtë paska qenë! Kurse unë nuk guxoja të dilja nga shtëpia!»

* * *

Gjithë ato ditë Petriti ishte si në ëndërr. Nuk e mbanin këmbët në vend. Në stërvitje ishte vështirë të mateshe me të. Shokët habiteshin ku i kishte fshehur gjithë ato energji! Vetëm kur zihej në gojë qitja, ai bëhej prush në fytyrë dhe priste me padurim çastin kur do të shtrihej në pozicion, që t'u tregonte të gjithëve si dinte të qëllonte. Po edhe në këto raste ai nuk e largonte dot mendjen nga Flutura. Ajo ishte me të kudo që shkonte: në poligon, në klasë, në këndin sportiv. Dhe, ngaqë i dukej se ishte nën vrotimin e saj të vazhdueshëm, mendohej ta bënte çdo gjë mirë, më mirë se të tjerët.

Shokët e kuptonin gjendjen e tij dhe u pëlqente ta ngacmonin. Një mëngjez, Zamiri e pa me vetulla të ngrysurat e i tha: «Ç'ëndërr të keqe na paska parë dhëndërrin ynë sonte?» Që nga ajo ditë, kur ishin jashtë stërvitjes, të gjithë i drejtoheshin me këtë nofkë: dhëndërr. Petriti bënte sikur nuk dëgjonte dhe nuk ishte në gjendje të thoshte në

i vinte mirë apo keq që e ngacmonin kështu. Ç'do të thoshte, vallë, Flutura po t'i dëgjonte?

— Ej, dhëndërr, të kërkon komandanti!

— Komandanti? Pse vallë? Mos kishte bërë ndonjë gabim? Petriti u përpoq të kujtonte vep-
rimet e ditëve të fundit. Jó, nuk kishte hedhur as-
një hap të pamenduar. Pas ardhjes së Fluturës, ai
ishte përpjekur ta llogariste mirë çdo gjë, si në
stërvitje, ashtu dhe në marrëdhënjet me shokët e
eprorët. Po pse e thërrisnin atëhere? Mos ndoshta
do ta qortonin që një ditë përpara i kishin dhënë
liridalje dhe ai nuk kishte vajtur të takohej me
Fluturën? Me siguri që po. Hej, ç'bel! Ai do të
deshte, t'i shmangej takimit me komandantin, por
kishte marrë urdhër dhe duhej ta zbatonte. Pastaj
ku ta dish? Mbase Pirrua do ta ngarkonte me
ndonjë detyrë.

— Ku është komandanti?

— Para klasës.

Ai shpejtoi hapin. Ju paraqit. Pirrua e vësh-
troi ngrysur. «Sa i nxehur që duket! Kushedi ç'do
t'i kenë thënë... Po mbase dhe kam gabuar». Ndër-
sa mendonte kështu, komandanti zgjati një copë
letër. «Hë, hë, ja si qenka!»

— Është bileta e liridaljes, — i tha serioz. —
Gjer në mbrëmje mund të shëtitësh në qytet, sho-
ku... dhëndërr — dhe e mbajti me zor të qeshu-
rën. Petriti e ndjeu se si e mbështolli një afsh
i nxehtë. U skuq i tëri (sa shpejt që skuqej këto
ditët e fundit). «Domethënë edhe ai e paska marrë
vesh si më thërrasin. Po e di unë kush i ka fajet.
Mos më daltë përpara ai Zamiri, pa...» dhe nde-
roi me dorë e kërkoi të largohej.

— I bëni të fala Fluturës nga unë! — tha oficeri.

Petriti u çapit me mëdyshje. Kur e pa se përballë tij po vinte komisar Guri, u hutua edhe më shumë. Hodhi vështrimin anash. Rrugua ishte e drejtë dhe nuk mund të kthehej as majtas as djathtas. «Kjo është e tmerrshme!» Kujtoi fjalët e Zamirit dhe shpejtoi hapin. Mendoj se do ta hidhte lumin me një të nderuar. Po Guri e ndali:

— Për ku kështu?

— Gjer te bufeja, shoku komisar, — u përpoq të dredhonte.

— Ashtu? Po atë letër në dorë, ç'e keni?

— ...

— Për letrën po ju pyes. Ma jepni ta shikoj, — dhe Guri zgjati dorën.

«Ah, kjo letër! Si nuk e futa në xhep?...»

— Është...

— Bileta e liridaljes, ë?

— Siurdhëron.

Guri ju afrua, i hodhi krahun dhe ecën disa hapa bashkë.

— Më jep fjalën se do të shkosh te Flutura. Ajo pret.

Ushtari nuk tha as po, as jo. Ditët e fundit (këtë e dinte mirë komisar) atij i kishin dhënë edhe një herë tjetër leje për të dalë në qytet. Po, megjithëse e kishte pritur me padurim një gjë të tillë, as vetë nuk e kuptonte pse kishte ndërruar mendje në çastin e fundit. Lëri të tjerat, po kush dëgjonte Andonin, Zamirin dhe shokët. «Ej, dhëndërr, më vafsh shëndoshë ti. Paske qenë me një barrë mend ti. Një ditë, dy, dhe hop në qytet. Po ke të drejtë, mor vhan. Dhëndërr i ri, s'i thonë shaka!»

— Ma jep fjalën, Petrit.

— Por... sot kam shërbimin e postës.

— Për atë kujdesem unë me komandant Pirron.

— Po shkoj atëhere, shoku komisar.

Dhe u bë erë. Tani që e vendosi, nuk i mbante dot hapat. Ecte dhe, ndonëse i afrohej shtëpisë gjithnjë më shumë, i dukej sikur i largohej. Nuk i pri-tej sa të takohej me Fluturën. Po kur ngjiti shka-llët dhe u ndal para derës së apartamentit të komi-sarit, qëndroi një hop dhe ndjeu se si i rrihte me nxitim zemra në krahëror. Trokiti dhe mbajti vesh. U dëgjuan hapa. Po sikur të ishte Majlinda? Përsëri do të skuqej dhe nuk do ta kishte të lehtë ta mblidhte veten. Ah, sa i hutuar ishte bërë këto ditë!

Dera kërciti dhe u hap me ngadalë. Para tij qëndronte Flutura. Sa e pa, ajo nxori një «ah!» dhe ju veshën sytë.

— Gjithë këto ditë të kam pritur. Pse nuk ke ardhur? — e pyeti me zërin që i dridhej.

— Kam qenë me shërbim, — tha ai për ta qetësuar. Dhe e vështronte me habi. I dukej se para syve nuk kishte Fluturën që kishte njohur në fshat e me të cilën ishte takuar disa ditë përpara, por një vajzë krejt tjetër. Në vend të fustanit të gjatë e tërë pala, ajo kishte veshur një fustan basme të qepur mirë pas trupit, ngjyrë blu, me një jakë të bardhë, që i shkonte shumë. Flokët e shkurtuar ja nxirrnin edhe më mirë në dukje qafën e gjatë dhe fytyrën e rrumbullaktë, me buzët e fryra e si të mbushura me lëng qershie, kurse në vend të kë-pucëve, kishte veshur një palë pantofla plastmasi shumë të bukura.

— Ti paske ndryshuar krejt! — tha ai i habitur.

— Edhe ti se si më dukesh, — ja ktheu ajo dhe desh të shtonte diçka, po nuk arriti. Nga dera e dhomës doli Majlinda, me fëmijën e vogël në duar.

— Ditka, pa shih kush na erdhi? — tha ajo buzagaz dhe shtoi duke imituar zërin e fëmijës: — Milëdita, xhaxhi Petliti. Mirëse na erdhe. Po ç'u bële gjithë këto ditë, xhaxhi? Teta Flutula të ka plitur. Është bëlë melak teta Flutula. Për pak na u nis pël në fshat.

Petriti ndjeu ambientin e këndshëm e gazmor të shtëpisë dhe ju mbush gjoksi me ngrohtësi. Majlinda kishte fituar shumë nga aftësitë e të shoqit për t'u afruar shpejt me njerëzit e për të mos u lënë shkak që ta ndienin atë ndrojtje që ndien njeriu kur shkon për herë të parë në shtëpinë e një tjetri. Ata qëndruan vetëm disa minuta aty dhe Majlinda u erdhi në ndihmë që të shetisnin. Zbritën me të shpejt shkallët, të zënë dorë për dorë. Kur dolën në rrugë, Petriti ja lëshoi dorën dhe zgjati hapin. Flutura mbeti prapa. Që larg e vështronte Majlinda me vajzën e vogël në duar.

— Teta Flutula, mos i halo ato që ka thënë mami, — foli ajo duke imituar prapë zërin e vogëlushes.

— Jo, jo nuk i haloj, — tha vajza dhe shpejtoi hapin e i doli në krah ushtarit.

— Ç'të ka thënë Majlinda? — pyeti Petriti, kur u larguan e nuk dukej më shtëpia e komisarit.

— Shumë gjëra, aq sa nuk i kam mësuar gjatë gjithë jetës.

— Si shumë ke ndryshuar, Fluturë. Mua më

dukesh tjetër soj. Edhe vetë s'di ta shpjegoj se si.

— Më mirë, apo më keq!

— Natyrisht më mirë, por... megjithatë, si shpejt më duket ca.

— Nga mëngjezi në mbrëmje unë jam si në kurs. Linda më mëson si ta rregulloj shtëpinë, si të vishem, e ku di unë çfarë tjetër. Por për pak harrova kryesoren. Shoku Guri më ka propozuar që të futem në punë. Bile ka bërë edhe përçapje në uzinë.

— Po, po. Këtë ma ka thënë edhe mua. «Nuk është se ju shtyn ndonjë nevojë, — më tha. — Por do të mërzhitet në shtëpi. As ajo dhe as ti nuk do ta keni mendjen të mbledhur. Pastaj puna ka plot të mira. Atje do të mësojë shumë gjëra. Do ta ndjejë veten më të sigurtë, më të pavarur. Mbi të gjitha, do të kalitë ndërgjegjen revolucionare në kudhrën e klasës punëtore». Kështu më tha komisar. Dhe ka të drejtë. Shumë të drejtë.

— Sa shumë gjëra të reja kam mësuar gjatë këtyre ditëve! Nganjëherë më duket sikur, gjer më sot, kam pasur një perde në sy dhe ajo ma hoqi. Thotë se javën tjetër do të më lërë mua të gatuj për të gjithë. E shkreta unë, sa pisk e kam! Jo se nuk kam gatuar ndonjëherë. Por se si më vjen kështu. Më duket se do të turpërohem e nuk do të katranos gjë...

Petriti e dëgjonte dhe nuk ja ndante sytë. Çuditëj me të. Me të vërtetë që kishte ndryshuar brenda atyre ditëve, megjithëse çdo gjë e bënte pak si me sforcim. Vetëm ai kishte mbetur ashtu siç kishte qenë. Të paktën kështu i dukej atij. Kurse ajo...

Gjithë atë pasdite, nuk lanë rrugë të qytetit pa

shetitur e pa i rënë dy-tri herë nga kreu në fund. Herë-herë, kur ndodhej para ndonjë ndërtese të bukur, pranë këndit të lojnavë për fëmijë, kur ndalej para vitrinave të rregulluara bukur apo shihte ndonjë moshataren e saj me fustanin mbi gju, që ecte lozonjare e gjoja mospërfillëse ndaj gjithçkaje që e rrethonte, Flutura qëndronte, harronte ku ishte dhe në ato çaste vetëm veshja e dallonte nga vajza e një fshati të largët malor, që shkelte për herë të parë në qytet. Po shpejt e mblidhte veten dhe i bëhej sikur dëgjonte prapa krahëve zërin qortues të Majlindës: «Teta Flutula, mos i halo ato që të ka polositul mami!»

Kur po mbaronte ora e liridaljes, ata morën rrugën që i çonte në shtëpinë e komisarit. Flutura mbante nën sjetull një basme të bukur, të cilën ja kishte blerë Petriti. Dhe, ndonëse e lodhur, ajo ndiente një gëzim e lumturi të tillë, të cilën nuk e kishte provuar kurrë gjer atëhere. Qyteti, shtëpitë i dukeshin të kredhura në një bukuri mahnitëse, të cilën nuk e kishte vënë re herë tjetër.

Pas asaj dite, ajo doli prapë shetitje me Petritin, Lindën e Gurin.

* * *

Lajmin se batalioni do të dilte për fushim veror dhe do të kalonte një muaj në zemër të maleve, e pritën të gjithë me gëzim, përveç Petritit dhe Fluturës. Tani që kishin filluar të dilnin së bashku, ata i numëronin ditët me gishta gjersa vinte e diela. Por qoftë ata, qoftë të tjerët, madje edhe vetë komisarit, nuk e merrnin dot me mend se, pas

tri ditë marshimi, do të vendoseshin pranë një fshati, emrin e të cilit as që e kishin dëgjuar gjer atëhere, dhe do të qëndronin atje shumë më tepër nga ç'e kishin llogaritur.

* * *

Kur i vështron nga larg, malet sikur të stepin e të trembin me atë madhështinë e tyre hijerëndë. Dhe, kur vihesh në rrugë e ecën drejt tyre, të rrëmben dëshira t'i arrish sa më shpejt majat e t'i kesh nën këmbë. Po mali përsëri sikur të vështron me mospërfillje e me krenari. Sa ngjitesh në majën e parë, mbi kryet të ngrihet lartësia tjetër, që arrin gjer te retë, pastaj maja e tretë, e katërta e me radhë dhe ti thua se kjo garë me majëmalet nuk do të mbarojë kurrë. Kështu u dukej edhe ushtarëve atë ditë që lanë kazermat, qytetin, fushat dhe nisën të ngjiteshin e të ngjiteshin përpjetë. Me orë të tëra gjarpëroi kolona e gjatë shtigjeve e monopateve, buzë arave të mbjella me të lashta, rrëzë vreshtave e nën pemët që zgjatnin degët e të grishnin të uleshe disa çaste nën hije e të pije një gllënjë ujë sa të njomje fytyrën. Në fillim, ushtarët e oficerat sikur nuk e ndien peshën e rëndë të armëve dhe të pajimeve, as orët e marshimit, po dalëngadalë kolona nisi të ndërpritej. Njerëzit i hidhnin si me përtrim hapat, të mbështjellë nga perdja e murme e pluhurit, që kishte përpirë kolonën, dhe merrnin frymë me zor. Vetëm Petriti, i lindur e i rritur në male, ecte gjithnjë në krye. Po të mos ndalej herë pas here për të pritur shokët, askush nuk do të mund ta arrinte.

— Edhe sa kilometra na mbetën? — pyesnin ata që nuk ishin mësuar me ngjitje të tilla e që u kishte dalë djersa mbi xhaketë. — Nuk paska të sosur kjo rrugë!

— Eh, shok i dashur, sa ka zanati! Që sot filllove t'i matësh kilometrat? Po nesër?

— Ke të drejtë ti, Çlirim, se nuk të rëndon gjë mbi shpatulla, kurse unë...

— U lodhe? Ma jep mua mitralozin. Dhe mos u mërzit. Fillimi është gjithmonë i vështirë.

Sa më shumë i ngjiteshim të përpjetës, aq më të rralla bëheshin bisedat me zë të ulët, shakatë. Secili mbarte mbi vete pajimet e rënda, peshën e kilometrave të kaluar dhe të mendimeve. Dhe priste me padurim sa të bëhej pushimi, që të hante një kafshatë bukë e të njomte buzët me një pikë ujë. Kur arritën tek ahishtet, nën këmbët e tyre gurgullonin burimet. Sa shumë burime dhe ç'ujë të kulluar që kanë malet! Zamiri u përkul mbi njërin nga ato dhe freskoi fytyrën. Kishte etje. U mat të pinte. Por, me të afruar buzët, dëgjoji një zë:

— Mos pi, duro edhe ca!

Ngriti kokën dhe dalloi komandant Pirron, që e vështronte rreptë.

— Vetëm një gllënkë, — mërmëriti. — M'u tha pështyma.

— Jo!

Ai u ngrit me përtesë. Me duart e lagura freskoi fytyrën dhe shikoi përreth. Ç'burime të kthjellëta! Kurrë s'kishte parë burime të tilla. Dhe të mos pish pak, sa të njomësh buzën! Pirrua ja lexoi në fytyrë të gjitha këto mendime. I erdhi keq që i

foli ashtu. Po si mund të bënte ndryshe? Uji i malit të pret, sidomos kur je i djersitur.

U çapitën më tej.

Kështu, duke ecur në gjurmët e njëri tjetrit, ata as që e vunë re se arritën në një rrugë të ngushtë, që përdridhej si litar buzë rrëpirës. Ushtarët i hidhnin me ngadalë hapat, duke u kapur pas një gëmushe, dhe shikonin me frikë greminën e hirtë që zbriste pingul poshtë. Po, me kohë, u mësuan edhe me këtë fituan besim në veten e tyre dhe kjo ecje e guximshme, si mbi trarin e ekuilibrit, jo vetëm që nuk i stepte si në fillim, po nisi t'i bënte për vete. Edhe si lanë prapa rrëpirën e u ngjitën në një lëndinë, ku kundërmonte erë trendelinë, ushtarët përsëri ecnin me ngadalë e u dukej sikur kishin nën vete greminën e hirtë plot zaje.

— Pushim, shokë! Gjysmë ore pushim.

Ushtarët u ulën atje ku qenë, pa bërë asnjë hap më tutje. Komisarit nuk i erdhi aspak mirë për këtë. Gjatë gjithë rrugës, ai i binte kolonës nga kreu në fund, duke u dhënë zemër ushtarëve e duke i habitur ata me energjinë e tij. As në minutat e pushimit nuk i zinte këmba dhe. Vetëm kur dëgjoi Çlirimin që bisedonte me dikë tjetër, të cilin nuk e shikonte, se ishte ulur rrëzë një gëmushe, mbajti hapin. Biseda në mes tyre i tërhoqi vëmendjen:

— Pse e zgjidhe trastën? — e pyeti shokun Çlirimi.

Në vend të përgjigjes, tjetri hapi pagurin, piu disa gllënjka e nisi të mbllaçitej.

— Më hahet bukë, o shok. Ke parë kështu ti? Më hahet. Kjo është e keqja. Po helbete, njerëz jemi e kemi dhe uri.

— Mbase edhe shokët kanë uri.

— Le të hanë. Unë s'ua ndala dorën.

— Po nuk është dhënë urdhër për të ngrënë. Ti e di se në ushtri çdo gjë bëhet me urdhër.

Shoku bëri sikur nuk dëgjoi e vazhdoi të mbllaçitej.

— Ti, Andon, vetëm të qeshësh e të llupësh di, — ndërhyri Zamiri. — Ç'do të ngjante sikur të gjithë të tjerët të bënin kështu si ti?

— Do të vinin një gisht dhjamë më shumë dhe do të ngjitnin njëra pas tjetrës njëqind maja si këto, — u përgjegj në çast Andoni, si t'i kishte fjalët në majë të gjuhës.

— Dhe do ta mbaronin racionin e tri ditëve që ditën e parë, pastaj...

— Pastaj shëndoshë shoqëria, rrofshin shokët. Urraaa!

— Nuk është ashtu. Ti çdo gjë e merr me të qeshur. Unë, për veten time...

Komisari desh të dëgjonte si do t'i vinte filli bisedës, po ju afrua Pirrua dhe u ul bashkë me të për të shfletuar hartën e për të rrahur mendimet se ç'duhej të bënin më tej. Pak më vonë u mblodhën ushtarët. Komisarit e mori me mend se ata bisedonin për një problem, që mund ta zgjidhnin edhe pa të e pa Pirron. Vetëm në pushimin e dytë, kur u dha urdhër që të hanin bukë, ai mori vesh se si përfundoi «zënka» në mes Çlirimit, Zamirit dhe Andonit.

— Thashë se mund të hani bukë! — përsëriti Pirrua dhe vuri para vetes racionin e tij. Po, përveç nënoficer Hasanit, asnjë tjetër nuk e ndoqi shembullin e tij. Komisar Guri e ndjeu se diçka kishte në atë mes dhe priste çdo të ngjiste më tej.

— Hajde fol me ta, po deshe, — mblodhi su-

pet kapter paragrafi, siç vazhdonin ta thërrisnin ushtarët në mes tyre edhe tani që ishin hequr gradat. Kanë mbledhur «kuvendin e maleve», me demek, dhe kanë vendosur që të mos hanë.

— Si, si?!

— Ja kështu. Nuk e dinë ata se në ushtri duhet të hash atëhere kur s'të hahet dhe të punosh atëhere kur të pëlqen të dremitësh. Demokraci, thonë. Zëri i masës, me demek! Ke parë kështu ti? Zëri i masës!

Ushtarët dëgjonin dhe heshtnin.

— Folë më mirë, shoku Hasan, si është puna? Po ju, shoku komisar, dini gjë për këtë?

— E nga ta dijë komisar? Këta kanë shpallur «grevën e urisë», — vazhdoi të qeshte me shpoti kapter paragrafi.

— Është shpejt për të qeshur, — ndërhyri Çlirimi. — Më lejoni të sqaroj si është puna? Ja si është. Ne vendosëm t'i propozojmë komandës që ditën e parë të mos hamë fare ushqim, ditën e dytë të përdorim gjysmën dhe të tretën vetëm racionin e një vakti.

— Budallallëk me brirë — e ndërpreu Hasani, i cili nuk ja ndante sytë komisarit, dhe ishte i sigurtë se këtë herë ai do të mbante anën e tij.

— Mos u ngut, — foli Guri. — Propozimi është interesant. Po a mund të më thoni shokë: pse vepuat kështu? Ç'ju nxiti të bënit një propozim të tillë?

Në vend të Çlirimit, e mori fjalën Andoni.

— Në pushimin e parë, — foli ai, — unë kisha uri e fillova të haja pa urdhër. Çlirimi me Zamirin më qortuan. Thanë se unë di vetëm të qesh dhe të... llup! Atëhere ua ktheva se edhe unë mund të

duroja, madje, po të qe nevoja, mund të mos haja fare drekë. Ja, kështu, më prekën në sedër. Koka bën, koka pëson. Po Zamiri nuk m'u nda. «Po nde-nje ti një vakt, — tha, — ne do të rrimë një ditë pa ngrënë fare». «Ju me mua bashkë, — ja kthe-va. — Delen që ndahet nga shoqet, sidomos këtu, në mal, e ha ujku». Dhe u mblodhëm të gjithë, kur ju bisedonit me komandant Pirron, e...

— Po mirë, mirë, unë dua të di diçka tjetër: ç'ju shtyu ta bënit një gjë të tillë? Ashtu, kot e bëtë, inatshe? Rastësisht?

— Jo, shoku komisar, pardje ju na treguat se, gjatë luftës, partizanëve u ka takuar të marshojnë e të luftojnë me ditë të tëra zhveshur, zbathur e pa vënë një kafshatë në gojë. Kështu mund të na takojë edhe ne një ditë, ndaj duhet të kalitemi.

— Pallavra! — nuk ju durua nënoficer Hasanit. — Kalitja nuk bëhet si ç'më shkrep në kokë mua dhe ty, por në bazë të një plani, në bazë të rregullave. Dhe, në daçi ta dini, shokë, rregullorja as që e bën kabull të merret me një gjë të tillë.

— Pse nxitoheni kështu, shoku Hasan.

— Domethënë, edhe ju, shoku komisar, jeni dakord me propozimin? Nuk më besohet. Kurrën e kurrës s'më besohet. Mbase e kam dhe gabim, por një gjë të tillë s'ma ka zënë veshi ndonjëherë. Më ranë dhëmbë e dhëmballë në ushtri, por këtë — pse të gënjej? — nuk e kisha dëgjuar.

— Shumë gjëra s'i kemi dëgjuar, po do t'i dëgjojmë. Apo jo, shokë? Unë, për veten time, bashkohem me mendimin tuaj. Nuk ma merr mendja të bëjmë ndonjë gabim, përderisa, në fund të fundit, përtërijmë një traditë të luftës sonë. Në luftë ngjet

gjithsesi. Duhet kalitur edhe trupi, edhe truri. Apo jo, Andon?

— Siurdhëron, shoku komisar, — ja ktheu ush-tari dhe shtrëngoi fort rripin.

* * *

Kolona dridhej pa krye e fund faqes së malit, që zbriste thikë poshtë, buzë përroit, ku ujët binte në theqafje duke shkumuar. Përballë një mal tjetër e më tej dergjeshin e dremisnin binjakët e tij, maja hijerënda, të mbështjella me pelerinën e blertë të pranverës. Duke i vështruar ato, nga kreu i kolonës njëri ja mori këngës: «N'ato maja rripa-rripa, seç gjëmonte». Kënga mbështolli në gjirin e saj kolonën dhe e ngjiti nga maja në majë. Vetëm andej nga fundi, Andoni kishte mbledhur përreth katër-pesë vetë dhe u tregon-te për byrekët e gjellët që gatuhën me mish lope, qingji e zogu, thuase kishte përpara librin «Si të gatuajmë».

— Ta dini ç'gjellë të mira gatuante nëna ime, more shokë, — thoshte ai, duke lëpirë buzët. — Dhe si ma gjente midenë. Që thoni ju, në dy javë një herë unë hiqesha si i sëmurë. Ajo ja kë-puste kokën një pule fap, ja mbushte barkun me thelpinj arrë dhe e piqte në furrë. Ç'gjë e shijshme, more shokë! Edhe në shtratin e vdek-jes të ishe, për njëzet e katër orë do të ngrihe-she në këmbë. Më plaçin sytë në ju gënjej. Unë e haja dhe hopa nga krevati. Nëna më ndiqte pas: «Ç'do tjetër, shelegu i nënës? — më pyeste. — Mos kujto se hëngre kushedi se çfarë; fundja

pula nga një vezë ka dalë». Qafsha kokën tuaj që kështu më thoshte.

— O Andon, lëri muhabetet dhe jepu këmbëve. S'mbeti meny restoranti pa na përmendur. Lër dhe ca për nesër, që të mos mbetemi thatë.

— Qetësi andej nga fundi. Na i mbushët gojën me lëng.

— Opo këta! — ankohej Andoni. — As me bukë, as me fjalë nuk të lënë të ngopesh!

— Luaji këmbët, Andon! — e ngacmonin prapë të tjerët.

— Luaji, luaji, po na mbaroi karburanti. Nuk punon motori.

Shokët qeshnin me fjalët e tij dhe e harrojnë lodhjen.

Nata i zuri buzë pyllit. Në lëndinë, nën kurorën e pishave, u ndezën zjarret. Zjarre partizane. Rreth tyre u grumbulluan ushtarët. Dhe nisën këngët, bisedat, dhe, bashkë me ushtarët, zunë të ngroheshin edhe tregimet partizane.

— Tej, në malet që zbardhojnë dimër e verë, — tregonte komisari, — kaloi atë vit brigada jonë. Ishte vjeshtë. Vjeshta e dyzetekatrës. Armiqve s'u zinin këmbët dhe. Ishin struktur thellë midis shkëmbinjve e kishin bërë vendin pëllëmbë e mitraloza dhe kujtonin se atje nuk do të mund të futej këmbë partizani. Të gjitha shtigjet i kishim zënë. Po kompania jonë, në një natë si kjo, ju ngjiti me thonj e dhëmbë shkëmbinjve dhe i gostiti mirë armiqtë me plumba e bomba dore. Ata nga sytë këmbët. S'e pa i pari të dytin».

Ushtarët dëgjonin. Vonë, shumë vonë gjumi ua rëndoi qepallat. Dhe ashtu, duke dremitur,

me flatrat e ëndrrave, i ngjiteshin edhe ata, bashkë me komisarin, shtegut të thepisur e i binin armikut atje ku nuk e priste... Vetëm Çlirimit nuk i flihej. Pasi la shërbimin e rojes, e rrëmbeu dëshira të futej thellë në pyll, nga dëgjohej pandërprerje kënga e gjelit të egër. Dhe humbi nën kurorat e pishave, midis të cilave dukeshin e humbisnin përsëri copa qielli dhe vezullime yjesh. Ai kishte lexuar për pyjet, kishte shkukur me traktorin e vet hektarë të tërë me lisa e shkoza, duke i rrëmbyer me forcë malit bukën, po pyje të tilla nuk kishte përfytyruar dot gjer atëhere. Ecte mbi sfungjerin e gjetheve të kalburra, duke thithur ajrin e lagësht, që herë mbante erë lëng pishe, herë të kujtonte manushaqen. Nën këmbë kërcisnin degët e thata, kurse majtas e djathtas rrëshqisnin zogj të trembur, kafshë të egra. Çlirimi habitej me pyllin e i dukej sikur edhe ai dremiste e mërmëriste nëpër dhëmbë mijëra fjalë, si t'i ishin ngjallur edhe atij, si komisarit, kujtimet për vitet e luftës, vitet partizane.

Të nesërmen, pa çelur mirë dita, ushtarët nisën përsëri marshimin. Përpara kishin majën më të lartë. Ata ngjiteshin e ngjiteshin dhe ndalonin një hop për të soditur panoramat magjepsëse, që shpaloste natyra para syve të tyre. Ahet shponin qiellin. Nëpër degët e tyre depërtonin rrezet e diellit dhe endnin në mes fletëve mijëra rrjeta të arta, të tejdukshme. Pylli dihaste e lëshonte një afsh të vakët, kundërmues, kurse poshtë, nën këmbët e tyre, blegërinin bagëtitë e bariu i binte xhurasë. Ushtarët habiteshin kur shihnin se si mplekseshin atje lart ahet me shkëmbinjtë, mali shkëmbor me lëndinën e butë, toka me qiellin,

kur vinin re se sa afër njëri tjetrit ndehej qilimi i blertë me çarçafin e bardhë të dëborës. Diku pranë kishte çarë bardhësinë e virgjër një lule e ndezur. Pranvera ishte ngjitur në ato maja me tërë gjallërinë dhe bukurinë e saj, edhe pse pak e ndrojtur dhe e vonuar.

Ja dhe maja më e lartë. Ata ecnin kreshtës, që dukej si një teh shpate, vështronin se si kacavirëshin pjerrësitë nga të dy anët dhe e ndjenin veten një me malin, të fortë e të papërkulur si ai. Pastaj filloi zbritja, si e rrëkeve të malit që e ndalojnë vrapin në luginë. Ushtarët çuditëshin me tekat e malit. Me sa vështirësi ua dha ai lartësinë dhe ç'dorëlëshuar tregohej për fushat! Më në fund, kolona arriti buzë lumit. Ata ecnin anash dhe vështronin si luante uji me shkëmbinjtë, gjersa arritën te vahu, ku lumi ndehte shpatullat i lodhur në shtratin që ua kishte rrëmbyer brigjeve. Atje u kapën dorë për dorë dhe, ashtu si qenë, të veshur, vazhduan ecjen, mengadalë e si me frikë. Kur kolona e preu lumin mespërmes nga njëri breg në tjetrin, Pirrua bisedoi për diçka me komisarin.

— Ajri! — thirri befas komandanti.

Ushtarët u hutuan një çast, po shpejt e mblodhën veten. Ata që nuk kishin arritur ende te lumi u shtrinë më shpinë atje ku qenë, dhe drejtuan armët nga qielli. Kurse ata që ishin duke kaluar lumin, vazhduan ecjen.

— Aeroplanët «armiç» e diktuan kolonën dhe po marrin pikiatën mbi lumë për të hapur zjarr — sqaroi pas pak Pirrua dhe priste me kureshtje se ç'do të ngjiste. Pushkatarët shtuan shpejtësinë për të dalë nga lumi kurse mitralieri me ndihmësin mbajtën hapin dhe ngritën kryet lart. Po sikur të

zbrisnin vërtet pingul aeroplanët armiq dhe të lëshonin plumba e bomba mbi lumi, ç'do të bënin ata? Ç'mund të bënin?

Teksa mendonte ashtu, shenjuesi mbushi mitra-lozin, shkëmbeu disa fjalë me shokun, pastaj iu afrua, nxori mbi supin e tij grykën e mitralozit dhe hapi zjarr me breshëri. Guri e vuri re dhe nuk e fshehu dot habinë. Pa shiko ç'metodë e thjeshtë dhe interesante për qitje nga lumi!» Sa paska zanati! ...» kujtoi ai shprehjen që e përdorte atë shpesh Çlirimi. Dhe shpejtoi hapin për nga lumi. Po dëgjoi një zë të shqetësuar që prapa krahëve:

— Ej, ç'po bëni ashtu ju te lumi? Pa prisni, prisni!

E dalloj që ishte Hasani. Ktheu kokën dhe e pa se si zbriste që lart, duke u penguar nëpër shkëmbinj, thuase do të rrëzohej nga çasti në çast. «Ç'ka ngjarë? — mendoj komisari. — Mos vallë po na mbytet njeri?»

Hasani mezi merrte frymë nga nxitimi. U ndal te bregu dhe vuri duart në ije. Ushtarët qenë kthyer të hutuar nga ai dhe e kishin ndërprerë qitjen.

— Ç'keni kështu? — e pyeti Guri.

— Si ç'kam, shoku komisar? Kjo është e.., tmerrshme. Ata po hapin zjarr nga lumi!

— Shumë mirë. Ç'të keqe shihni këtu?

— Po gëzhojat, shoku komisar? Gëzhojat po na i merr lumi. Si do të mund t'i justifikojmë në dokumenta fishekët e harxhuar?

Disa veta nuk e mbajtën dot gazin.

— Thamë se ç'pate! — mori frymë i lehtësuar Çlirimi. — Po kjo është luftë, vëllaçko, luftë!

Hasani hodhi shikimin përreth. I gjithë batalioni i kishte ndërprerë veprimet dhe që kthyer

nga ai. Hasani s'e kishte parë veten herë tjetër aq ngushtë. Ai i vështroi një për një fytyrat e ushtarëve. Dhe në sytë e tyre ai lexoi shumë më tepër nga ç'mund të shprehnin me fjalë në atë rast.

— Ta kanë marrë mendjen dokumentat e formularët, o lumëmadh, — shtoi Çlirimi. — Hiqe, ore, atë perde që të ka zënë sytë dhe shiko me ç'vrull vërshon jeta.

«Si nuk e sheh se ushtarët gjetën një zgjidhje me të vërtetë interesante, për të cilën duhen lavdëruar?» — sikur i thoshte Pirrua tek e vështronte ngultas.

Kurse Andoni:

«Ti sikur ke lindur burokrat, o i gJORë!»

Po komisari ç'mendonte vallë?

«Nuk e prisja nga ti edhe këtë, o Hasan».

Hasani nuk e kishte të lehtë t'u qëndronte gjithë atyre vështrimeve, që i flisnin aq shumë. «Më duket se e teprova këtë herë, — qortoi veten. — Pse u nxitova, xhanëm?» Dhe ngriti përsëri sytë. Ushtarët nuk kishin lëvizur nga vendi. As komisari. «Duhet ndihmuar më shumë ky shok të eci me kohën dhe kolektivin» — mendonte Guri.

— Ajri u zhduk! — komandoi me zë të lartë Pirrua, duke i përgëzuar ushtarët për veprimet e përpikta, sidomos ata që bënë qitje nga lumi.

Kolona dredhoi sërish monopateve.

* * *

Në buzëmbremjen e ditës së tretë të marshimit, batalioni arriti në vendin e parashikuar. Ai ishte një rrip toke, në njërin krah të së cilës gurgu-

llonte uji i përroit, kurse përballë tij ngriheshin mbi kurrizin e njëra tjetrës një vargan kodrash të veshura. Sa arritën atje, Andoni hapi çantën dhe filloi të hante racionin e të tri ditëve, Petriti i vuri krahët një lisi dhe u mundua të përftyronte rrugën që kishin kaluar për ta kuptuar më mirë se sa ishte larguar nga Flutura, kurse Hasani hapi rregulloren e nisi të lexonte kapitullin mbi fushimet. Pak më poshtë, Pirrua kishte mbledhur rreth vetes vartësit dhe caktonte bashkë me ta vendet e secilit nënrepart, të mensës dhe të klasave fushore. Ata ngjanin me një grup ndërtuesish, të cilët bënin piketimet dhe përgatiteshin për të hedhur themelet e veprës së ardhshme.

Më vonë se kudo, nata bie në maja malesh. Ajo pushton me krahët e saj të zinj në fillim përrenjtë, luginat dhe ngjitet si e trembur e tinzare lartësive. Po atje përsëri nuk arrin ta shtrijë plotësisht pushtetin e saj.

Çlirimi qëndroi një kohë i habitur, duke vështruar se si hidhte vallen nëpër gropa e rrëke malesh, se si e nxirrte kokën ajo që prapa pemëve e shkëmbinjve. Pastaj shpalosi fletën e çadrës, e bashkoi me të Petritit dhe të dy nisën të ngrinin «shtëpinë» e tyre. Gjer vonë u morën me hapjen e kanaleve rreth çadrave dhe ndërtimin e dyshekëve prej fierzash, pastaj hodhën mbi vete bataniet dhe i kapiti gjumi i thellë, gjumi i lehtë e i ëmbël i maleve.

Të nesërmen nuk u ngritën shpejt. Dhe nuk do të ishin ngritur akoma, po të mos kishin dëgjuar zërin e fortë të rojes. Dikush u kthye në anën tjetër, kurse disa u ngritën ndenjor. Guri u kopsit dhe doli nga çadra. Përtej, në hyrje të repartit, dalloi një grup fshatarësh. Ata kishin marrë drejt rrugës.

këmbësore, që e nxirrte kryet pranë vendit të fushimit, dhe kishin shtangur për disa çaste të habitur. Para tyre që çfaqur befas qyteza e ushtarëve me çadrat e hirta, të vendosura në një vijë të drejtë, si t'i kishte marrë agimi me vete kushedi se nga dhe t'i kishte hedhur pranë fshatit të tyre. Ata shpejtuan hapin, të nxituar nga kureshtja, që të shihnin ç'kishte ngjarë, nga kishin dalë ato çadra, por dëgjuan zërin e fortë e të rreptë të rojes:

— Ndal!

I mbajtën këmbët si me zor dhe vështroan andej nga erdhi zëri. Po nuk mundën të dallonin njeri. Pritën edhe pak, pastaj përsëri nisën të çapiteshin. Po zëri i rojes u derdh që sipër edhe më kumbues, si të dilte nga gjoksi i malit. Fshatarët panë njëri tjetrin të habitur. Tërë jetën ai rrip toke kishte qenë i fshatit, i tyre, dhe tani, kur shihnin njerëz të tjerë, kur dëgjonin atë zë rrënqethës, provonin një ndjenjë të çuditshme. Kërkuan të flisnin me komandantin. Dhe, pa e mbaruar mirë fjalën, panë një oficer shpatullgjerë, me një fytyrë prej babaxhani, që shpejtonte hapin drejt tyre. Ju duk sikur e kishin parë atë njeri edhe herë të tjera, sikur njiheshin me të prej kohësh, dhe vranë mendjen për të dalluar se cili ishte.

— Mirëmëngjezi, shokë kooperativistë e mirëseardhët, — i përshëndeti komisar Guri dhe u përçafua me radhë me ta.

— Mirëmëngjezi, shoku oficer, — ja kthyen ata përshëndetjen. Vetëm njëri, më i riu ndër shokët, i veshur me një palë kilota doku dhe një bluzë lëkure, seç u përtyp nëpër dhëmbë.

— Do të donim që përshëndetjen «Mirëseardhët»

t'jua kishim thënë ne, por ju as që na pyetët para se të ngrinit çadrat, — foli ai pas pak.

Guri u zu ngushtë.

— Erdhëm shumë vonë, — u përpoq të shpjegohej. — Potnuaj në mesnatë. Pastaj, thamë se këtu ishim në... shtëpinë tonë, — shtoi duke vënë buzën në gaz.

— Ne s'kemi asgjë të ndarë, — e mori fjalën njëri nga fshatarët, një burrë i thyer në moshë, i pakët nga trupi, po i shëndetshëm, me një bustinë të vjetër ushtarake në kokë, i cili i kujtoi Gurit babanë e tij. — Ju jeni fëmijët tanë dhe, po të doni, urdhëroni e flini te ne, se jashtë të pret veriu. Por... — dhe nuk u dha dot rrugë mendimeve.

— Ashtu është, xha Malo, — e plotësoi ai që kishte folur i pari, i veshur me bluzën prej lëkure. — Por, ti e di, ne e kishim caktuar këtë vend për stallat e lopëve, ndaj dhe u ngritëm që me natë e erdhëm të shihnim ku t'i ndërtonim e si do t'i ndërtonim. Dhe, ju lutem, të na kuptoni drejt shoku oficer: ne mendojmë të krijojmë të parën tufë të lopëve në kooperativën tonë, që do të jetë e para në tërë këtë krahinë, e të thyejmë kështu një koncept. Çështje koncepti, shok, — përsëriti ai me gjuhën e një njeriu, që i përdor këto fjalë disa herë në ditë nëpër mbledhje.

— Kur është kështu, ju kërkojmë falje. Ne mund ta ngremë fushimin qysh tani dhe të vendosemi në një vend tjetër, ku t'ju duket dhe juve më i përshtatshëm.

Djaloshi i veshur me bluzë lëkure hapi krahët anash, si të donte të thoshte me këtë: «Keq na vjen, por s'kemi ç'bëjmë». Por këtë radhë fjalën ja rrëmbëu nga goja plaku me bustinë ushtarake:

— Mos e merr me vrap, shoku agronom, merre më shtruar. E di si themi ne këtej, o shoku oficer? Atje ku vure këmbët, të rënçin dhëmbët. Kështu themi. Urdhëro ndize një herë tani e të bëjmë një dorë muhabet. Nuk e di ç'thonë të tjerët, po mua, për këtë tokë, më kishte marrë malli të shihja ushtarë në këto male. Dhe jo një e dy, po kështu si jeni ju, shumë.

— Unë jam plotësisht dakord, po stallën e lopëve ku do ta ndërtojmë? — pyeti agronomi si të mos i kishte dëgjuar fjalët e fundit.

— E pse të mos e ngremë atje poshtë, të themi, te bokërima. Edhe lumin e kanë më pranë e do të shuajnë etjen kur të zërë vapa.

Kooperativistët vështruan nga bokërima dhe ranë disa çaste në mendime.

— Vend shumë i mirë, — tha njëri syresh. — Më afër fshatit për të mirë e për të keqe.

— Ashtu qoftë, — shtoi agronomi. — Shumica vendos. Gëzuashi. Për çdo nevojë që të keni, shoku oficer, ne nuk do të kursehemi.

Plaku përdrodi mustaqet i kënaqur dhe thithi çibukun që po i shuhej.

— Ashtu, de. Tani fole fjalë me mend. Është djalë i mirë, shejtani, — ju drejtua Gurit. — Nuk ja gjen shokun. Vetëm se rrëmbehet shpejt, e zë me vrap, si ajo pela ime, që i kanë rënë dhëmbët dhe mbetet pastaj në mes të rrugës.

Ai fliste ngadalë, thithte papushim çibukun nga dru shqope, ku kishte gdhendur një fytyrë njeriu, dhe përdridhte vazhdimisht mustaqet e zbardhura.

— Kështu, more djalë. I kishte marrë malli këto male për ju. Për këtë tokë në ju gënjej. Na kujtoni partizanët me atë yllin në ballë. Se kanë

qenë partizanët edhe në anët tona, o bir, dhe kanë luftuar si trimat. Po të vështrosh këtyre ledheve, do të gjesh kushedi sa fishekë të djegur e copa bombash.

— Mos do të na i tregosh përsëri atë historinë e lumit, xha Malo! — e ngacmoi agronomi, duke i shkelur syrin komisarit.

— Pse, mërzitësh zotrote? Domsodo, ti e gjete sofrën shtruar, bashkë me shokët, ndaj më flet ashtu, — shfryu me zemërim plaku. — Po kjo kockë e di ç'ka hequr, — dhe goditi me grusht krahërorin.

— Jo, xhaxha, ai bën shaka. Ngjarjet e luftës nuk i mërztin kurrë të rinjtë. Po si është ajo historia e lumit?

— Ehu, të shkuara e të harruara, more shok. Si e ke emrin ti? Guri? E gëzofsh. Një ditë tjetër, shoku Guri.

— Po e tregoj unë atëhere, se e kam mësuar përmendësh, — luajti urët agronomi dhe si, u kollit, shkundi disa herë në takën e këpucës një dru, siç bënte xha Malua me çibukun, e shpuri dorën të mustaqet, duke imituar atë, dhe nisi të fliste:

— «Ka qenë një dimër i egër, more djem, për këtë tokë në ju gënjej, që ta ngrinte edhe fjalën në buzë...»

— Ti hesht, se kam vetë gojë unë, — e ndërpreu thinjoshi. U kollit tri-katër herë, përdrodhi mustaqet dhe ja nisi:

— Po, po. Ashtu ka qenë, vërtet. Dimër i egër...

Guri dhe fshatarët e tjerë nuk e mbajtën dot gazin kur vunë re se sa mirë e kishte imituar agro-

nomi zërin e xha Malos. Po plaku ishte mësuar me këtë dhe nuk e prishi terezinë. E mbushi së dyti çibukun me duhan dhe e thithi disa herë, gjersa u ndez.

— Po, po, edhe fjala të ngrinte në buzë. Ke qenë në luftë ti, o shoku Guri?

— Kam qenë.

— Ashtu më ruash. Po nga anët tona të ka rastisur të kalosh?

— Si të them? Edhe kam shkuar, edhe s'kam shkuar. Si nëpër tym më kujtohet. Ka qenë natë, më duket, mbase edhe mëngjez i thellë, s'më bie mirë ndërmend.

— Ashtu ka qenë, ashtu edhe atë ditë. Për këtë tokë në të gënjej. Kohë të keqe nuk kishin parë këto male. Dëbora kallkan dhe retë ishin ulur aq shumë e nxinin e rëndonin, sikur i mba-je në kurriz. Qe drekëherë, po dukej si ndajnatë. Ne ishim në mulli, kishim dalë pa feksur mirë e prisnim mos vinte njeri të bluante. Po kush kishte bereqet në atë kohë, more djem? Qëndronte rrota e mullirit e mbërthyer në dru, i binte ujët përsipër dhe të dukej sikur shkrihej në lot për një dorë bereqet. Pa rrinim ne dhe përgjonim rru-gën. Kur ja, u tund vendi nga një gjëmim i fortë. Mos shkrepni vallë afër? Dhe dolëm jashtë, bashkë me plakun. Kur ç'të shohim? Disa njerëz të armatosur afrohen si hije. Qëndrojnë para mullirit. Vështrojnë. «Ç'jeni ju?» — u thotë plaku duke fërkuar sytë. «Partizanë. Po afrohen gjermanët. Ata janë shumë. S'i presim dot këtu». «Ka një guvë atje tej, të mbuluar me kulpër, që nuk i vete mendja njeriut për pesëqind vjet. Futuni atje». «Jo, duam të kalojmë lumin. Ku është vahu?» Plaku

I shpuri te lundra (se kishim bërë një lundër për të kaluar lumin mëngjez e darkë) dhe i hodhi të gjithë përtej. Pastaj u kthye në mulli. «Unë do të rri këtu, — më tha. — Po na i prishën mullirin, njëlloj kemi për të vdekur. Ti shko në guvë. «Ishte e kotë t'i kundërshtoje. Ai s'duronte t'ja bëje fjalën dy. Shkova. Kur ja, poftisën gjermanë e ballistë, mizë lisi. Unë i vështroj nga guva. Ata e nxjerrin plakun nga mulliri. E shtyjnë me majat e bajonetës. «Ku i shpure partizanët?» pyesin dhe sytë u kullojnë gjak nga inati. Plaku ngre supet. Ata e shtyjnë më tej. «Ç'e bëre lundrën? — pyesin. Po ai hesht, si rrota e mullirit. Për këtë tokë në ju gënjej. Më në fund e gjejnë lundrën ku qe fshehur. Hipin shtatë-tetë veta në të, bashkë me plakun. Ai e kuptoi ç'e priste kur t'i hidhte në bregun tjetër. Dhe e ndau mendjen. Sa arriti në mes të lumit, kur ja, ujët bie me vete një kërcu të madh. Ai bën sikur do t'i largohet, e mbërthen varkën me të dy duart, frap ja bën, e përmbys e nuk ngrihet më, bashkë me ta. Gjermanët çmenden, ulërijnë, duan t'i vënë flakën mullirit, por nuk arrijnë. Partizanët kanë ngritur pushkë e mitraloza këtej, nga këto kodra, dhe i kositin si fije kashte. Ata s'kanë ku të futen. Toka nuk u hap vend t'i fshehë. Ngrenë dhe gjermanët pushkë e mitraloza, po s'kanë ç't'u bëjnë partizanëve, që i ka fshehur mali në gjoks. Japin sa japin, i lënë aty një fushë me të vrarë dhe ikin nga sytë këmbët. Ja, kështu, more shok. Për këtë tokë, në thashë një fjalë të tepërt.

Xha Malua heshti. Mbushi çibukun me duhan, e tymosi dhe e treti vështrimin tej nga lumi, ku shkumbonte ujët dhe zbardhonte çatia e mullirit të

moçëm. Në bregun e përtejme shushurinte gruri dhe përkulte kryet e ngarkuar me bukë, si të don- te të nderonte kujtimin e mullixhiut trim. Nga la- pidari buzë arës, ai dukej sikur i tregonte bukës së re legjendën e trimërisë, që u thur njëzet e ca vjet të shkuara në ato brigje.

* * *

Xha Malua u bë miku më i afërt i komisar Gurit dhe i gjithë batalionit. Në mëngjez, para se të dilte në punë dhe në mbrëmje vonë, kur do të ngjitej në fshat, ai bënte ç'bënte dhe kthehej një herë nga «djemtë», bisedonte me ta, u fliste për jetën e kaluar, u tregonte se si u ngrit një vit më parë kooperativa edhe në fshatin e tyre malor.

— Sa hodhi parullën Kongresi, na erdhi një shok i komitetit dhe na mblodhi. Një palë njerëz i kishin vënë shpatullat zjarrit dhe nuk u vinte mirë të ngriheshin. Unë shkova i pari: «Ç'thua ti, xha Malo?» — më thotë delegati. «Shumë u vonu- am, — ja kthej unë. — Edhe më parë të bëhej kjo punë, më mirë do të ishte». Po ku dëgjonin ca brumbuj? «Rrini rehat, o njerëz! Ç'do të bash- kojme ne, gurët?» — thoshte hoxha. «Dakord je- mi, — hidheshin dhe ca të tjerë. — Ndenjëm që ndenjëm, le të presim dhe ca». Tani janë shtruar si kau në brazdë. E shohin ç'është kooperativa. Vetëm hoxhë efendiu më tund tespijet gjithë di- tën dhe qendis nuska e marifete.

— Po ti, xha Malo, beson?

— Unë..? Vetëm kur më zë cërma e kujtoj perëndinë, pa, kur jam mirë, as që pyes për të.

— Po plaka, ç'thotë plaka?

— E ç'do të thotë? Kapellon e ke, qillotat i ke, gjej dhe një palë çizme e një pallto, thotë, e vishu dhe ti ushtar. Je mësuar si kau në grazhd, o i zi. Si do të bësh kur të të ikin djemtë!

— Do të vete, moj, do t'i gjej atje ku të jenë, — ja kthej.

— Po ne do të rrimë së paku edhe këtë dimër, në mos më gjatë, — hyri në bisedë komisar Guri. — E mban mend si the atë mëngjez: «Ku vënçi këmbët, ju rënçin dhëmbët».

Xha Malua hapi sytë dhe vështronte herë komisarin, herë ushtarët.

— Si the, o shoku Guri, apo bërë gjë shaka?

— Jo, xha Malo. Komanda jonë, ata lart — më kupton? — vendosën që ne të rrimë e të stërvitemi për një kohë këtu, meqë vendi është shumë i përshtatshëm.

— Vërtet, komisar?

— Po, po, xha Malo.

— Epo pse heshtni, more djema? Pse nuk ma thatë që në fillim? Nuk e dini se ky është një sihariq për fshatin tonë? — dhe u ngrit e u përshëndet me ushtarët. — Shkova t'u jap sihariqin të gjithëve. Ta dini sa do të gëzohen. Për këtë tokë që do të gëzohen.

Guri e shoqëroi me sy gjersa u largua. «Ç'ma nxori krejt mallin e babait», mendoi.

Të nesërmen në mëngjez, sa zbardhi dita, fushimi u zgjua nga zëra gazmorë dhe troku i kuajve. Një karvan i tërë, i ngarkuar me trarë e gurë, ju ngjit përpjetë kodrës dhe u ndal para fushimit të ushtarëve.

— Ku je, o shoku Guri? — foli xha Malua.

— Pa ngrehu një herë dhe hajde të dredhësh një cigare.

Komisari doli nga çadra e tij, vështroi karvanin dhe nuk po kuptonte se çfarë po ngjiste. «Mbase duan t'u lërojmë vendin për stalla», mendoi.

— Pa hajde, o komisar, hajde e mos bjerë ashtu në të thella. Na thuaj ku ta shkarkojmë qerestenë. Na trego vendin. Ustallarët do t'ja nisin menjëherë punës.

— Filloni ku t'u bëhet më mbarë, — tha komisar i tek po afrohej. — Për ne njëlloj është. Do të gjejmë një vend tjetër.

— Si ore, vend tjetër? Po ne për ju i kemi, për papanonet, apo nuk e thashë mirë, o djalë i Shemes?

— Për kapanonet e ushtarëve, — e korigjoi ushtari i liruar.

Guri vetëm tani po e kuptonte ç'po ngjiste dhe vështronte i habitur varganin e gjatë të kafshëve, fshatarët që i mbanin nga kapistallet e që prisnin ku t'u caktohej vendi për shkarkim.

— Ja këtu, shokë, këtu. Ju faleminderit shumë. Po dale një herë ta marrim vesh? Pse u munduat kështu?

— Pse u munduam? Po do të vijë dimri, shoku komisar, dhe ushtarët nuk ka si flenë në ato çadra të holla sa fleta e cigares.

Guri vështronte si rritej kapica me materiale.

Po ai u çudit ca më shumë pas disa ditëve kur, në vendin e çadrave, u ngrit një ndërtesë e gjatë përdhese, «papanoni», siç thoshte xha Malua në vend të: kapanonit. I kredhur në punët e shumta për ndërtimin dhe sistemimin e garnizonit të vogël para se të vinte dimri, as ai dhe as ushtarët nuk

e kuptonin se sa shpejt kalonin javët dhe muajt, si rritej e forcohej kolektivi i tyre, si nisën të fute-shin ushtarët në jetën e fshatit dhe kooperativistët në stërvitjen ushtarake.

* * *

Në fillim, Petriti i numëronte ditët me gisht dhe priste me padurim sa të kthehej në qytet pranë Fluturës. Ai e humbi fare toruan, kur erdhi urdhëri se reparti do të vendosej për një kohë në tjetër vend. Tani binte shpesh në mendime të thella. Shokët nuk para e ngacmonin. Vetëm Andoni s'e linte në hallet e tij. «S'ka faj lumëmadhi, mbeti si peshku pa ujë», — thoshte. Kurse komisar Guri, sa herë e shihte, i buzëqeshte. «Mos u mërzit, — i kishte thënë një ditë. — Për ne të dy kjo është një periudhë prove, kurse Flutura ende s'e ka mbaruar kursin». Petriti e kishte pritur me ankth sa t'ja zinte në gojë Fluturën. Po përsëri nuk kuptoi se ç'mendonte Guri për të ardhmen. U mat ta pyeste, po ajo buzëqeshja e komisarit gjithmonë e çarmatoste. Në atë buzëqeshje ai shihte jo vetëm ngrohtësi e afërsi, po edhe diçka tjetër, më kuptimplote, që të ngjallte shpresa e të mbushte me besim. «Mos u mërzit, — përsëriti komisari. — Sa të rregullohet transferimi i Majlindës, ato do të vijnë të dyja këtu. Veç me një kusht: që të mos kërkosh pastaj të ikësh që këtej», — shtoi buzagaz. «Kurrë!» — tha Petriti dhe në fytyrën e tij u pasqyrua një ndjenjë e thellë respekti e mirënjohje për atë njeri të thjeshtë, të urtë e të dashur, që i ishte ndodhur aq pranë, si një prind i mirë. Të

kishte krahë atë çast, ai do t'i kaptonte malet, do të shkante një hop te Flutura dhe të ndante me të gëzimin që e pushtoi pas atyre fjalëve të komisarrit. Po kjo nuk mund të ngjiste. Flutura ishte shumë larg, kurse pranë kishte Gurin. Petriti qëndronte përballë tij si përballë mësuesit dhe e ndiente se nga ai duhej të mësonte shumë, shumë.

— Me leje, shoku komisar? — dëgjoi befaz zërin e Çlirimit. — Nëqoftëse nuk ju pengojmë, Petriti duhet të vijë në punë vullnetare.

— Vetëm ai? Po unë?

— Ju si të dëshironi.

— Ç'do me thënë kjo? Disa qenkan të detyruar, disa sipas dëshirës, — dhe ju afua grumbullit të veglave, zgjodhi një bel e, në krye të ushtarëve, u nis drejt kodrës. Atje u shndërrua shpejt e shpejt në një ushtar të thjeshtë, bashkë me Pirron, kurse komandën e merrnin Çlirimi me Zamirin. I pari, si traktorist, që kishte një përvojë të pasur në këtë punë, drejtonte shpyllëzimin. Tani ishte harruar për një kohë Çlirim-strategu dhe kishte dalë në plan të parë Çlirimi punëtor, traktorist. Hapjen e qilizmës e udhëhiqte Zamiri. Dhe të dy i kryenin detyrat në mënyrë të përsosur. Kur grumbulloheshin rreth ndonjë trungu shtatë-tetë ushtarë e nuk ja gjenin dot anën, si rrënjës së një dhëmballe të futur thellë në mish, afrohej Çlirimi, rrëmbente kazmën, qysqinë dhe e nxirte trungun me një lehtësi të çuditshme. «Ehu, sa ka zanati» — thoshte duke qeshur. Ndërsa Zamiri, sa fillonte puna, shndërrohej në një brigadier tekanjok, që nuk i linte shokët të qetë për asnjë çast. Ndihmësi i tij më i afërt ishte Petriti. Ata plotësonin, si të thuash, njëri tjetrin. Aftësitë drejtuese e njo-

huritë e gjera agroteknike të Zamirit, gjenin shprehjen më të mirë te Petriti, i cili punonte sa për dy veta, megjithëse rrallë herë i ngulte dy bela në një vend. Veçanërisht Andonit i bëhej rodhe:

— Kjo është e tmerrshme, — përsëriste ai orë e çast. — Vetëm sa i kthen barin. Fute ore belin thellë, mos ki frikë, se nuk i del gjak, — dhe, bashkë me të, e fillonte punën nga e para. Andoni shastisej kur shihte si e ngulte ai belin, dhe, sadoqë përpiquej, nuk hahej dot me të.

— E di, Petrit? Ti kot je bërë si ne. Të ishe bërë më mirë... buldozer, që t'i përmbysje këto kodra brenda njëzet e katër orëve e të na lije rehat pastaj, — dhe gajasej me fjalët e tij. Petriti as që ja vinte veshin. Këshillohej për diçka me Zamirin, shkonte te shoku tjetër dhe kthehej përsëri te Andoni, të cilin e gjente të kredhur në djersë.

— Hë, de, ku i ke shakatë tani?

— Marr guximin t'ju them se i bëra qilizmë, shoku përgjegjës! — ja kthente ai. Pas këtyre fjalëve, e qeshura kalonte nga njëra fytyrë në tjetrën e përhapej në tërë kodrën. Dhe vazhdonte pastaj puna më me vrull, sidomos në orët e mbrëmjes, pas perëndimit të diellit, kur kooperativistët ktheheshin nga arat e mbylleshin në shtëpi. Ja filluan me faqet e kodrave që shtriheshin në të kundërtën e fshatit, me qëllim që të mos i shikonte njeri e t'u bënin një dhuratë të papritur kooperativistëve në përvjetorin e parë të ngritjes së kooperativës. Po, siç thoshte Andoni, minareja nuk futet dot në thes.

Një pasdite, kur ishin duke punuar, aty pranë kaloi agronomi me një grup kooperativistësh.

Në fillim ata as që e vunë re se ç'kishte ngjarë. Por ja, njëri mbajti hapin dhe vuri dorën si strehë mbi vetulla.

— Shihni gjë ju, o shokë, apo më bëjnë sytë mua? — pyeti.

Qëndruan dhe të tjerët. Vështruan nga kodrat.

— Kjo është për t'u çuditur! Ç'po bëjnë kështu? Më duket se na i lagën.

— Ku ta dish se ç'i pjell mendja komisar Gurit me djemtë e tij.

Dhe u ngjitën njëri pas tjetrit në kodër.

— Puna e mbarë, o djema. Ju lumtë krahu.

— Faleminderit.

Agronomi u fut gjer në gju në tokën e punuar, mori një grusht dhé të zi, të shkrifët dhe e shkërmoqi me gishta.

— Bukur e paski punuar! Po pse lodheni kështu?

Njëri nga kooperativistët kishte arritur sakaq në majë të kodrës.

— Shoku agronom, pa ngjitu një herë këtu. Ngjitu dhe shiko. Faqja tjetër e kodrës qenka përmbysur e gjitha. Ku paskemi qenë ne gjer tani? Si nuk i paskemi pikasur gjer më sot? Pa le, po këtu qenka dhe shoku Guri. Dhe s'ndihet fare.

Agronomi ngjitej lart, zbriste, fuste belin në tokë dhe nuk i bëhej të besonte. «Bukur e paskan punuar. Kësaj i thonë qilizmë, jo llafe. Po ç'kanë ndërmend të bëjnë, xhanëm? Pemëtore? Vreshtë?

— Na thoni të drejtën, shoku Guri: do të mbillni gjë këtu, apo është ndonjë punë ushtarake kjo që ne s'e marrim vesh.

— Pyetni Çlirimin me Zamirin. Ata janë ko-

mandant e komisar në punime. Siç e shihni, unë vetëm kryej detyrën që më ngarkohet.

— Folë, o shoku Çlirim, si është puna?

Ai u tregoi si qëndronte puna. U tha se ushtarët qenë ndarë në tri grupe. Disa bënë shpyllëzim, disa kthenin tokën qilizmë, kurse të tjerët, gjithsejt një skuadër, grumbullonin gjethe pemësh në pyll për ta përdorur si pleh gjatë mbjelljeve. Ata ishin këshilluar me specialistët e fermës bujqësore, kishin bërë kontraktimet dhe, në pranverën e ardhshme, do të fillonin nga mbjellja e hardhive. Vreshtit do t'ja vinin emrin «10 Korriku».

Kooperativistët dëgjonin të habitur. Në fillim agronomit nuk i erdhi mirë që kishin kuturitur gjer në qytet dhe nuk kishin biseduar me të, por, kur mori vesh se këtë e bënë që të mos zbulohet e fshehta nga fshatarët, qeshi e gëzoi edhe ai bashkë me shokët. Madje më shumë se ata. I binte kodrës nga kreu në fund, merrte një grusht dhë (megjithëse këtë punë e kishte bërë disa herë), e shtrëngonte në grusht dhe e hapte përsëri, si të provonte cilësinë e ndonjë stofi. Pastaj e bridhte vështrimin në faqet e kodrave, që shtriheshin gjer tej, si të mbështeteshin tek njëra tjetra për të mbajtur peshën e rëndë të malit. «Çfarë toke!, mermëriste. — Nuk paska të sharë!» Dhe mundohet të përfytyronte vreshtat, hardhitë e mbështetura në tela, që mezi mbanin veshët e mbushura me lëng të tejdukshëm. «Po, po, do të bëhet një vresht i mrekullueshëm, — mendonte. — Mbetëm duke diskutuar se kur do të fillonim nga puna për hapjen e tokave të reja. Për pak morëm tokën e bukës».

— Si thua, shoku agronom? Do të nxjerrim gjë në kut, apo...

— Ç'të them unë, shoku komisar. Punë e shkëlqyer! Mbi të gjitha, kjo është çështje koncepti. Nuk di në më kuptoni. Çështje koncepti!

Dhe tregonte se si, me të mbaruar punët e stinës, fshatarët do t'i kthejnë sytë nga kodrat, nga malet, për t'u rrëmbyer atyre sa më shumë toka pjellore, ku do të mbillin jo vetëm pemë frutore e hardhi, por, në radhë të parë, patate, për ta siguruar bukën me forcat e veta, ashtu siç thotë partia.

— Është çështje koncepti, shokë. Ju nuk e merrni dot me mend se ç'front pune na hapët e ç'ndihmë të madhe na dhatë, — vazhdonte të fliste me entuziazëm agronomi. — Nuk do të kalojë shumë dhe keni për të parë se ç'plantacione të bukura do të krijohen këtu me vreshta e pemë frutore.

Fjala mori këmbë e u përhap që atë natë në gjithë fshatin. Ndonjë brumbull, si hoxhë efendiu, nisi të zukaste e të pickonte kë të mundte, duke thënë se qenkesh punë e kotë, pa bereqet, se ajo tokë mezi rriste murrizin e jo rrushin, po kush e dëgjonte? Kooperativistët, aty dhe pleqtë që kishin kohë pa kapërcyer prakun e shtëpisë, u ngjitën atë mbrëmje gjer tek «kodra e ushtarëve», morën atje një grusht tokë dhe e futën në gji për ta parë më mirë nën dritën e llambës.

Mali, me bukurinë e tij pak të ashpër, me ngjy-
rat që hidhte mbi supe nga muaji në muaj e nga
stina në stinë, me ajrin e pastër, pyjet e dendura,
ujëvarat, i habiste shpesh ushtarët, sidomos ata që
kishin lindur e ishin rritur në qytet. Në fillim
atyre u ishte dukur çdo gjë e stërmadhe, mono-
tone, po dalëngadalë i rrëmbeu aroma e lëndinave,
fëshfëritja e pyllit, gurgullima e burimit. Një ditë,
në stërvitje taktike; Andoni ishte ngritur ndenj-
ur në pozicion dhe vështronte i habitur se si binte
uji në theqafje, duke u thërmuar në mijëra e mi-
liona grimca, se ç'reflekse të çuditshme ngjyrash
krijonin me të rrezet e diellit.

— Harrove se jemi në stërvitje? — e pyeti
dikush aty pranë. — Ç'vështron ashtu?

— Bukuritë e natyrës, o bukurosh. Shih sa
ylbere të vogla krijohen dhe me ç'forcë zbret uji
teposhtë. Po të kishte atje një turbinë, me siguri
që do të jepte dritë për tri katër fshatra si ky
yni.

Komandant Pirrua ishte matur t'i tërhiqte vë-
mendjen që nuk qëndronte mirë në pozicion, po
fjalët e shkëmbyera në mes ushtarëve e futën në
mendime. Natyrisht që njeriu nuk ka si të mos je-
tojë me natyrën që e rrethon, por ushtari, mbi të
gjitha, është ushtar. Në orët e lira të ditës ai mund
të ulet diku, të shfletojë një libër dhe ta bredhë
vështrimin nga t'i pëlqejë. Por në stërvitje duhet
ta vështrojë çdo gjë me synë e ushtarakut dhe jo
të turistit. Ndryshe, ç'kuptim kishte që të shkë-
puteshin çdo ditë nga rajoni rreth vendit të ven-
dosjes dhe të futeshin thellë në çuka e maja, të

ngjiteshin shtigjeve shkëmbore, duke u mbajtur në pushkën e shoku shokut, për ta goditur «armikun» atje ku nuk ja priste mendja, dhe të ktheheshin andej me fytyrë e duar të mavijosura nga cingërima, me xhaketa të lagura nga djersa e shiu?

Në çast, Pirrua i mblodhi ushtarët rreth vetes. U tregoi shkurt ç'mendonte. U tha me ç'sy duhej ta vështronin ata vendin sa herë që dilnin në stër-vitje. Në fillim ndonjëri qeshi nën buzë. E ç'ka këtu për të shikuar! Kodra, maja, rrëpira, asgjë më tepër. Por, me kalimin e ditëve, ata filluan të dallonin se ku mund të ndërtohej një pritë, ku të kalonte transheja e mbrojtjes, ç'pika duheshin zënë për të mbrojtur me pak forca një rajon sa më të madh.

Po, mbi të gjitha, si ushtarë, atyre u pëlqente t'i shprehnin mendimet, aftësitë e tyre, me gjuhën e zjarrtë, e të prerë si krismat e pushkës. Aty mjaftonte vetëm një «fjalë» një e shtënë, për ta thënë atë që nuk arrin ta tregosh me leksione të tëra. Dhe në qitje, më shumë se kudo, ai që dinte të «fliste» më shkurt e më shpejt, ishte Petriti. Njeri fjalëpakë nga natyra, ai i kishte edhe plumbat të kursyer. Po nuk i ndahej Çlirimi hap pas hapi. Ata ishin si dy vrapues të shpejtë, që shkëputen qysh në fillim nga shokët dhe i udhëheqin gjatë gjithë kohës, duke e ruajtur largësinë gjer në fund të garës.

Në qitjen e fundit me pushkë, komandanti thujse nuk kishte arritur të shkelte sekondëmatësin, kur ata të dy i shkrehën të tre fishekët.

— Ç'bëni kështu? Ju ndjek njeri pas që i hidhni plumbat për zogj? — u nxeh Pirrua, duke u ngritur nga vendi.

— Unë i kam të tria në tabelë, — tha Çlirimi i sigurtë në veten e tij, duke lëmuar me dorë tytën e ngrohtë të pushkës.

— Edhe unë ashtu besoj, — shtoi Petriti.

Komandanti i pa dhe mblodhi supet.

Atë do ta shohim, — tha. Po, kur trokiti zilja e telefonit dhe kontrolluesi i shenjave raportoi se gjithë plumbat kishin goditur në tabelë, Pirrua nuk e fshehu dot habinë.

— Si është e mundur?! — pyeti ai pa e larguar dorëzën e telefonit nga veshi. — Ata e bënë në çdo qitje në më pak se dy sekonda. Kjo është e pabesueshme. Sillini këtu tabelat.

Kryekontrolluesi i shenjave nuk ishte gabuar. Rezultati ishte me të vërtetë i shkëlqyer.

— Rastësi! — thanë disa. — Kjo bie era rastësi dhe asgjë më tepër.

Qitja u përsërit. Rezultati mbeti i pandryshuar. U përsërit së treti dhe prapë shkëlqyer. Kështu, nga gryka e pushkës, në poligon, shkrepri një lëvizje e re, që e mori emrin në ditët e mëpas-tajme: në çdo sekondë një qitje, një plumb në ballin e armikut! Ashtu siç shkrepri, ashtu dhe u përhap: me shpejtësinë e bubullimës. I gjithë batalioni u vu në lëvizje. Komisari foli për të në mble-dhje, organizoi gara e disa mësimë shembullore për mbushjen e zbrazjen e armës dhe shkrepjen bosh. Normat u thyen nga çdo ushtar. Vetëm Hasani ishte në hall.

— Natyrisht, kjo është lëvizje interesante, — thoshte. — Ushtari duhet të qëllojë shpejt e në she-një. Ta palosi në vend armikun me një të hequr të gishtit. Por, të kuptohemi, ama, me kapacitetet teknike nuk mund të luhet. Ato kanë dalë nga

llogaritje të përpikta. Pse, ore, më të mençur do-
lëm ne nga të tjerët?

Dhe shpërthenin kështu diskutime të gjata, të zjarrta. Hasani bënte sikur qëndronte i shkujdesur, po më në fund nuk i durohej dhe e thoshte fjalën e tij. Një herë, kur u zu ngushtë, mori një gotë bosh dhe ja zgjati Çlirimit.

— Na, më hidh këtu një kile ujë, — i tha serioz.

Çlirimi ngriti supet dhe vështroi nga shokët.

— Nuk ju kuptoj, shoku Hasan! Ç'doni të thoni me këtë?

— Dua të them se me kapacitetet teknike nuk mund të luhet, mik i dashur. Çdo gjë ka një masë, një kufi, përtej të cilit s'mund të shkohet. Më kupton? Ja, këtë desha të thosha, me demek.

— Një me zero për kapterin? — e ngacmoi Andoni, që futej si pykë në çdo bisedë. Po Çlirimi as që e prishi terezinë. U mendua një çast, pastaj ja ktheu Hasanit:

— Për ujin s'di si të them. Por bëje këtë gotë prej çeliku, shko vëre atje tej dhe ne kemi borxh ta mbushim me plumba. Pastaj shko e peshoi ti sa rëndojnë: një kile, apo dy.

— Ehu, sa ka zanati! — i vuri përsëri vulën bisedës Andoni.

Kapteri paragrafi e vështroi me habi, bëri një shenjë me dorë, si të donte të ndante diçka në mes, dhe ktheu krahët. Nga ajo ditë, ai nuk foli më për kapacitetet teknike. Ndërkaq, stërvitja vazhdonte pa asnjë ndërprerje. Poligoni përcillte vazhdimisht jehona krismash gjer tej, në fshat. Një ditë, aty erdhi xha Malua. Qëndroi një copë herë si mbi gjemba, pastaj e pyeti Gurin:

— Si duken, o shoku komisar, qëllonjë mirë?

— Mirë, xha Malo, jo keq.

Plaku ndezi çibukun, e thithi disa herë dhe prapë pyeti:

— Mirë the? Posi, posi! Po, nuk më thua, si janë këto pushkët? Kështu duken xixë.

— Nuk shahen, xha Malo. Të këpusin.

Tjetri e vështronte pushkën me kërshtëri, e hidhte nga njëra dorë në tjetrën dhe e ngiste fjalën më tej:

— Të këpusin, ë? Po, po. Ashtu është. Po, nuk më thua, o komisar, si shtihet me to?

Guri i tregoi se si merrej shenjimi, pastaj e pyeti:

— Do ta provosh një herë si qëllonjë?

Xha Malua përdrodhi mustaqet dhe i ra supëve:

— Epo hë, të shkretën, se ma more shpirtin. Unë kam një sahat që i vi rrotull e rrotull e ti mezi i re në të. Në s'të vjen keq për fishekët, m'i jep nja dy-tri copë. Po, kur të mbetemi vetëm, ama. Se, helbete, pleqëri e na dridhet ca dora.

— Ke hall mos turpërohesh nga ushtarët?

— Jo, ore, jo, s'ka frikë xha Malua. Gjersa u bëra kaq, nuk jam turpëruar ndonjëherë, — dhe u shtri në pozicion e i shkrehu të tre fishekët njëri pas tjetrit. Pastaj u ul këmbëkryq dhe ndezi llullën. «Pushkë të mira këto, nuk i dëgjon fare, — mendoj. — Ajo gërdalla ime ma bëri supin me kallo». Në këto e sipër dëgjoji zërin e komisarit dhe ju duk atë çast sikur e mori plumbi nga shpatulla në shpatull:

— Nuk ka gjë? — fliste me zë të ulët komisar. — Pa shikoje mirë, shikoje dhe një herë.

Qëlloi xha Malua. Ashtu! E pe me kujdes? Dhe nuk ka? Çudi! — uli dorezën e telefonit dhe u kthye nga ushtarët:

— Po ju, kush ju tha të vinit këtu? Shkoni shpejt nëpër vendë! Vazhdoni stërvitjen.

Xha Malos, një fytyrë i vinte, një i ikte. Më ngushtë nuk e kishte ndier veten. Për pushkë ai numërohej me gisht jo vetëm në fshat, po në gjithë krahinën. Godiste kokrrën e vezës njëqind çape larg. Edhe skifterin e kishte ndarë në mes në fluturim. Kurse tani nuk mundi të qëllonte gjithë atë tabelë, sa dera e mullirit!

— S'kanë faj djemtë, o komisar, kot u bie në qafë, — foli dhe u ngrit e iku.

Ushtarët nuk e kishin parë ndonjëherë të ecte aq shpejt, si ta ndiqte njeri nga prapa. Sa u humbi nga sytë, vazhduan stërvitjen. Askush nuk ishte në gjendje të thoshte sa kohë kaloi, kur te kthesa u duk përsëri xha Malua. Kishte hedhur një pushkë në krah dhe e kishte shtruar ca hapin. Tani nuk dukej sikur e ndiqte njeri pas.

— Do të më hapësh edhe një herë rrugë, o komisar, ta provoj këtë dyfekun tim. I vjetri me të vjetrën dhe i riu me të renë, — tha ai, duke hequr pushkën nga krahu. Ushtarët e vështruan buzagaz. Kishte një pushkë të gjatë, të gërryer vende-vende nga gjurmët e viteve, po me një qytë të pastër, të zbukuruar me ca pulla të vogla e si të florinjta, që vezullonin nën rrezet e diellit.

— Provoje, xha Malo, provoje.

Ai nxori nga xhepi diçka të mbështjellë me një shajak të bardhë, të pastër. Guri ju afrua kur reshtar. Ishin tre fishekë të mëdhenj, që shkëlqenin nga pastërtia. Xha Malua i vështroi një copë

herë, si t'i vinte keq të ndahej nga diçka e afërt, e dashur. I kishte ruajtur ata fishekë vjete e vjete me radhë «për ditë të mirë e të keqe», siç thoshte. Edhe kur fashistët ja dogjën shtëpinë e doli me ç'kishte veshur, ai e mbështeti kokën mbi qytën e dyfekut dhe e kapërdui hidhërimin si një lëmsh të hidhur zeher, po nuk psherëtiu. Vërtet ja dogjën plaçkë e laçkë, po ai mbeti prapë njeri i lirë e krenar, si malet. Se lirinë nuk e mbyll dot në një dhomë e t'i vësh zjarrin. Dhe xha Malua e kishte pushkën, i kishte fishekët. Gjëmën e tyre e ndjeu mirë armiku. Çdo plumb i kërkoi një kokë njeriu. I ndjenë më pas dhe diversantët që u përpoqën një natë t'ja digjin shtëpinë për së dyti. Pas ndeshjes me ta i kishin mbetur edhe tre fishekë. Xha Malos i dukeshin ata si tre djem azganë, që mund t'ja përdridhnin kokën çdo hasmi. Ndaj i shihte ashtu. Po pse t'i vinte keq? Për kur i duheshin tjetër, në mos për atë ditë?

— Qoftë e hairit, o komisar! — Dhe u shtri, po pushkën nuk e mbështeti në pozicion. E mbërtheu me të dy duart dhe e shtrëngoi fort. Komisarrit ju duk ajo si një pjesë e gjoksit të rreshkur e leshtor të plakut.

— E sheh atë ledhin në anë të pyllit, komisar?

— E shoh.

— Në mes ka një shenjë të bardhë. Është gur.

Dhe i dha faqen pushkës e mbylli njërin sy. «Matu mirë, o Malo, sikur të kesh atje Hrushovin», — i foli vetes dhe tërhoqi këmbëzën. Pushka kërcëu e shkrepri flakë, si vetëtimë mali. Mbi shenjën e bardhë doli tym, po Guri nuk u coptua. «Ma paska kokën të fortë tullaci» dhe ja tereziti për së dyti. Tym i doli prapë, po guri mbeti. «Ma more

dhe të fundit, i mallkuar!» u hakërrua xha Malua dhe qëlloi përsëri. Guri u bë copë e thërrime. Ushtarët nuk u përmbajtën më. E rrethuan dhe flisnin të gjithë në një gojë:

— Të lumtë dora, xha Malo. Këtij i thonë të qëlluar, jo shaka.

Xha Malua ishte bërë qull në djersë dhe i shkonte buza vesh më vesh.

— Epo ju thashë unë i varfëri: plaku me plakun dhe i riu me të rinë, — përsëriste vazhdimisht. Kur mbetën vetëm, ushtarët flisnin për atë qitje të përpiktë, që i kishte habitur aq shumë. Hahe-shin në fjalë në mund ta godisnin edhe ata, në mos me të parën, të paktën me të dytën apo me të tretën. Dhe arrinin në përfundimin se vetëm Çlirimi, Petriti, e Zamiri mund ta godisnin, kurse të tjerët...

— Si thoni, shoku komisar, mund ta godasin?

Guri gjithnjë mendohej dhe as që i kishte dëgjuar fjalët e ushtarëve. Ajo që kishte ngjarë pak më parë e kishte futur në mendime të thella.

— Ç'mendoni, shoku komisar, a mund ta...

— Ç'mendoj? — pyeti pa ja larguar sytë xha Malos, i cili i ngjitej së përpjetës me pushkën kraheve, me duart e hedhura përmbi të dhe kapelen ushtarake mbi sy. Ecte ngadalë, si të kthehej i lodhur, po fitimtar nga beteja. Dhe këndonte një këngë të vjetër, këngë kaçakësh, së cilës nuk ja mbante mend mirë fjalët.

— Unë mendoj se duhet të nxjerrim mësimë nga ky rast. Më duket, shokë se ne jemi mbyllur në guaskën tonë, kënaqemi me sukseset që arrijmë në stërvitje, apo me disa hektarë tokë qilizmë, dhe harojmë se, në rast nevojë, sado të pregati-

tur që të jemi, ne nuk do të mund ta mbrojmë vetëm gjithë këtë rajon ku jemi vendosur, po bashkë me xha Malon, me çetën vullnetare, me popullin. Po xha Malua i dogji edhe ata tre fishekë që kishte. Kurse me karabinë nuk e kemi mësuar të qëllojë. Pra, duhet ta mësojmë. Guri ngriti strehën e kapeles, siç bënte kur vriste mendjen të gjente rrugëdalje për një problem të vështirë, dhe e ndjeu se si ja freskoi era ballin e djersitur. — Medoemos duhet ta mësojmë. Dhe pa humbur kohë. Menjëherë. Apo jo? Nuk duhet të humbasim asnjë minutë.

Po atë mbrëmje, mbledhja e përbashkët e organizatës bazë të partisë së batalionit dhe të kooperativës vendosi që në kooperativë të bëhej një punë më e organizuar për stërvitjen e çetës vullnetare të vetëmbrojtjes. Aty për aty u përgatitën nga e para listat e pjesëtarëve të çetës dhe u hartua pa vonesë programi i ri i stërvitjes, të cilën nuk do ta drejtonin, si gjer atëhere, ushtarët e liruar, po shokë nga më të përgatiturit në batalion, me komisar Gurin e komandant Pirron në krye. Dhe që të nesërmen çeta zhvilloi mësimin e ri mbi përdorimin e armëve.

* * *

Për një kohë, Majlinda qëndroi palëvizur në nim, me librin në dorë. Nuk vendoste në duhej ta hapte e të lexonte. Ju afrua dritares së hapur përgjysmë, nga dyndej ajri i freskët e i pastër. Mbësh-teti kryeti në parmak dhe e treti vështrimin diku larg. As vetë s'e kuptonte pse ishte aq e mërzhitur,

sa nuk i bëhej për punë. U mat të kthehej dhe të merrte përsëri librin e ta humbiste mendjen me lexim. Por atë çast dikush trokiti në derë. Në fillim nuk ishte në gjendje të thoshte në i vinte mirë apo keq që nuk do të mbetej vetëm, por, kur e çeli dhe pa Fluturën që dukej aq e gëzuar, sikur e rrëmbeu edhe atë entuziazmi dhe gjallëria e saj.

— Ç'ke kështu? Erdhi Petriti, apo more ndonjë letër?

— As njëra dhe as tjetra.

Flutura ju afrua me hap të shpejtë krevatit të Ditkës.

— Me ngadalë, të lutem. Mezi e zuri gjumi.

Ajo u përkul mbi krevat, e vështroi për disa çaste fëmijën që kishte rënë në një gjumë të ëmbël e i buzëqeshte ëndërrës, dhe e puthi. Pastaj eci me po atë hap të shkujdesur drejt dritares dhe e hapi kanat. Flladi i lehtë i mbrëmjes ja shpupurishi flokët. Ajo nuk ngopej me ajër.

— Ç'ke kështu? Si shumë e gëzuar më dukesh.

Flutura u kthye nga Majlinda. Ato qëndronin pranë e pranë.

— Si ta them, Linda. Unë sot kam dy gëzime. Në mëngjez herët shkuam në poligon me të rinjtë e uzinës. Kishim qitje. Unë nuk kisha qëlluar asnjëherë. Nuk ta them dot se si më erdhi kur mora pushkën në dorë. Dridheshja e tëra, por mos kujto se kisha frikë. Jo, jo, asnjë çikë, për kokën e Ditkës në të gënjej. Dhe prapë se si më vinte. Edhe s'më durohej sa të ulesha në pozicion, edhe ndruheshja. Po sikur të dilja keq? Po sikur të mos fusja asnjë fishek në tabelë? «Hajde tani, mjaft na ke folur për zakonet prapanike, më tha përgjegjësi i rinisë. Po e zëmë se atje është kanuni. Ulu dhe

qëlloje». Dhe e di? Tabela dukej atje tej sa një fletore e vogël, e zezë. Unë u ula. Mbështeta faqen mbi pushkë. Po të thashë: frikë nuk kisha asnjë çikë. Vetëm për një gjë mendoja: a do ta qëlloja? Mbylla njërin sy dhe tërhoqa ngadalë këmbëzën. Ta dish si më hidhej zemra, sikur do të vraponte edhe ajo bashkë me plumbin drejt tabelës. As vetë nuk e ndjeva krismën. Qëllova edhe dy herë të tjera. Pastaj vrapuam me shoqet drejt tabelës. Kur dëgjova zërin e komandantit: «Ç'qitje e shkëlqyer, more shokë! Të tre plumbat në qendër dhe fare pranë njëri tjetrit. Kush ma ka këtë sy pushke?» Unë kujtova se bënte shaka komandanti dhe m'u prenë gjunjët. Desh mbeta atje. Por, kur u afrova, mbeta dhe vetë e habitur. S'më besohej të kisha qëlluar aq mirë. Shokët më rrethuan dhe s'dinin si ta shprehnin gëzimin. «Të lumtë, moj Fluturë. Ja bëre shoshë mushkëritë kanunit. Pushkatim të tillë s'e ka parë as në ëndërr!» tha sekretari. «Epo vajzë malësie ajo, more vëlla. Ka lindur bashkë me pushkën». «Pse, vetëm vajzat e malësisë qëllojnë mirë? Po ne?» «Edhe ju, xhanëm, edhe ju. Po me Fluturën nuk mateni dot». «Flutura na i hodhi të gjithëve, me vajza e djem». Dhe fjalët s'kishin të mbaruar.

Majlinda nuk ja hiqte sytë. Ajo nuk e kishte parë kurrë kaq të gëzuar shogën e saj.

— Të lumtë, moj motër. Ti je me të vërtetë e çuditshme. Unë them se çdo gjë mund të bëja, veç me pushkë nuk do të dija të merrja nishan.

— Ashtu të duket. Po e di sa e thjeshtë është? Mjafton të mos ndruhesh, të mos kesh frikë, dhe...

— Po me atë letër ç'ke mbështjellë?

— Me letër? Oh, desh harrova. — Flutura e

hapi dhe nxori andej diçka të bardhë, të ndritshme, në formë tubi.

— Nuk e kupton ç'është? Me të vërtetë nuk e kupton? Po ja moj, kjo është spinotë. Një spinotë bales tre. Kështu duket i thjeshtë, por unë e di ç'hoqa për ta bërë.

— Pse, vetë e punove?

— Po, vetë. Është prodhimi im i parë në torino. Më kupton, Linda? Prodhimi i parë. Këtej e tutje unë nuk jam më nxënëse në ekonomi, por tornitore me kategori. Si të ta them këtë... Ja, sa u kthjem nga poligoni në uzinë, lajmi mori dhenë. Të gjithë mendonin për qitjen. Edhe usta Merua. Të ishe atje dhe të shikoje sa u gëzua! Goja i vajti vesh më vesh. «Pa shih ç'ndihmëse të zonjën kam nxjerrë! — mburrej. — Vajzë për kokë të vajzës. Ja kalon dhe djalit më të mirë». «Atë mos e thuaj, o xha Mero, — e ngacmoi njëri nga shokët. — Kaluan katër muaj dhe ajo nuk ka fituar ende kategorinë. «Kush të tha, more, se nuk e ka fituar? Dale pa e shikon...» u nxeh xha Merua dhe sillej e sillej rreth tornos. «Kush të tha se nuk e ka fituar? Pa eja këtu, moj Fluturë. Ashtu. E sheh këtë hekur? Merre dhe më bën një spinotë bales tre. Hajde, ç'më shikon ashtu? Ti e godite armikun në zemër dhe tani hutohesh për një spinotë». «Xha Mero, po dale një herë të merremi vesh. Unë...» «S'ka unë dhe ti këtu. Për dy minuta dua spinotën». Dhe vështroi orën e kryqëzoi duart mbi gjoks. Unë thashë se bënte shaka. Por e kuptova se s'kishte rrugë tjetër. Të gjithë qenë mbledhur rreth tornos e prisnin, njëlloj si në poligon. Ju afrova xha Meros dhe desha ta pyesja për diçka. Ai më vështroi sikur thoshte: «Ç'pret më, bija ime? Fillo!

Dhe me kujdes, mos na turpëro!» Pra, nuk isha në ëndërr. Unë do të punoja vetë në torno. Pa ndihmën e ustait! Sa e pata pritur këtë çast! Sa herë i kisha bërë me mend veprimet që do të kryeja para komisionit të kategorizimit. Dhe ç'komision! Jo me tri e katër veta, por me të gjithë shokët e repartit. Në fillim u hutova. Më dukej sikur i harrova të gjitha. Sikur nuk do të isha në gjendje të lëvizja as dorën, le pastaj tornon. Dhe ç'torno moderne që kemi ne, Linda! Desha s'desha, vendosa detalin, pastaj thikën, u mata mirë e mirë, shtypa tamponin dhe... u lava në djersë. Thika u ngul në detal, hoqi gjithë pjesën e sipërme dhe... dhe... Ah, sa inat më vjen që nuk di ta shpjegoj se ç'gjë e mrekullueshme është kjo punë, se si dridhesha unë, kur e hoqa spinotën e mbaruar. Usta Merua mori kalibratorin, e mati me kujdes, përdrodhi i gëzuar mustaqet dhe ua kaloi spinotën shokëve për ta shikuar! Po ti ç'ke kështu, Linda? Me siguri që ke diçka. Mos u mundo ta fshehësh. Po, vërtet, për pak harrova. Si përfundoi puna e Mamicës?

Megjithëse e ndjente të domosdoshme të këshillohej me dikë për ato që kishin ngjarë, Majlinda nuk donte ta bënte këtë atë mbrëmje, ngaqë i dukej se do ta prishte sadopak gëzimin e Fluturës. Por Flutura nguli këmbë dhe ajo u shtrëngua t'i tregonte me hollësi si i kishte kaluar dy ditët e fundit.

Dy net më parë, sa e kishte zënë gjumi Ditkën, kishte trokitur lehtë dera. Ajo kishte kujtuar se ishte Flutura dhe ishte përgatitur ta ngacmonte, si zakonisht, por, kur e kishte hapur, kishte mbetur një çast e hutuar.

— Mamica, ti?!

Mysafirja e kishte vështruar me ndrojtje dhe kishte ulur kokën. Nuk ishte vështirë ta kuptoje që ishte e tronditur dhe kushedi sa shumë kishte ngurruar para se të kishte trokitur në derën e apartamentit të saj.

— Pse je kaq e tronditur? Mos nuk të doli e drejta e studimit?

— E drejta më doli, mësuese, por...

— Ç'tjetër? Pa ulu e më thuaj shtruar. Po më parë qetësohu. Ndërkaq, unë po të sjell një gotë çaj, ose një shurup, më mirë.

— Oh jo, mësuese. Ju lutem, mos u shqetësoni për mua. Tani është shumë vonë.

Po Majlinda as që i kishte dëgjuar këto fjalë. Ajo kishte shkuar në kuzhinë, nga ishte kthyer pas pak me një gotë limonatë në dorë. Mamica kishte ngurruar ta mernte. Jo se nuk i pihej, por se si i dukej kur shihte mësuesen e saj që i shërbente. Ajo kishte një respekt të thellë për Majlindën. Gjersa mbaroi shkollën e mesme, kishte ndërruar disa mësues dhe natyrisht të gjithë i çmonte e i respektonte, ashtu siç i çmon një nxënëse e edukuar dhe mirënjohëse edukatorët e saj, po për Majlindën ushqente një respekt të veçantë, që arrinte gjer në adhurim. Ndonëse me të kishte bërë vetëm dy klasët e fillores, sa herë që bënte ndonjë gabim, apo kishte rënje në mësim, prindërit e kërcënonin se do t'i shkruanin «zonjushë Majlindës» e do t'ja tregonin të gjitha fill e për pe. Në këto raste, ajo lutej me lot në sy që të mos i shkruanin dhe premtonte se nuk do të bënte më asnjëherë gabime të tilla. Dhe sa shumë u gëzua Mamica kur, pas disa vjetësh, e takoi përsëri mësuesen e saj të fëmijërisë, e cila e njohu që në

çastin e parë dhe e përqafoi me ngrohtësi jo më si një ish nxënëse, por si një shoqe të dashur!

— E pra, më thuaj tani: si qëndron puna?

Ajo ja tregoi të gjitha.

Atë pasdite kishte shkuar për vizitë, bashkë me të jëmën, te një komshiu i tyre. Atje ishin takuar thuajse rastësisht me disa të njohur dhe me një inxhinier të ri. Kur ishin kthyer në shtëpi, i kishte pritur i ati, i cili ishte shtruar në tavolinë dhe po pinte. Sa e kishte parë, ai kishte kthyer dhe një gotë dhe e kishte ftuar të ulej pranë tij.

— Hajde, bijë e babait, se tani m'u rrite. Pa më thuaj një herë: si t'u duk inxhinieri, ë?

Mamica ishte skuqur gjer te veshët dhe vetëm atëhere ishte munduar të thellohej në ato që kishin ngjarë. Ajo kishte biseduar e çiltër e pa të keq me inxhinierin, edhe pse ata që ndodheshin në dhomë vështronin herë-herë njëri tjetrin e vinin buzën në gaz.

— Po deshe, mendohu dhe sonte, — e kishte ngarë fjalën e ëma. — Nga pamja nuk di ç'të them, se ti sytë në ballë i ke. Sa për të tjerat, përgjigjemi ne. Djalë më të mirë s'ke ku gjen. I ri. Me shkollë të madhe. Familje e mirë. Si veshja në mes të dhjamtit do të jesh, moj bijë.

— Po shkolla, mama?

— Epo ç'të duhet shkolla, moj bijë, kur ke fatin e mirë. Ja, ta zëmë se e mbarove. Dole dhe profesreshë. Po më tutje? Kush më siguron se nuk të hedhin në ndonjë fshat? Dhe të rruat shkolla pastaj!

Majlinda dëgjonte në heshtje. Ajo e kishte vënë re që në fillim tronditjen e ish nxënëses, po tani që kishte dëgjuar tregimin e saj dhe kishte

parë se me ç'shqetësim e kishte nxjerrë thujtë çdo fjalë, e kuptoi edhe më mirë gjendjen e Mamicës.

— Po pastaj ç'ngjau..? U theve? Hoqe dorë nga shkolla?

— Jo, kundërshtova me sa munda. Por ata nuk hoqën dorë. Sidomos babai. Thotë se do të shpalli menjëherë fejesën dhe do të shkojë në seksion të arësimit për të hequr dorë nga e drejta e studimit.

— Dhe ti si ju përgjigje! Apo u mbylle në dhomë dhe qave e qave sa t'u bënë sytë kaçup.

— Ç'mund të bëj unë? Unë... — dhe nuk e mbaroi fjalën. Sytë ju veshën me një cipë të lëngshme dhe çdo gjë përreth ju mjegullua.

— Me lot nuk fiton gjë, motër. Ti duhet të ngulësh këmbë në të drejtën tënde, të ngulmohesh me guxim e gjer në fund. Dhe të kesh më shumë besim në veten tënde, në forcat e tua. Natyrisht, edhe unë mund të të ndihmoj me sa mundem, por në radhë të parë duhet të luftosh vetë, më kupton? T'i bindësh prindërit se është e drejta jote të vendosësh me kë do të lidhësh jetën, por më parë të mbarosh shkollën.

Ato biseduan gjatë. Të nesërmen Majlinda shkoi në shtëpinë e Mamicës. Si zakonisht, prindërit e saj e pritën me përzemërsi.

— Erdha t'ju uroj, — tha. — Mora vesh se Mamicës i ka dalë e drejta e studimit për matematikë-fizikë.

E ëma sillej e hutuar nëpër dhomë, kurse i ati heshtte dhe qëndronte si mbi gjemba.

— Është një degë mjaft e mirë, — vazhdoi mësuesja. — Shumë e përshtatshme për Mamicën.

Ajo që e vogël dallohej ndër shoqet për prirje në matematikë. Me ç'lehtësi i zgjidhte problemet! Do të bëhet një pedagoge shumë e mirë. Keni për ta parë.

— Ndoshta.

— E pse ndoshta?

— Sepse nuk dihet në do t'i vazhdojë studimet, apo jo.

— Nuk ju kuptoj. Asaj i doli e drejta e studimit, — u hoq sikur s'dinte gjë Majlinda.

I ati i Mamicës vuri buzën në gaz.

— Keni të drejtë, shoqja Majlinda. Por ja që në jetë ngjet edhe kështu. Qëllon që ngulmojmë e ngulmojmë për një kohë të gjatë të realizojmë një plan e një dëshirë, por, kur vjen puna, habitemi pse jemi munduar aq shumë, sepse zgjidhja paskësh qenë shumë më e thjeshtë dhe më e shpejtë.

— Ju kuptova, — dhe mësuesja kapsalliti sytë e vuri buzën në gaz.

— Çfarë kuptuat?

— Po ja, keni gjetur një djalë të mirë dhe mendoni të fejon i Mamicën.

I ati e pa ngultas për disa çaste.

— Domethënë jua paska treguar të gjitha, — dhe u kthye nga Mamica, që ishte mbledhur grusht dhe vështronte e hutuar herë të jatin, herë mësuesen.

— E pse ta mohoj? M'i tha.

— Po... — i ati i Mamicës u ngrit dhe i ra dhomës disa herë mendueshëm nga kreu në fund. — Po... — përsëriti — Jua paska thënë. Dome thënë, mbrëmë te ju paska qenë. Epo mirë. Ç'të keqe shihni ju në këtë mes?

— Të them të drejtën, unë këtu nuk shoh asnjë të mirë.

I ati e ndali hapin dhe u kthye nga Mamica. Për herë të parë ajo e shikoi drejt dhe nuk i uli sytë.

— Ti, Mamicë, shko dhe shiko gjellën në zjarr se mos na digjet, — tha si me një ton të prerë.

— Unë do të qëndroj këtu, baba. Gjersa bisedohet për mua, do ta them fjalën time. Dhe ju — në këtë rast — duhet të më dëgjoni.

— Shko, moj bijë. Ti je ende e vogël për këto muhabete, — ndërhyri e ëma.

— Kurse për t'u martuar jam tamam, — ja ktheu ajo.

I ati e vështroi edhe disa çaste, pastaj i ktheu krahët, e u ul në kolltuk, përballë mësueses, dhe përsëriti të njëjtën pyetje që ja kishte bërë pak më parë:

— E pra ç'të keqe shihni ju këtu?

Pa pritur përgjigjen e saj, e mori fjalën e ëma e Mamicës:

— Vajza është si ai trëndafili në degë, bija e nënës. Po u hap, mos prit më, se do të fishket, do t'i bien fletët dhe shpejt a vonë do humbasë çdo gjë: edhe aromën, edhe bukurinë, e nuk do t'i bjerë më njeriut në mend për të. Nga gjithë ajo bukuri, në degë mbetet vetëm gjembi, që jo vetëm s'të kënaq, po ta shpon dhe gishtin po e preke.

— Krahasimi më duket pa vend, — nuk ju durua Majlindës. — Po edhe ashtu sikur të ishte, Mamica është ende gonxhe. Burbuqe themi ne nga anët tona. Për të çelur, për të na dhënë të gjitha ato që mund të na japi, në familje e shoqëri,

duhet të mbarojë shkollën, të piqet me një fjalë. Dhe ke për të parë pastaj ç'lule e bukur që do të çelë. Një lule që s'do fyshket kurrë. Sa më shumë kohë të shkojë, aq më e bukur, aq më e qëndrueshme do të bëhet. Kurse po mbeti pa shkollë, do të bëhet si trëndafili: për një kohë do të na kënaqë me freskinë dhe bukurinë e jashtme, pastaj këto do t'i ikin dhe... dhe ndoshta do të bëhet ashtu siç thatë ju pak më parë...

Flutura ishte e dhënë e tëra pas tregimit të Majlindës dhe në përgjigjet e saj, në fjalët e saj, shikonte e dëgjonte diçka që i dukej se kishte të bënte edhe me të, që i përkiste edhe asaj.

— Po më tej ç'ngjau, Linda? Me siguri që prindërit e Mamicës u tërhoqën, apo jo? Nuk është lehtë të hahet njeriu me ty. Pastaj unë e di se sa të duan prindërit e Mamicës. Ata janë njerëz të mirë, shumë të mirë. Veçse, si shumë prindër, i tremben fatit të vajzës. Dhe unë s'u vë shumë faj: jemi delikate ne, vajzat.

Majlinda qeshte dhe tundte kokën. Po dukej që nuk i kishte dëgjuar të gjitha fjalët e Fluturës, se mendja i punonte diku gjetkë.

— Nuk më the, — ju drejtua së dyti Flutura, — u tërhoqën prindërit e saj?

— Është ende shpejt për ta thënë këtë, sepse ata, me sa duket, i kanë dhënë fjalën familjes së djalit. Megjithatë, biseda nuk qe e kotë. Ata pothuajse u bindën. Dhe, ç'është më e rëndësishmja, Mamica nuk u mjaftua me lot, as nuk heshti, por nguli këmbë se nuk do të fejohej pa mbaruar shkollën, aq më pak me një njeri që nuk e njihte.

— I lumtë! — dhe Flutura ju hodh në qafë Majlindës. — Unë çuditem me ty, Linda. Ti ke

diçka të veçantë, që të bën për vete, të jep zemër, të... s'di si të them tjetër. Po të jem me ty, Linda, unë nuk do t'i trembem asgjëje, asgjëje...

Në krahët e njëra tjetrës qëndruan një kohë pa lëvizur, me vështrimet ëndërrimtare të ngulura, larg dritares.

— Ç'po bëjnë vallë tani Guri me Petritin? — pyeti Flutura.

* * *

Gjatë ditëve të fundit, ushtarët do t'i gjeje shpesh në poligonin e qitjes. Inisiativa për shkurtimin e normave dhe hapjen e zjarrit të shpejtë e të përpiktë, kaloi nga njëri ushtar te tjetri dhe përfshiu gjithë repartin. Komisar Guri kishte ditur t'i jepte qysh në fillim një kuptim të thellë politik kësaj lëvizjeje.

— Puna është, — kishte thënë ai në një mbledhje, — që ushtari ynë të diktojë i pari armikun e të hapi zjarr të shpejtë, në mënyrë që të jetë në gjendje të vrasë njëqind armiq dhe vetë të mos vritet.

Këto fjalë ishin ngulitur në mendjen e secilit. Çlirimi me Petritin nuk mbetën pa konkurrencë. Zamiri i ndiqte hap pas hapi. Po, një ditë, për çudinë e shumë vetave, flamuri i kuq i qitësit më të mirë erdhi e u ngul tek bajoneta e Andonit, të cilin, gjer atëhere, nuk e vinte njeri në defter. Në heshtje e pa tërhequr vëmendjen e të tjerëve, ai e ngriti nga dita në ditë rezultatit, gjersa, më në fund, brenda një minute, me dyzet plumba e goditi dyzet herë me radhë tabelën. Ky u quajt një rezultat rekord. Por Çlirimi me Petritin nuk u tërho-

qën. Ata e sulmuan edhe këtë majë e u ngjitën më lart.

Kjo ngjau në një mëngjez plot diell, aty nga fundi i qershorit. Reparti u njoftua se, pas tri-katër ditësh, do të vinte vetë komandanti i njësisë me një ekip specialistësh për t'u njohur nga afër me përvojën e qitësve të përpiktë. Guri e njihte prej kohësh komandantin epror dhe kishite për të një respekt të veçantë. Ai ishte njeri i qetë, që rrallë herë kënaqej, që dinte të vështronte gjithmonë më larg se të tjerët dhe t'i vinte vartësit në lëvizje, pa përtuar, kur ishte nevoja, të ulej gju më gju me ushtarët, në një pozicion. Ai nuk e duronte dot sidomos punën e sipërfaqshme, sa për t'u dukur, dhe kërkonte që çdo gjë të bëhej e menduar mirë e t'i binte era barut, t'u afrohej sa më shumë kushteve të luftës. Ndaj ato pak ditë që kishin mbetur, ai bashkë me komandant Pirron, binin natën vonë për të fjetur e ngriheshin pa gdhirë mirë. Merreshin me paraqitjen e rregullt të ushtarëve nga ana rreshtore, me pregatitjen e bazës materiale dhe të poligonit. Më në fund, ata menduan se çdo gjë e kishin pregatitur me kujdes dhe mund të dilnin ballëhapët para komandantit.

Atë mëngjez, që erdhën shokët për kontroll, dita gdhiu e qeshur. Qielli shkëlqente. Nga majë-mali zbriste një puhizë e butë dhe e këndshme. Pasi vizitoi me radhë vendet ku flinin, hanin e mësonin ushtarët, komandanti i njësisë nisi të ngjitej përpjetë rrugës që e nxirrte kryet pranë poligonit. Ai kishte një trup mesatar e të shëndoshë, po ecte pa u ndalur, me një hap të gjatë, jo të

zakonshëm për moshën dhe fizikun e tij. Guri nuk e kishte të lehtë ta ndiqte.

— U lodhe, shoku komisar? S'paske rendur shumë, më duket. Ruaju nga dhjamët, se ai të mbërthen si ngërçi e s'të lë të marrësh frymë.

Komisari mendohej të mos ja ndante hapin. Eprori i bënte nga një pyetje në të rrallë, po gjithmonë të menduar dhe dëgjonte në heshtje përgjigjen. Guri vështronte me bisht të syrit fytyrën e komandantit dhe mendohej të kuptonte se ç'përshlytje i kishin bërë fjalët e tij, po i dukej se në atë fytyrë nuk lëvizte asnjë muskul. Kur arritën në vendin e vrojtimit, komandanti shikoi me cep të syrit karriget e radhitura pranë një tavoline, të mbuluar me beze të kuqe.

— Oho, qenki përgatitur si për festë! — foli i habitur. — Kushedi se me ç' rezultate të mira do të na gostitni. Po këta ç'janë? Kooperativistë? — dhe ju afrua grumbullit të tyre, i përshëndeti me radhë e nisi të fliste shtruar, duke i pyetur për punët e stinës e për marrëdhënjet që kishin me ushtarët. Ata flisnin të gjithë në një gojë, si të ishin në garë se kush do të thoshte fjalët më të mira për ushtarët, sidomos për komisar Gurin.

— O, jo kaq shumë lëvdata. Jo, jo kaq shumë. Ushtarit nuk i bëjnë mirë dafinat, sidomos para betejës. Pas betejës, kur ja shtyp kokën armikut, atëhere, natyrisht, edhe mund t'i thuhet ca fjalë të mira. Po përsëri jo kaq shumë. Dhe tani le të shohim ç' do të na tregojnë shokët.

Dikush aty pranë dha një sinjal me flamur dhe ushtarët u vunë në çast në lëvizje. Guri me Pirron kishin menduar që të mos tregonin një qitje të thjeshtë, sado interesante, po ta kombino-

nin me veprime taktike. Ushtarët dolën me shpejtësi nga strehimet dhe nisën të vraponin drejt pozicioneve të zjarrit. Komandanti i njësisë vuri në sy dylbitë, vrojtoi një copë herë dhe tundi kokën. Diçka nuk i pëlqeu, si duket. Po çfarë? Guri më kot vrau mendjen ta gjente. Ndërkaq ushtarët zunë pozicionet e zjarrit në luginë. Përballë tyre u çfaqën një varg i gjatë tabelash që imitonin armikun. U dëgjua një komandë e fortë, që u shoqërua nga dhjetra krisma të pandërprera. Gurit i rrihte zemra fort.

— Të parët bëjnë qitje ushtarët Çlirim Shpatti, Petrit Shkoza dhe Andon Toro, — shpjegoi ai. — Kanë gjashtëdhjetë fishekë kundër gjashtëdhjetë tabelave. Kocha: një minutë.

Ndërsa ai fliste, ushtarët vazhdonin të qëllonin. Ngjyra e tabelave përkundruall ndërrohej si me magji nga e zeza në të kuqe. Ato ishin ndërtuar në mënyrë të tillë, që, pas çdo goditjeje, të rrëzohej pjesa e zezë dhe të mbetej e kuqja. Kështu ngjau thujt me çdo njëren nga ato, me përjashtim të pak tabelave, të cilat nuk u goditën. Dhe qitja ishte aq e shpejtë, aq e përpiktë, sa njerëzit mbetën për një çast të shtangur nga habia. Edhe komandanti i njësisë nuk mundi ta mbante entuziazmin.

— Bukur, — tha ai. Kjo është me të vërtetë një gjë e mirë.

Guri nuk ngopej me frymë. Zemra i rrihte fort.

— Tani do të bëjnë qitje ushtarët Zamir Laska, Gjon Deda dhe Sokol Bardhi.

Kur ata dolën nga strehimi e nisën të vraponin nëpër transhe, komandanti përsëri tundi ko-

kën. Po Guri as këtë radhë nuk e kuptoi shkakun. Edhe qitja e dytë ishte aq e shpejtë dhe e përpiktë, sa të gjithë sa ishin aty, ushtarakë e kooperativistë, duartrokitën e brohoritën me entuziazëm.

— Po tani, komandant, a i kanë hak fjalët e mira? — foli xha Malua. — Për këtë tokë, unë jam rritur me dyfek krahëve, po nuk do të hahesha dot me këta djem, edhe sikur të isha i ri. U lumtë syri i pushkës!

Qitësit e dalluar dhe të gjithë ushtarët u grumbulluan pas pak në pikën e vrojtimit. Komandanti i njësisë i shtrëngoi dorën me radhë Çlirit, Petritit, Zamirit, Andonit, Sokolit, Gjonit, të gjithëve.

— Po, po, ju jeni kaq shumë dhe qëlluat kaq mirë, sa me të vërtetë na bëtë për vete. — Ai heshiti një çast. U kthye nga shokët që kishin ardhur për kontroll. — Nuk do të ishte keq të vinin këtu shokë nga repartet e tjera për të parë. Përvojën e tyre duhet ta përhapim medoemos në tërë njësinë. Medoemos dhe sa më shpejt. Ne duhet të synojmë që çdo ushtar të pregatitet ta diktojë dhe ta asgjësojë armikun brenda sekondës. Po ta arrijmë këtë, kemi bërë gjithçka.

Dhe komandanti nuk i kurseu fjalët e mira atë ditë. Guri nuk e kishte ndier herë tjetër veten aq krenar për ushtarët e tij. Po, ndërsa zbrishte drejt repartit, përkrah eprorit, e ushtarët i ndiqnin nga pas duke kënduar, ai vriste mendjen të kuptonte se pse e kishte tundur kokën komandanti ndërsa vrojtonte me dylbi. Nuk ju durua pa pyetur:

— Kam përshtypjen se, gjatë lëvizjes, diçka nuk ju pëlqeu.

Komandanti hodhi edhe disa hapa e qëndroi. E vështroi me ata sytë e tij të mëdhenj, po të rreptë, që pasqyronin një botë të brendshme të thellë dhe të gjerë.

— Më mirë të mos flasim për vërejtjet tani për tani. **Le të kënaqemi me përshtypjet e mira që na dhuroat,** — ja ktheu ai si u mendua.

— Megjithatë, shoku komandant, ne duhet të mësojmë dhe nga të metat, që të mos i përsëritim më, — ngulmoi Guri.

— Si të doni. Unë desha të mos e prishja atmosferën e sotme festive, — tha komandanti dhe e vështroi ngultas, si të desh të shtonte: «po, meqenëse ju ngulni këmbë, mund edhe t'jua tregoj si është puna».

— E dini çfarë, komisar? Më duket se ushtarët tuaj nuk dinë të maskohen. Ata e kanë harruar fjalën e urtë: «Më mirë një maskim i kujdesshëm, se sa një mburojë prej çeliku».

Këtë radhë e vështroi Guri ngultas. Dukej se nuk ishte në një mendje me komandantin.

— Nuk jeni dakord? — pyeti eprori. — Mbase gabohem, veçse, po të mos kenë kundërshtim, ne mund edhe ta provojmë.

— E provojmë, — ja ktheu Guri, pa e fshehur besimin që parandjente për fitore. Ju kujtua se si disa ditë më parë, gjatë stërvitjes, ushtarët ishin maskuar aq bukur me gjethet që ua jepte pylli pa kursim.

Komandanti priti gjersa u afruan ushtarët.

— Armiku para, për luftim! — komandoi pas-taj me një zë të lartë, të prerë, të rreptë. Ushtarët u stepën një hop, pastaj vrapuan kush djath-

tas e kush majtas dhe, me shpejtësi të rrufeshme, zunë pozicionet e filluan të vetëgroposeshin.

— Tani secili le të maskohet me kujdes. Veprimet e tjera nuk do të kontrollohen. Supozohet se i keni kryer më përpara.

Ushtarët u shpërndanë dhe nisën të maskonin me kujdes helmetën, trupin, pajimet e armën. Lanë të zbuluara vetëm sytë e duart, dhe u kthyen nëpër vendet e tyre. Po të mos i kishe parë kur u ulën, do të thoshe se atje ku qenë shtrirë, kish-te disa kaçube dhe asgjë tjetër. Ndërsa komandanti bënte ecejake në atë brryl rruge, Guri i kontrolloi një për një ushtarët dhe raportoi i sigurtë:

— Gati, shoku komandant!

Ai u afrua disa hapa dhe hodhi një vështrim përreth.

— Faleminderit, — tha. — Për mua është e qartë. Ky është po aq maskim i mirë, sa dhe një demaskim i shkëlqyer, për të cilin armiku do të na ishte mirënjohës.

Guri mblodhi supet dhe desh të pyeste diçka. Por eprori nuk i dha kohë. Duke kaluar nga njëri ushtar te tjetri, ai tregoi se, po të mbuloresh me gjethe në një zallishte, bokërimë a vend të zveshur, në vend që ta mashtrosh armikun, do t'i thuash atij më gojën tënde: «Ja ku jam. Qëllomë!» Në fillim, Gurit nuk i erdhën mirë këto fjalë. Po sa më me kujdes i vështronte ushtarët, aq më tepër i jepte të drejtë eprorit. Prapa çdo fraze të tij të shkurtër, me fjalë të kursyera, dallohej një logjikë e fortë, bindëse.

— Unë nuk them se mjeshtëria e maskimit është më e vështirë se e qitjes, — shtoi ai. —

Kush e bën të dytën, mund ta bëjë shumë mirë edhe të parën. Rëndësi ka të njohim të metën dhe të mos e harrojmë fjalën e urtë të popullit për maskimin. Kështu, komisar?

— Siurdhëron.

Dhe, ndërsa ecnin prapa eprorit të tyre, ushtarët nuk e kishin më atë gjallërinë e mëparshme. Vetëm komandanti sikur e harroi në çast atë që ngjau, dhe nisi të interesohej për problemet e furnizimit, të organizimit, të kohës së lirë të ushtarit dhe përgatitjet për dimër. Nuk harroi të pyeste edhe për nënoficer Hasanin.

— Kur keni qenë për herë të fundit në qytet? Nuk dua t'jua bëj qejfin, por keni një bashkëshorte shembëllore. Vazhdimisht ngul këmbë që të vijë sa më shpejt këtu. Dhe do të vijë, sa t'i hapet një vend në shkollën e fshatit. Hë, për pak harrova: si është ushtar Petriti? E lejoni të shkojë ndonjëherë te e fejuara? Vajzë shumë e mirë. Në qoftëse nuk do të kishte ndonjë kundërshtim edhe Petriti, mund ta dërgonim Fluturën në Shkollën e bashkuar për të dalë oficere.

Guri i përgjigjej shkurt. E dinte se eprorit nuk i pëlqenin fjalët e tepërta. Ai kishte një aftësi të çuditshme për të kapur thelbin e bisedës dhe për të zbuluar, pa e nxjerrë mirë fjalën nga goja, kur nuk i thoshe të vërtetën.

— Po me lejen si e keni punën? Vitin e kaluar, më duket, nuk e bëtë të plotë. Kur ju është caktuar sivjet?

— Më një korrik, ngurroi të përgjigjej Guri.

— Domethënë pasnesër, në mos gabohem.

— Po, por...

— Asnjë «por». Ai që s'di të pushojë, nuk di as të punojë.

Për një kohë, ata u hëngrën me fjalë. Komisar Guri përpiqej të arësyetonte se duhej ta shtyn-te lejen gjersa të rregullonte disa punë që nuk prisnin, kurse eprori i tij ngulte këmbë në të kundërtën.

— Kur dy veta grinden, duhet të gjykojë një i tretë, — tha komandanti. — Le të pyesim ushtarët. Nëqoftëse ata thonë se ju duhet ta shtyni medoemos lejen, le të bëhet ashtu. Përndryshe...

Guri e kuptoi se do ta humbiste davanë dhe u përpoq të dredhonte, por sakaq ushtarët ishin afruar dhe kishin qëndruar përballë tyre.

— Ja si është puna, shokë. Komisar Guri pasnesër duhet të marrë lejen. Por ai thotë se keni shumë punë për të kryer. Dhe, më duket, e hodhi fjalën te maskimi dhe te alarmi që duhet të bëhet me çetën vullnetare. Por unë them se ju, me shokun Pirro, mund t'i kryeni shumë mirë këto detyra. Apo jo?

— Ashtu është, u përgjegjën me një gojë disa veta.

Komandanti ngriti supet, si të donte të thoshte: «Më vjen keq, por...»

— Pra, shoku Guri, pasnesër të fillojë lejen. Fletën e pranimit në konvaleshencë e ka gati.

* * *

Tri pushkë dhe një bombë. Alarm!

Fshati u zgjua i trembur nga gjumi. Njerëzit

u veshën me të shpejtë dhe u grumbulluan në qendër të kooperativës me fenerë në duar.

— Të shuhen dritat! — urdhëroi një zë. — Të qëndrojnë këtu vetëm anëtarët e çetës. Të tjerët në shtëpi.

Ky ishte një urdhër i prerë, ushtarak. Disa veta, sidomos më të moshuarit, u përpoqën të kundërshtonin, por urdhëri u përsërit dhe ata u shkëputën pa dëshirë nga shokët.

— Edhe ju, xha Malo, mund të shkoni. Nuk jeni anëtar i çetës vullnetare.

Plaku u kollit, po nuk lëvizi vendit.

— Gjersa e ka emrin «vullnetare», — tha, — unë do të qëndroj, pa le të bëhet qameti.

Pirrua vuri buzën në gaz. Ai e dinte se, çfarëdo që të thoshte, xha Malua s'do të luante vendit. Bëri sikur nuk i dëgjoi fjalët e tij dhe nisi të jepte detyrën:

— Puna është shumë serioze. Batalioni ynë është vënë në lëvizje, po kanë mbetur disa drejtime, të cilat nuk arrin t'i mbyllë. Dhe koha s'pret. Pak minuta më parë, na njoftuan me radiogram se në afërsi të fshatit tonë është diktuar një bandë diversantësh. Disa reparte janë ngritur në këmbë, por gjer tani nuk kanë rënë në gjurmat e saj.

Ai fliste me zë të ulët, ku vihej re një notë shqetësimi e padurimi. Kooperativistët dëgjonin të habitur. Ata qenë çmësuar me alarme të tilla. Kishin kaluar shumë vjet që në ato anë nuk bëhej më fjalë për banda dhe diversantë. Rrëfimet e më të vjetërve për ta ngjanin me disa legjenda, që i përkisnin së kaluarës. Po nga mënyra se si

fliste komandant Pirrua, nuk mbetej shteg për dyshime.

— Ja si qenka puna! — foli xha Malua. — Dhe mua më thonë të shkoj me fëmijët. Po ku të flihet në një natë si kjo? Për atë tokë se të mba dysheku.

Pirrua përsëri bëri sikur nuk dëgjoi.

— Epo ç'presim, djema, me vrap malit!

— Ju lutem kujdes, shokë. Asnjë hap pa urdhër. Tani do të shkoni të gjithë në depo të pajiseni me armë e municion. Do të pajiseni vetëm me armët dhe municionin e depos. A ka kush armë me vete? Jo! Atëhere, vrap për në depo, — dhe, ndërsa ecnin, Pirrua tregonte drejtimet që do të siguronte çdo skuadër e togë. Sakaq, nga e majta, u dëgjuan breshëri armësh. Dikush pëshpëriti:

— U vonuam, më duket. Djemtë ranë në gjah.

— Pse, neve do të na presin?

Si t'u përgjigjej këtyre fjalëve, një ushtar çau errësirën dhe, duke marrë frymë me nxitim, kërkoi komandant Pirron:

— Ne i diktua, por përsëri na humbën. Duket se i njohin mirë këto shtigje, shoku komandant. Më dërguan t'ju them se kjo faqe mali është e pabllokuar.

Kooperativistëve nuk u durohej sa të merrnin armët. Secilit ju dhanë nga tri ballë fishekë. Dhe komandantët e skuadrave nuk pritën më. Çanë përpjetë malit, bashkë me shokët e tyre.

Xha Malua ishte i mërzhitur që i kishin marrë armën (sadoqë nuk kishte më asnjë fishek) dhe i kishin dhënë një pushkë nga ato të depos. Ecte dhe seç fliste me vete, ndërsa ngulmonte të mos mbetej prapa të rinjve. Nga e ecura e tyre e merr-

te me mend se nuk i kishte edhe aq larg. Ai përpiqej ta zgjaste hapin dhe të zinte Shtegun e Dhelprës. «Nëqoftëse janë të këtyre anëve, rruga do t'i nxjerrë medoemos atje. Për këtë tokë që do t'i nxjerrë», — dhe mendimet i fluturuan dhjetë-dymbëdhjetë vjet të shkuara. Në një natë si kjo, ishte dhënë kushtrimi. Aeroplani kishte hedhur një bandë diversantësh dhe forcat e ndjekjes qenë vënë në kërkim. Xha Malua kishte zënë Shtegun e Dhelprës. Kur ja, ndaj të gdhirë kishte dëgjuar hapa që ngjiteshin. Pastaj disa veta ishin përleshur. Një hop heshtje. Dhe përsëri hapa. I kishte lënë të afroreshin dhe kishte thirrur sa i mbante zëri:

«Ndal! Aty qëndroni!»

Po njerëzit kishin vazhduar të ecnin si më parë.

«Mos lëvizni, se jua shpova plëncin?»

«Ehe, xha Malo, tani të doli gjumi? Ki mendjen!»

Xha Malua kishte njohur zërin e kryetarit të këshillit. E kishte kuptuar se ishte vonuar dhe i kishte çëritur në zemër, kur kishte parë tri veta të lidhur me litarë, që turfullonin e shkumëzonin si kuajt në lëmë. «Bukur ma punuat», — kishte thënë dhe nuk ja kishte falur vetes që s'kishte zënë vend disa metra më poshtë. Po tani e dinte ai ku të rrinte. Le të ngjiteshin të tjerët përpjetë malit. Aq më mirë. Dhe përsëri nisi të fliste me vete. «Thamë se vunë mendje, të mallkuarit. Po s'i mban njeri qentë kot. . . Atë çast, qiellin e çau një raketë, që u ngrit lart me shpejtësi, pastaj e ndali vrullin si e lodhur dhe u kthye përsëri poshtë, duke e bërë dritë vendin. E kuptoi se atë e hodhën

për të ndriçuar dhe u shtri një me tokën e hapi sytë se mos dallonte gjë. Ju duk se poshtë, në rripë, dy hije lëvizën njëra pas tjetrës. «Të më kenë gënjer sytë?» — pyeti dhe hodhi përsëri vështrimin andej, si të donte të çante tejprtej errësirën. As vetë s'e kuptoi se sa priti ashtu pa lëvizur.

«Ç'u bënë, vallë? — përgjonte xha Malua me veshët bigë dhe u tërhoq zvarrë, rrafsh me tokën, për të shikuar më mirë. Disa hapa përpara kërciti diçka. Ai u ndal, u ngjesh më fort pas shkëmbit dhe përgjoi. Kaluan disa minuta. Asgjë. Po pas pak në greminë u rrukullis një gur. Që poshtë, nga ishin ushtarët u dëgjuan zëra, krisma. Pastaj, disa hapa më tej ai dëgjoi përsëri zhurmë. Zemra i rrahu fort. «Po vijnë!» dhe dalloi t'i afroreshin hije të zeza. Ecnin, ndalonin dhe shikonin rrotull, dhe përsëri ecnin. Ai thua se nuk merrte as frymë. Numëroi: «Një, dy, tri... Shumë janë. Po plumba kam për të gjithë. Dhe jo një, po tre-katër për kë». I la të afroreshin dhe ca. Pastaj s'priti më. Thirri:

— Ndal! Duart lart!

U duk sikur sokëlliu kështu vetë shkëmbi. Ata të tre ngrinë në vend, aq papritur u erdhi zëri. Po kjo zgjati vetëm një çast. I pari ngriti duart, ndërsa dy të tjerët, që vinin më pas, u përpoqën të vraponin nga e djathta dhe të fshiheshin shkurreve. Po disa zëra buçitën, u ndjenë lëvizje shulesh dhe në çast:

— Ndal! Mos luaj!

Xha Malua u kthye i habitur. Nga dolën ata zëra? Shokët e tij? Aq pranë t'i kishte dhe të mos i kishte vënë re? Po fundja, pse të mërzhitej? Ai

le të mbërthente të parin që qëndronte në krye, kurse shokët mjaft i kishin dy të tjerët. Dhe, ndër-
sa me një rën dorë mbante pushkën me bajonetë
te gjoksi i diversantit, me dorën tjetër hoqi rripin
e mesit.

— Uli duart dhe mos luaj, — tha, se t'i nxo-
ra zorrët. Qenke dhe i ri. Si dreqin t'i hodhën tru-
të e gomarit?

Diversanti u bind. Plaku ju afrua dhe nisi
ta shtrëngonte fort, si një deng me lesh:

— Të keqen, xha Malo, mos kaq fort, se ma
more frymën.

Plaku e vështroi i habitur: «Nga dreqin ma
ditka emrin?!»

— Hesht, flamë! Kështu i do mushka drutë! —
dhe e shtrëngoi më fort. Atë çast, te kthesa u duk
komandant Pirrua me disa ushtarë. Ai vraponte
e nuk ngopej me frymë.

— I kapët, shokë? Ju lumtë. Tani... mund t'i
zgjidhni.

Xha Malua e vështroi i habitur:

— Ç'thua kështu, komandant?

— Them se, po të ishin diversantë të vërtetë,
ose ushtarë të hedhur nga armiku në prapavijat
tona, ju do t'u kishit treguar vendin...

— Po ç'janë këta, në mos diversantë?

— Këta? Ende nuk i dalloni ushtarët tanë?
Nuk vini re se vetëm sa janë maskuar ca për të
mos u njohur?

— Po, për këtë dhe! Ky qenka Andon sha-
kaxhiu!

— Kurse ky Gjoni!

Kooperativistët vështronin të habitur herë «di-

versantët», herë komandant Pirron. Dhe sikur u vinte keq që dolën të zhgënjyer.

— Ti të na kishe thënë, o komandant, se unë desh e palosa këtë djalin këtu. Sikur të kishte vrapuar pas shokëve, ja ngjesha plumbin bythëve.

Pirrua nuk e mbajti dot gazin.

— Po me se, xha Malo? Ne i kishim marrë të gjitha masat. Fishekët nuk shkrepin. Janë mësimore.

— Po ato krisma, që tundën vendin?

— Ishin fishekë manovre, pa plumb.

Disa veta lëvizën në çast shulet e pushkëve. Vështronin të habitur fishekët që ranë në tokë dhe lëshuan një trokëllimë, si ena e zbrazur. Po, ata vërtet qenkeshin bosh! Si nuk i patën vënë re më parë?

* * *

Ditët që po kalonin në plazh, ishin për Gurin dhe Majlindën mjaft të këndshme. Kjo jo vetëm se vinin nga malet, ku natyra ndryshonte aq shumë me detin, as sepse këtë herë kishin me vete Ditkën e vogël, e cila i zbaviste tërë ditën me gjysmëfjalët dhe hutimin që ndiente sa herë futej në ujë, por sidomos për një arësye tjetër. Ata ishin njohur disa vjet të shkuara pikërisht këtu, në bregun e detit. Guri atëhere po kalonte pushimet verore, ndërsa Linda, pas provimeve të fundit të pedagogjikes, kishte ardhur eskursion bashkë me shoqet e klasës. Ishte një ditë e kthjellët, e bukur, plot ajër e dritë. Deti të grishte me kaltërsinë e tij. Guri porsa kishte dalë në breg dhe ishte shtrirë në rërë. Kishte vënë duart nën kokë dhe

ja kishte dhënë trupin diellit, kur dëgjoi një zë të shqetësuar:

«Ndihmë, ndihmë, po mbytet!»

Ai u ngrit dhe vrapoi buzë ujit. Ata që ishin në det kishin mbetur si të hutuar, kurse në breg disa vajza qenë mbledhur kokë më kokë dhe qanin e thërrisnin me të madhe. Në sytë e tyre të trembur e të përlotur Guri dalloi një trishtim të thellë:

«Kush po mbytet?» — pyeti.

«Një shoqja jonë. Ja, tek e nxori kokën përsëri, Vrapo, shok! Shpëtoje!»

Guri u lëshua me vrap dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u gjend te vendi ku ishte dukur disa sekonda më parë një kokë njeriu. Hodhi vështrimin përreth, po nuk dalloi gjë. Atëhere mbushi gjoksin me frymë dhe u zhyt. U suall majtas e djathtas, po përsëri nuk pa gjë. Dy-tri herë me radhë doli mbi ujë për të mbushur mushkëritë me ajër dhe u zhyt, gjersa përmes perdes së murme të turbullt, dalloi diçka të zezë, që ishte mbledhur grusht dhe përpëlitej me duar e këmbë, si të don-te të kapej diku. E mbërtheu fort nën sjetull e ngriti lart dhe e nxori në breg. Trupi i vajzës ju duk tepër i rëndë. Fytyra i ishte mavijosur, kurse nga goja dhe hundët nxirrte shkumë. Shoqet e saj, tani që e panë, nisën të qanin me të madhe. Guri i largoi me zor dhe nisi t'i jepte të mbyturës ndihmën e parë. Në fillim e ktheu kokëposhtë dhe i nxori ujët që kishte pirë. Pastaj i bëri lëvizjet e duarve dhe të këmbëve. Për disa minuta, ajo nuk dha asnjë shenjë jete. Pas çdo lëvizjeje duart e këmbët i përthyeshin dhe nuk ktheheshin më në pozicionin e parë. Pulsu nuk dallohej në rrihte apo jo. Guri u bë qull në djersë. Lufta me vdekjen ja

kishte përpirë forcat, mendimet, tërë qenjen e tij dhe ai herë i jepte frymë në gojë e i shtypte kra-hërorin, herë i lëvizte gjymtyrët. Më në fund pulsi nisi të rrihte lehtë, po atë çast erdhi maqina e ndihmës së shpejtë dhe të sëmurën e shpunë në spital.

Guri sikur e harroi atë që ngjau dhe u dha i tëri pas detit e rërës. Po një javë më vonë, kur ishte ngritur nga gjumi e po bëhej gati të dilte, e njoftuan se e prisnin në hyrje të konvaleshencës. Zbriti me nxitim shkallët, vështroi me vëmendje përreth. Përveç disa vajzave, askush tjetër nuk i tërhoqi vëmendjen. «Kanë bërë shaka shokët», — mendoi dhe u mat të ikte. Po atë çast dëgjoi një zë vajze:

— Mos jeni ju shoku Guri Lena?

Ai u kthye. I vështroi. Asnjërin nuk njohu.

— Po.

Ato befasi u gjallëruan dhe nisën të flisnin pa i lënë radhë njëra tjetrës.

— Ky është!

— Po, po, ky është, Linda. Unë do ta njihja në mes të njëqind vetave.

— Falënderoje tani që të shpëtoi jetën. Të mos ishte ky, moj e zezë...

Guri vetëm atëherë i ra në të. Shikoi atë që i treguan dhe ju duk sikur e vështronte për herë të parë. Në vend të vajzës me fytyrë të zverdhur e vende-vende të mavijosur, nga tiparet e së cilës nuk i kishte mbetur asgjë në mendje, tani kishte përpara një vajzë krejt tjetër, me tipare të rregullta e të imta, si prej fëmije, me sy të kaltër e si të përplotur dhe flokët gërshet, që i binin gjer

mbi bel. Ajo zgjati dorën e saj të hollë e delikate dhe u ndez flakë në fytyrë:

— Ju faleminderit shumë. Ju më kthyet jetën. Nuk do t'ju harroj kurrë, — foli me një zë të butë e të ëmbël dhe e vështroi me një ndjenjë të thellë mirënjohjeje. Guri e vështronte i hutuar dhe nuk dinte ç'të thoshte. Po shoqet e saj i erdhën në ndihmë. E rrethuan me gjallërinë e tyre dhe nisën të ecnin së bashku.

Pasi shetitën bregut të detit dhe u ndanë në mbrëmje, ata e ndjenë se përsëri do të takoheshin, se midis tyre ishin krijuar lidhje të tilla, që nuk do të shkëputeshin kurrë. Dhe, që nga ajo kohë, atyre u pëlqente të vinin shpesh në plazh. U dukej se deti, me kaltërsinë, thellësinë dhe pafundësinë e tij, ruante në vetvete diçka të frikshme, po edhe të dashur, që i afronte gjithnjë më tepër me njëri tjetrin.

— Të kujtohet ai vendi atje, Linda?

— Hë, hë. E si mund ta harroj? — dhe ajo qeshte e e treste vështrimin ëndërrimtar diku thellë, në det.

— E di, Linda? Më duket nganjëherë se ti u dashurove me mua jo pse të pëlqeva, por vetëm ngaqë ndodhi ashtu dhe kujtoje se kishe një detyrim, një...

— Ç'thua kështu, Guri! Unë ta kam thënë kushedi sa herë. Nuk di se si m'u duke kur të pashë. Gjatë gjithë atyre ditëve, para se të njiheshim, unë kisha menduar shpesh për ty, kisha krijuar me fantazinë time një figurë të dashur, të afërt. Dhe, sa shumë u çudita kur më thanë: «Ja, ai është». Ishe tamam ashtu siç të përfytyroja. Dhe e ndjeva në çast se nuk do ta kisha lehtë të nda-

hesha më. Po ti? Si the ti kur më pe, ë? Më trego.

— Unë?.. «Ja se ç'copë mishi paskam shpëtuar», mendova. «Më mirë ta kisha lënë ta hanin peshqit».

— Ashtu, ë? Shumë të faleminderit, Guri! — dhe, ndërsa ai qeshte, Linda bëhej tërë hundë e buzë, i mbante mëri një copë herë. Pastaj sikur harronin gjithçka dhe jepeshin pas detit, duke lozur e qeshur me dallgët. Për Ditkën vonë kujtoheshin. Ajo kalonte dorë më dorë, si një top i vogël, buçkane, që nuk dinte veç të qeshte, të vraponte e të rrëzohej në rërë. Kjo ishte një lojë që e zbaviste pa masë. Pasi rrëzohej, ngrihej, vraponte dhe përsëri rrëzohej. Guri me Lindën e vështronin si luante, si lëvizte dhe gëzoheshin si fëmijë, kur shihnin me ç'energji e shpejtësi po hynte ajo në jetë. Mbrëmjeve, kur dielli e stoliste horizontin me një ngjyrë të përflakur, kur hëna shtronte mbi detin që dremiste një brez të artë dhe valëzat lëpiheshin pas bregut, ata shetisnin gjer vonë pranë njëri tjetrit. Në mëngjez ngriheshin herët. Ditka flinte në çerdhe. Pas shetitjes së zakonshme, Guri ulej në rërë e lexonte diçka. Kurse Linda, e veshur me një kostum banje rozë, që i jepte një refleks të ndezur, vraponte e shkujdesur në rërë. Gurit i dukej gjithnjë e vogël, lozonjare. E vështronte si vraponte duke rendur pas topit. E godiste atë me majat e gishtave, po, siç dukej, e godiste keq dhe ngrinte këmbën e vrarë e sillej rreth vetes. Pastaj i binte prapë topit me tërë forcën dhe qeshte me të madhe kur shihte si merrte vrull, thuase kishte bërë kushedi çfarë. Tek lozte ashtu, një mëngjez, aty nga ditët e fundit të lejes, Gurit ju afrua një burrë i panjohur.

— Ju jeni Guri Lena?

— Unë.

— Ju ka ardhur një telegram.

Linda e humbi krejt toruan. Kur e pa si e hapi telegramin dhe me ç'vëmëndje e lexoi, ajo qëndroi atje ku ishte, disa hapa larg, e nuk guxonte të afrohej.

— Nëqoftëse të thërresin, ose diçka tjetër të këtillë, të lutem mos më thuaj. Të paktën jo tani. Të lutem.

— Asgjë për t'u shqetësuar, Majlinda. Përkundrazi. Vërtet që është pak e çuditshme, e paqartë, por, sidoqoftë, interesante. Dhe nisi të lexonte. «Kur të mbaroni lejen, ju presim me komandantin e njësisë. Mundësisht bashkë me të. Përshëndetje. Pirrua dhe shokët». Guri e lexoi përsëri dhe përsëri, po as ai dhe as komandanti i njësisë nuk mund ta merrnin me mend surprizën që u kishin përgatitur ushtarët.

* * *

«Gazi» i ngjitej mengadalë rrugës së ngushtë, të përpjetë e të pashtruar malore. Më në fund, ja kazerma. Gurit i ngjante sikur kishte shumë kohë që ishte larguar. Çdo gjë përreth i dukej e afërt, e dashur. Vështronte ndërtesën e zhytyr në një det gjelbërimi, sheshin para saj, po syri thujse nuk i dallonte asnjë ushtar. Ku ishin ata? Ç'po bënin? Përse vallë e kishin ftuar bashkë me komandantin e njësisë?

Papritur, shoferi frenoi. U ndalën edhe mendimet e Gurit.

— Pse qëndrove?

— Buzë rrugës ka një tabelë.

Ata zbritën. Guri u afrua i pari dhe lexoi: «Skuadra është maskuar në këto njëqind metra, majtas e djathtas rrugës. Po nuk diktuat, qoftë edhe një ushtar, do të hapim zjarr me fishekë manovre». Komandanti epror u afrua e lexoi dhe ai me zë: «Skuadra. . .» U panë sy më sy me komisararin. Gurit i qeshte fytyra. Brodhi sytë ledheve, në të dy anët e rrugës, po nuk dalloi asgjë. Kjo lojë ju duk tërheqëse. Në çast e pushtoi dëshira që të kërkonte, t'i gjente ushtarët dhe t'u thoshte: «Sado që të përpiqeni, nuk na i hidhni dot as mua, as komandantit». Krahas kësaj nxirrte krye një dëshirë tjetër: të kërkonte e të kërkonte dhe të mos i gjente.

— Epo, si thua, shoku Guri? — pyeti eprori.
— E provojmë një herë? Ti shiko djathtas, unë majtas. Po mos ma bën me hile, ama! Vështro mirë. Po të mos mbash anën e ushtarëve, do t'i gjemë se s'bën!

Majlinda me shoferin kishin zbritur nga maqina dhe vështronin të habitur. Ata të dy nisën të çapiteshin. Ecnin ngadalë si t'u kishte humbur gjë; herë-herë ktheheshin dhe përsëri vazhdonin. Kontrollonin me kujdes çdo pëllëmbë, çdo sop, çdo gëmushë. Befas komandanti u çel në fytyrë:

— Aha, ja tek të pashë. Afër shkëmbit je, shoku ushtar. Ngreu!

Po nuk mori asnjë përgjigje. Atëhere shpejtoi hapin, ju afrua shkëmbit dhe u përkul mbi një kaçube:

— Mos bën sikur nuk dëgjon. Ngreu! — tha përsëri, po mbeti i habitur kur midis degëve nuk dalloi gjë. «Sidoqoftë, s'kanë ku futen. Do t'i gjej-

më se s'bën». Dhe eci më tej. Po i afroheshin sektorit të kufizuar nga tabelat dhe nuk po dallonin asnjë ushtar të vetëm. Si ishte e mundur? Mos kishin bërë shaka dhe, ndërsa ata po kontrollonin, ushtarët u pregatisnin një lojë tjetër? Po të ishin aty, s'kishte si të mos i dallonin, së paku njërin prej tyre.

Ata u kthyen dhe nisën të kontrollonin nga e para. Pas çdo vendi të ngritur dhe kaçubeje u dukej sikur i vështronin sytë tinzarë të ushtarëve. Qëndronin, kontrollonin me kujdes me sy, me duar e me këmbë, dhe shikonin të habitur njëri tjetrin. Kaq mirë të jenë maskuar? Nuk ishte e mundur! Duhej t'i gjenin medoemos. Dhe e nisnin nga e para. Po më kot. Më në fund, komandanti u ul mbi trungun e një peme.

— Epo, unë i ngrita duart, — tha. — Po të jenë këtu, le të dalin.

— Shokë ushtarë, dilni, ku jeni futur? — pyeti Guri.

Pa e mbaruar mirë fjalën, u dëgjua një kris më, që u pasua në çast nga shumë të tjera. Guri me komandantin brofën në këmbë, megjithëse ishin paralajmëruar për qitjen. Dikush kishte shkrepur fare pranë tyre. Vështruan përreth. Vende-vende dukeshin njolla tymi, si të kalonte nën dhe oxhaku i maskuar i një kuzhine fushore. Në vend të erës së gjellës, ata ndjenë erën e athët të barutit.

— Ku janë fshehur kështu?!

Vendi ra disa çaste në heshtje. Pastaj shpërtheu një batore tjetër, po aq e befasishme sa e para. Komandanti i njësisë vështronte i çuditur majtas dhe djathtas. Disa hapa përpara lëvizti diçka. Ai vuri re, më në fund, një grykë pushke, që kishte

nxjerrë syrin e saj të metaltë e të palëvizshëm përmes një guri të madh. Si ishte e mundur ta shponin atë tejprtej? U mat të ngrihej të shkonte atje, po atë çast shpella lëvizi me një lehtësi jo të zakonshme dhe u kthye përmbys. Komandanti puliti sytë, kur vuri re se «guri» s'ishte tjetër, veçse një letër e trashë, si maskë, e lyer me diçka të murme, që nuk kishte as ndryshimin më të vogël me shkëmbin, si nga ngjyra ashtu edhe nga forma. Sakaq, mbi tokë u duk fytyra e Çlirimit, i cili kërceu lart me shkathtësi dhe, pa u lënë kohë eprorëve të merrnin veten nga hutimi i parë, komandoi:

— Skuadra, çou!

Atë çast, nga buza e ledhit, u largua një si perde e ngrirë, e lyer me baltë, dhe para tyre dolën Petriti me Sokolin. Pak më tutje, u duk sikur u ngrit një plis i gjatë, i stërmadh. Dikush hoqi diçka si peliçe të rëndë, të gjelbër, që nuk ishte tjetër veçse një rrjetë bari të njomë. Ushtari mori drejtqëndrimin, si të donte të paraqitej: Zamir Laska. Sakaq komandanti ndjeu trokitje, në trunqun ku ishte ulur, si ta gërvishte me sqep një qukapik dhe dëgjoi një zë të thellë:

— Më lejoni, shoku shef?

Ai u ngrit dhe shtangu nga habia kur pa si u përmbys trunqun dhe, që poshtë kërceu si ketër ushtar Andoni, me gojën gjer te veshët. Ai vrapoi si të shkelte mbi vezë e zuri vendin në rresht, duke i bërë shokët të qeshnin. Komandanti me komisar Gurin vështronin njëri tjetrin të habitur, kurse Majlinda me shoferin po qeshnin me të madhe.

— Hëpërhë, unë mund vetëm t'ju përgëzoj,

shokë, dhe t'ju them se ndoshta, pa e kuptuar, ju keni bërë një përmbysje të vërtetë në format e maskimit, — foli komandanti i njësisë.

Atë ditë që kishte ardhur ekipi i komandës eprorë, Çlirimi kishte mbledhur në heshtje një grup shokësh, kishte shkuar bashkë me ta atje ku komandanti i njësisë u kishte tërhequr vëmendjen për maskimin.

— Tani secili të zërë një vend dhe të mendo-het si të bëhet i padukshëm. Unë po e provoj këtu, — dhe ishte ulur në një shkëmb.

— Punë e rëndë kjo, vëllezër, — kishte thënë Andoni, duke u ulur në një trung peme.

— Vetëm të hash e të flesh është lehtë, — ja kishte pritur Çlirimi aty për aty.

Andoni nuk kishte mundur ta gjente në çast përgjigjen e duhur.

— Epo mirë, — kishte thënë. — Provoje të maskohesh te shkëmbi. Por mos harro, ama: murit nuk i bihet me kokë.

Çlirimi e pat vështruar gurin në heshtje dhe seç bluante me mendje.

— Do ta provoj, — kishte thënë. — Dhe do t'ja dal.

— Po u maskove te guri, — kishte shtuar Andoni, — unë do të maskohem këtu, — dhe kish goditur trungun me majën e këpucës.

Pas këtyre fjalëve, ushtarët kishin filluar të diskutonin me gjallëri. Sikush, pasi mendohej, jep-te një mendim, që i nënshtrohej aty për aty gjy-kimit të kolektivit. Çlirimi ishte menduar gjatë. Si mund të maskohej te shkëmbi? Të ishte pak më lart ose më poshtë, do ta gjente me siguri një rrugëdalje, kurse atje... Disa net me radhë ai nuk

e kishte ngopur synë me gjumë. Një mëngjez, shokët e kishin parë të shkonte te shkëmbi me një kovë uji dhe një shuk gazetash nën sjetull. I kishte lagur gazetat në kovë dhe i kishte shtruar si petë mbi shkëmb. Ato kishin marrë formën e gurit. Më në fund, sa kishin qenë ende të lagura, u kishte hedhur përsipër një shtresë hiri. Shokët e kishin vështruar të habitur dhe mezi e kishin mbajtur gazin. Por disa minuta më vonë, kur gazetat ishin tharë dhe kishin dalë si masë, tamam në formën e shkëmbit, ata kishin mbetur me gojëhapur. I zgjuar është ky Çlirimi! Çfarë nuk i pjell mendja!

«Shpikja» e tij kishte ndezur flakë fantazinë e shokëve, të cilët e kishin pasur më të lehtë të gjenin format e maskimit, duke u futur nën sipërfaqen e tokës, apo të trungut...

...Kjo ishte për repartin prova vendimtare për fitimin e titullit të shëmbullorit dhe, në të njëjtën kohë, dëshmia e fundit e pjekurisë për Çlirimin para se të shkonte në shkollë për oficer.

— Po, po — thoshte komandanti i njësisë. — Kjo është një përmbysje e plotë në format e njohura të maskimit.

Ushtarët e vështronin me mburrje e krenari komisarin e tyre.

EPILOGU

Para ndërtesës trekatëshe, në një nga rrugët kryesore të qytetit B, qëndroi një motoçikletë. Të dy ata që zbritën kërkuan me sy hyrjen kryesore dhe ngjitën me nxitim shkallët. Ndalën një çast para hyrjes së apartamentit, ku shkruhej «Familja Guri Lena», dhe i ranë ziles. Derën e hapi një vajzë e vogël, me fjongo në kokë e një përparëse të bardhë, të qendisur bukur.

— Urdhëroni, — dhe vogëlushja u përkul e i ftoi të hynin brenda. Flutura e rrëmbeu në duar dhe thirri e habitur:

— Ua, kjo qenka Ditka! Sa është rritur! — dhe e shtrëngoi në krahëror. Vajza e vogël vështrroi e hutuar kapelen me yll, uniformën kaki, me shenjat e kuqe në jakë dhe pyeti:

— Teta, ushtarë je ti, si babi?

— Po, xhan i tetës, ushtarë.

— Unë i dua shumë ushtarët, teta, i kam xhan, — dhe e përqafoi fort. — Po ai xhaxhi kush është, vëllai yt?

Të porsaardhurit qeshën dhe s'ditën si të përgjigjeshin. Atë çast u hap dera e dhomës.

— Ua! Dhe ne thamë pse na u vonua kështu Ditka! Paska ardhur teta Flutura me xhaxhi Petritin, — dhe Majlinda me Fluturën nuk shkëpu-teshin nga njëra tjetra.

— Epo tani mjaft, de, mjaft, se do të takohet edhe me ne të tjerët. Keni kohë të shmalleni, — foli një zë që prapa krahëve të tyre. Flutura mori drejtqëndrim, përplasi lehtë takat e çizmeve dhe raportoi ushtarakisht:

Shoku komisar, ... me rastin e emërimit pranë njësisë suaj, ju paraqitet...

Guri i shtrëngoi dorën, në fillim Fluturës, pastaj Petritit:

— Gëzohem shumë shoqja Flutura, që e mbaruat shkollën shkëlqyeshëm dhe që u transferuat te ne. Kurse juve, shoku Petrit, suksese në mësim. Të na bëheni një drejtues i mirë i kooperativës bujqësore.

Sa u ulën nëpër karrige, që prapa pasqyrës së gjatë të tualetit lëvizin diçka. Petriti e kuptoi se atje dikush që fshehur. Vuri buzën në gaz dhe u afrua duke mbajtur një petëz në dorë, në vend të pushkës.

— Pa shih kush qenka! Aha, shoku «strateg», mos lëvizni, se jeni i rrethuar. Duart lart!

Çlirimi doli me duart e ngritura.

— Jam dorëzuar! Në mëshirën tuaj, shoku kryetar.

Ata u përqaftuan fort, si shokë të vjetër, të dashur.

— Shokë, zini vendet. Flutura me Majlindën kanë ditën e punës në prodhim, — foli Guri buzagaz. — Kur të lodhen ato, e fillon turni i dytë: unë me Petritin. Çlirimin do ta lëmë të lajë pjatat, si dënim që është beqar.

Të gjithë qeshën me zemër. Secili nga ata ndjente një gëzim të thellë dhe ishte i kënaqur që e ndante me shokun këtë gëzim. Ndërsa filluan

të kujtonin repartin, ditët e paharruara që kaluan atje, Linda me Eluturën shtruan me të shpejtë tavolinën.

— Pra, mund të fillojmë, shokë, — u ngrit Guri dhe mori në dorë gotën e rakisë. — Ju lutem, zini dhe ju vendet, shoqe.

— Një minutë, — e ndërpreu Majlinda. — Kam ruajtur për ju një surprizë. Hapni gojën dhe mbyllni sytë.

Në dhomë ra heshtja. Por kjo nuk zgjati. Dera e brendshme trokiti.

— Prisni pak, — ju drejtua Linda atij që rrinte pas dere. — Kush mund ta gjejë se cili trokiti?

Ata u menduan një çast:

— Komandant Pirrua! — tha Çlirimi.

— Ka vajtur në akademi për studime, — sqaroi Guri.

— Zamiri! — shtoi i sigurtë Petriti.

— Dy vjet aksionist në zonat malore, bashkë me Hasanin.

— Andon shakaxhiu...

— Jashtë shtetit, me ekipin kombëtar të qitësve.

— Asnjeri nuk e gjeti, — i ndërpreu Linda e kënaqur. — Hyni! — foli ajo me zë të lartë.

Që prapa derës u dëgjua një kollitje e ngjirur:

— Për atë tokë, që është xha Malua!

— Xha Malua, dora vetë!

Plaku përdrodhi mustaqet dhe hoqi çibukun nga goja:

— Kështu, ë? As që ju vajti mendja për mua! E harruat fare xha Malon e gjorë.

Ata u përshëndetën dhe i bënë vend në krye të tryezës.

— Tani, besoj, nuk presim më njeri. Xha Malo, merrni komandën, — ju drejtua Guri.

— A jo, jo, mos më ngatërro mua. Unë jam me të vjetrën e do më turpëroni.

— Mos u mundo kot, xha Malo, nuk i shpëton dot përgjegjësisë, për këtë tokë, — dhe Guri goditi lehtë tavolinën.

Të gjithë qeshën. Vështruan xha Malon.

— Epo, gëzuar, shokë. kooperativistët më thanë që ta uroj shokun Guri për detyrën e re, lart e më lart shoku Guri, dhe Çlirimin e Fluturën që na nderuan në shkollë e dolën oficerë. Punoni mirë, djema, se për atë tokë, nuk është shaka të jesh sot oficer, të komandosh një ushtri si kjo jona, që ja shkrin plumbin në gojë dushmanit. Dalçi faqebardhë të gjithë dhe mos e harroni fshatin tonë. Kurdo që të vini, do t'ju presim me zemër të hapur.

— Gëzuar shokë. Suksese në punë, në jetë!

— Gëzuar! ..